



Raporti i Stabilitetit Financiar

6MII-2023

Parathënie.....	3
Shënime.....	4
Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023.....	5
1. Zhvillimet makroekonomike	12
1.1 Harta e stabilitetit financiar	12
1.2 Mjedisi makroekonomik i jashtëm	14
1.3 Mjedisi makroekonomik në vend	18
1.4 Zhvillimet në llogaritë financiare	21
1.4.1 Pozicioni financiar i bizneseve	23
1.4.2 Përbalueshmëria e borxhit dhe pritjet për të ardhmen.....	27
1.4.3 Pozicioni financiar i individëve	29
1.4.4 Përbalueshmëria e borxhit dhe pritjet për të ardhmen.....	32
2. Tregjet dhe sistemet e pagesave	33
2.1 Tregjet e kapitalit, tregu ndërbankar dhe tregu i këmbimit të monedhave.....	33
2.1.1 Tregjet e letrave me vlerë	33
2.1.2 Tregu ndërbankar i financimit.....	36
2.1.3 Tregu i këmbimit të monedhës	36
2.2 Tregu i pasurive të paluajtshme	37
2.3 Sistemet e pagesave	40
3. Sistemi financiar.....	42
3.1 Sektori bankar	43
3.1.1 Zhvillimet kryesore në sektorin bankar	43
3.1.2 Rreziqet e veprimtarisë së sektorit bankar	58
3.1.3 Rezistenca e sektorit bankar.....	66
3.2 Sektori jobankar.....	69
3.2.1 Ecuria e sektorit jobankar	69
3.2.2 Rreziqet dhe ekspozimet midis sektorit bankar dhe jobankar	72
4. Rreziqet sistemike dhe politika makroprudenciale.....	73
4.1 Rreziqet sistemike dhe politika makroprudenciale	73
4.2 Perceptimi i sektorit bankar mbi rrezikun sistematik	75

Parathënie

Raporti i Stabilitetit Financiar (më tej "raporti") publikohet dy herë në vit dhe ky është numri i 31-të i tij. Në hyrje të raportit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila, sipas kërkesës së ligjit, duhet të publikohet çdo gjashtë muaj. Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e tij, si dhe vlerëson aftësinë e sistemit financiar për t'i përthithur këto rreziqe. Dokumenti iu mundëson autoriteteve publike identifikimin në kohë të masave përkatëse për korrigjimet e nevojshme.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregut financiar, si dhe janë shfrytëzuar analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Analiza në vijim mbulon kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2023 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe rreth 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë së veprimtarisë së tij dhe të rreziqeve që burojnë nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm. Për të vlerësuar këto rreziqe, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonominë e vendeve të zhvilluara dhe ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Zhvillimet dhe rreziqet e lidhura me ekonominë vendase janë analizuar në bazë të treguesve të rritjes ekonomike, bilancit të pagesave, nivelit të përgjithshëm të çmimeve, kursit të këmbimit, si dhe treguesve fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimit të veçanta, është vlerësuar gjendja financiare e sektorit të bizneseve/ndërmarrjeve dhe të individëve/familjeve, si edhe ndikimi i saj mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar. Rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të ndryshme makroekonomike është vlerësuar nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit.

Raporti i Stabilitetit Financiar përgatitet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Shënime

Në fund të muajit dhjetor 2023, bankat në sektorin bankar shqiptar janë klasifikuar:

I. sipas kontributit marzhinal të secilit institucion në rrezikun sistemik në vend,¹ duke u grupuar në:

- ✓ **Banka me rëndësi sistemike:** Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Raiffeisen sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a.,
- ✓ **Banka të tjera:** Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka Tirana sh.a.;

II. sipas origjinës së kapitalit, duke u grupuar në:

- ✓ **Banka me kapital të huaj²:** Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (Itali); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka OTP Albania sh.a. (Hungari); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari). Këto banka zotërojnë rreth 64% të aktiveve të sektorit,
- ✓ **Banka me kapital shqiptar:** Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Tirana sh.a dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. Këto banka zotërojnë rreth 36% të totalit të aktiveve të sektorit.

III. sipas shtrirjes gjeografike të rrjetit bankar. Shtrirje të rrjetit bankar jashtë vendit kanë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. dhe Banka Credins sh.a., me filialet përkatëse në Kosovë.

Për analizën e kryer në raport, duhet të konsiderohet që:

- (1) Termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit; në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje"/"biznese" dhe "individë"/"familje";
- (2) Termi "teprica e kredisë" i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç është raportuar në bilancin e bankave në fund të periudhës që analizohet. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga kreditë me probleme që janë larguar nga bilancet e bankave gjatë periudhës. Për këtë arsye, teprica e kredisë që analizohet në Raportin e Stabilitetit Financiar është një koncept i ndryshëm nga ai i "kredisë për ekonominë", që trajtohet në Raportet e Politikës Monetare.

Në kredinë për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobankare. Kredia për ekonominë përfshin vetëm kredinë për sektorin privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirja e kredive me probleme, duke qenë se këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën e tyre ekonomike; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt. Dallimi në këto koncepte të kredisë, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

¹ Për më shumë informacion mbi indeksin dhe mbi përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike (BARS), lutem konsultoni dokumentin "Metodologji "Për përcaktimin e bankave me rëndësi sistemike dhe shtesën përkatëse të kapitalit"" të publikuar në: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikës_makroprudenciale/Akte_të_miratuara/

² Një bankë klasifikohet si bankë me kapital të huaj, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.

Deklarata e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë (BSH) publikon këtë deklaratë periodike, që është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me ekonominë e jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si dhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023 (më tej, "periudha"), veprimtaria e sektorit bankar u përmirësua. Depozitat dhe kreditë u zgjeruan pavarësisht efektit pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit, kapitalizimi i veprimtarisë u shfaq në nivele të mira, ndërsa fitimi u përmirësua në mënyrë të ndjeshme. Rreziqet e veprimtarisë vlerësohen në nivele të kontrolluara dhe në tërësi rezistenca e veprimtarisë bankare ndaj tyre është forcuar. Megjithatë, rreziqet e shoqërojnë gjithmonë veprimtarinë bankare, ndaj performanca më e mirë financiare duhet të përdoret nga bankat për të përmirësuar infrastrukturën e administrimit të rreziqeve.

Zhvillimet ekonomike gjatë periudhës ishin pozitive, ndikuar nga ecuria e mirë e konsumit dhe e investimeve, dhe veçanërisht nga përmirësimet në llogarinë korrente të bilancit të pagesave. Rritja ekonomike u shoqërua me ulje të papunësisë dhe rritje të punësimit e të pagave. Politika fiskale ruajti një prirje konsoliduese në kushtet e rritjes së ndjeshme të të ardhurave fiskale. Presionet inflacioniste erdhën në rënie, por norma e inflacionit mbeti mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë. Reagimi i mëtejshëm i politikës monetare do të mbështetet mbi të dhënat korrente dhe do të pasqyrojë analizën e faktorëve të rrezikut për ecurinë e inflacionit. Rreziqet për zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend mbeten të pranishme. Ato lidhen kryesisht me pasigurinë që mbartin zhvillimet gjeopolitike. Në këto kushte, mbetet e rëndësishme që politikat ekonomike të përdorin këtë periudhë të favorshme në zhvillimet ekonomike e financiare në vend, për të konsoliduar arritjet dhe për të reformuar më tej ekonominë me qëllim vendosjen e saj në shinat e një zhvillimi sa më të qëndrueshëm dhe të balancuar në të ardhmen.

Më konkretisht, zhvillimet e periudhës treguan që:

Aktiviteti ekonomik botëror është zgjeruar gjatë periudhës. Zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregun e punës, ecuria e mirë në sektorin e shërbimeve dhe mbështetja fiskale në rajonet e zhvilluara, mbështetën ecurinë e mirë të konsumit dhe të investimeve private pavarësisht kushteve më të shtrënguara monetare. Presionet inflacioniste kanë rënë më shpejt nga pritjet në shumicën e rajoneve, si pasojë e normalizimit të politikës monetare, efektit bazë dhe rënies së çmimeve veçanërisht në tregjet e energjisë. Ekonomia e Eurozonës nuk shënoi rritje në gjysmën e dytë të vitit 2023, duke reflektuar dobësimin e kërkesës së jashtme dhe tkurrjen e prodhimit dhe investimeve në kushtet e rritjes së kostove të financimit. Norma e inflacionit erdhi në rënie, por mbeti mbi objektivin e Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Kjo e fundit ka vijuar me normalizimin e politikës monetare, duke realizuar rritjen e fundit të normave të saj të interesit në shtator 2023. Transmetimi i fortë monetar është pasuar me rritjen në tërësi të normave të interesit në treg dhe rënien e kërkesës për kredi. Megjithë pasiguritë, rritja ekonomike e Eurozonës pritet të rigjallërohet

gradualisht gjatë këtij viti, ndërsa presionet inflacioniste pritet të lehtësohen dhe norma e inflacionit të rikthehet në objektivin e BQE-së në vitin 2025. Në Ballkanin Perëndimor, ekonomia është rritur me norma të kënaqshme dhe më të shpejta nga një vit më parë. Kjo rritje solli përmirësim të bilanceve fiskale dhe ulje të borxhit publik. Në sektorin e jashtëm, llogaria korrente është përmirësuar ndjeshëm në të gjitha vendet. Shtrëngimi i politikës monetare gjatë vitit 2023 ka dhënë efektet e tij në rënien e mëtejshme të normave të inflacionit dhe ngadalësimin e rritjes së kredisë. Cilësia e kredisë në rajon ka mbetur e qëndrueshme dhe raportet e kredive me probleme janë në nivele relativisht të ulëta. Në tërësi, ekonomia botërore pritet të vijojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme, por të ngadalhtë gjatë periudhës 2024-2025, e kryesuar nga rajonet në zhvillim. Niveli i pasigurisë mbetet i lartë dhe i ndikuar nga shpejtësia e rënies të inflacionit, kostot ekonomike të konsolidimit fiskal të orientuar drejt uljes së borxhit, përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike, të cilat mund të gjenerojnë goditje të reja ndaj zinxhirëve të prodhimit, si dhe ndryshimet strukturore të nxitura nga ndryshimet e klimës dhe teknologjisë.

Në terma vjetorë, ekonomia shqiptare u rrit me 3.8% deri në fund të vitit. Rritja ekonomike ka pasur një bazë të gjerë sipas sektorëve, por kontributin më të fortë në rritje e dha sektori i shërbimeve. Nga ana e kërkesës, aktiviteti ekonomik u mbështet nga konsumi final, investimet e sektorit privat dhe përmirësimi i ndjeshëm në bilancin e llogarisë korrente. Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive, si rritja e punësimit, rënia e normës së papunësisë dhe rritja e pagave në sektorin privat dhe në atë shtetëror. Në muajin nëntor, Banka e Shqipërisë rriti normën bazë të interesit me 0.25 p.p., në nivelin 3.25%. Presionet inflacioniste erdhën në rënie, por norma e inflacionit shënoi 4% në fund të vitit 2023, duke mbetur mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë. Kjo ecuri e inflacionit ka reflektuar efektin e normalizimit të politikës monetare, mbiçmimin e monedhës vendase dhe rënien e inflacionit të importuar, si edhe shuarjen e efektit të bazës së krahasimit. Në vijim, politika monetare do të mbetet e orientuar nga ecuria e të dhënave dhe analiza e faktorëve të rrezikut. Gjatë periudhës, politika fiskale ka qenë në tërësi konsoliduese. Objektivat për deficitin buxhetor u përmbushën në muajin e fundit të vitit, kur u përshpejtua realizimi i shpenzimeve publike të planifikuara. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficitin buxhetor dhe borxhi publik në total - kanë shfaqur një rënie të ndjeshme gjatë vitit 2023. Bilanci i pagesave, që tregon marrëdhëniet e ekonomisë shqiptare me botën, u përmirësua ndjeshëm gjatë periudhës. Deficiti i llogarisë korrente në tremujorin e katërt, është përgjysmuar ndaj vlerave të një viti më parë, kryesisht si rezultat i rritjes së flukseve neto të valutës nga shërbimet e udhëtimit, nga investimet e huaja direkte dhe nga dërgesat e emigrantëve. Stoku i pozicionit debitor të vendit ndaj jorezidentëve u zgjerua gjatë vitit 2023, për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat në formën e investimeve të huaja direkte dhe atyre të portofolit.

Gjendja financiare e bizneseve dhe e familjeve është e qëndrueshme dhe është përmirësuar gjatë periudhës. Sipas të dhënave të llogarive financiare, pozicioni i *bizneseve* është debitor dhe ai është thelluar gjatë vitit 2023. Sipas instrumenteve, ky zhvillim lidhet me rritjen e mëtejshme të detyrimeve në formën e investimeve të huaja direkte. Në terma të kundërpasive, bizneset kanë pakësuar detyrimet neto ndaj korporatave financiare, për shkak të rritjes më të shpejtë të depozitave sesa të kredive që ato kanë në banka dhe kanë zgjeruar detyrimet neto ndaj jorezidentëve. Kredia bankare për bizneset është rritur gjatë vitit 2023 dhe ritmi i rritjes ishte më i lartë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Kjo rritje ishte më e ndjeshme nëse korrigjohet për efektin pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit. Norma mesatare e interesit për kreditë e reja u rrit në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, si rezultat i rritjes së normave të interesit të kredive të reja për biznesin në valutë. Aktualisht, normat mesatare të interesit për kredinë e re në lekë, janë më të ulëta sesa ato për kredinë në euro. Pavarësisht rritjes së normës mesatare të interesit, kërkesa e bizneseve për kredi ishte më e fortë në krahasim me gjysmën e parë të vitit, ndërkohë që bankat kanë lehtësuar kushtet dhe termat e përgjithshme të kredisë për bizneset gjatë periudhës. Sipas vrojtimit të Bankës së Shqipërisë, shumica dërrmuese e bizneseve kanë raportuar fitime gjatë periudhës, dhe ecuria e shitjeve dhe e rezultatit

financiar vlerësohen pozitive krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Pritjet mbeten optimiste, megjithë problematikat që ekzistojnë lidhur me gjetjen e tregut, rritjen e kostove të prodhimit dhe të punës, si dhe me gjetjen/ruajtjen e stafit të kualifikuar. Pesha e bizneseve huamarrëse ka shënuar rënie gjatë periudhës, gjë që është e pritshme në kushtet e niveleve më të larta të normave të interesit dhe gjendjes së mirë të likuiditetit të tyre. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të borxhit ndaj kapitalit, dhe në formën e shërbimit të tij ndaj të ardhurave të ndërmarrjes, vlerësohet në nivele të përballueshme për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, dhe pa ndryshime të rëndësishme nga gjashtëmujori i mëparshëm. Bizneset presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet pozitive gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.

Familjet ruajnë një bilanc të theksuar pozitiv midis mjeteve dhe detyrimeve të tyre financiare. Kreditë nga korporatat financiare vendase zënë pjesën dërrmuese të detyrimeve të individëve, por vlera e tyre është disa herë më e vogël se vlera e depozitave pranë sektorit bankar. Pozicioni kreditor i individëve ndaj sistemit financiar vijoi të zgjerohet gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe nominale të kursimeve, duke përfshirë depozitat në banka dhe investimet në tituj, në krahasim me kreditë. Gjatë periudhës, depozitat e individëve në banka u zgjeruan me 55 miliardë lekë, dhe në fund të vitit ato shënonin vlerën 1,245 miliardë lekë. Kredia për individët u ngjiti në 270 miliardë lekë në fund të periudhës, duke u zgjeruar ndjeshëm pavarësisht vijimit të rritjes së normës mesatare të interesit.

Kërkesa për kredi është mbështetur në nevojën për konsum dhe për blerje pasurish të paluajtshme, të cilën bankat e presin të qëndrueshme edhe në periudhën e ardhshme. Rezultatet e vrojtimit të Bankës së Shqipërisë tregojnë që, megjithë luhatjet, pesha e familjeve huamarrëse dhe aftësia paguese e tyre paraqiten të qëndrueshme. Pesha e familjeve që kanë një hua për të paguar nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, por ka rënë disi krahasuar me nivelin e një viti më parë. Aftësia paguese e familjeve vlerësohet e përmirësuar krahasuar me rezultatet e vrojtimit të kaluara. Pritjet për aftësinë paguese në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten më optimiste. Megjithatë, familjet presin që kërkesa e tyre për kredi të vijë në rënie në pjesën e parë të vitit 2024.

Tregjet financiare kanë funksionuar në mënyrë të qëndrueshme. Në tregun parësor të titujve të borxhit të qeverisë, vëllimi i emetimeve gjatë periudhës ishte 30% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, por i krahasueshëm me vëllimin e një viti më parë. Në volumin e emetimeve të periudhës, emetimet afatshkurtra zbritën në nivelin më të ulët historik prej 53%. Normat e interesit shënuan rënie për pjesën më të madhe të titujve, duke rezultuar në ulje të kostos së borxhit të qeverisë dhe duke reflektuar pritjet e investitorëve për rënien graduale të normës së inflacionit. Gjatë periudhës, norma mesatare e ponderuar e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në lekë ra me 0.4 p.p., duke arritur në nivelin 4.1%. Për titujt afatshkurtër, norma mesatare e interesit ra me 1.2 p.p. në nivelin 3.2%; ndërsa për titujt afatgjatë, ajo qëndroi pranë nivelit të gjashtëmujorit të kaluar prej 5.2%. Oferta e investitorëve ka qenë e lartë dhe në shumicën e rasteve i ka mbuluar nevojat e qeverisë për huamarrje. Volumet e tregtuara në tregun dytësor të titujve, mbeten të ulëta dhe mbizotërohen nga transaksionet që bankat kryejnë për portofolin e tyre. Në tregun ndërbankar, vëllimi i transaksioneve të financimit shënoi rënie. Kontributi kryesor erdhi nga rënia e vëllimeve të transaksioneve 1-javore. Norma e interesit në transaksionet ndërbankare është rritur duke ndjekur nga afër ecurinë e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë. Në tregun e këmbimit të monedhave, leku ka vijuar të mbiçmohet ndaj valutave kryesore, duke reflektuar zhvillimet pozitive në flukset hyrëse të valutës në bilancin e pagesave. Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvillojë ankande për blerjen e euros, sipas kalendarit të publikuar paraprakisht dhe duke i shërbyer objektivit për rritjen e rezervës valutore.

Në tregun e pasurive të paluajtshme, zhvillimet kanë qenë të qëndrueshme dhe çmimet e pasurive të paluajtshme rezidenciale kanë shënuar rënie. Sipas vrojtimit të posaçëm të Bankës së Shqipërisë mbi

kushtet e tregut të pasurive të paluajtshme dhe çmimet për pasuritë e paluajtshme rezidenciale, rezultojnë që subjektet e pyetura e vlerësojnë pozitivisht gjendjen e përgjithshme të tregut. Indeksi i çmimit të banesave në rang vendi dhe për Tiranën ra me përkatësisht 7.6% dhe 10.1% në terma gjashtëmujorë, duke u rikthyer pranë nivelit mesatar të një viti më parë. Nga ana tjetër, çmimet e qirasë janë raportuar në rritje. Sipas të anketuarve, shitjet u rritën lehtë në krahasim me dy gjashtëmujorët e mëparshëm, ndërkohë që numri i pronave të pashitura ka rënë. Kërkesa nga jorezidentët mbetet e pranishme dhe ka ardhur në rritje në krahasim me periudhat e kaluara. Kërkesa në këtë treg u mbështet nga kredia bankare për blerjen e pronave të paluajtshme për individë dhe biznese, e cila ka vijuar të rritet me ritme të shpejta pavarësisht niveleve më të larta të normave të interesit. Në tërësi, oferta për prona të paluajtshme, e matur nga ecuria e numrit të lejeve të ndërtimit, ka vijuar të rritet me ritme të ngjashme me ato të periudhave të kaluara, ndërkohë që sipërfaqja mesatare e lejeve të reja të ndërtimit është rritur. Teprica e kredisë bankare për ndërtim e drejtuar për bizneset nuk ka treguar ndryshime gjatë periudhës, ndërsa kostot e ndërtimit janë rritur, kryesisht për shkak të rritjes në shpenzimet për paga dhe energji.

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase dhe në euro ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Gjatë periudhës është regjistruar rritje e vlerës dhe numrit të transaksioneve në sistemet e pagesave. Sipas instrumenteve të pagesave, përdorimi i kartave për kryerjen e pagesave ka vijuar të rritet në mënyrë të ndjeshme dhe aktualisht pagesat me kartë zënë peshën kryesore në pagesat e kryera.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, pesha e aktiveve të sistemit financiar³ ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me 2 pikë përqindje, në nivelin 93.9%. Në terma vjetorë, ky tregues ka rënë me 2.6 pikë përqindje, dhe kjo lidhet me faktin që norma vjetore e rritjes së PBB-së ishte më e lartë në krahasim me atë të rritjes së bilancit të sistemit financiar. Në këtë rënie, sektori bankar ka kontribuar me pothuaj 3 pikë përqindje. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me gati 91% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe ka shënuar rritje gjatë periudhës. E gjithë rritja e bilancit të sektorit bankar për vitin 2023, prej rreth 5%, u përqendrua në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Në zgjerimin e aktivitetit të sektorit bankar kontribuuan së bashku, investimet në tituj, kreditimi dhe veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare. Në krahasim me pasivitetin, në këtë ecuri kontribuuan rritja e depozitave të publikut dhe rritja e kapitalit. Gjatë periudhës, efekti statistikor negativ i mbiçmimit të lekut ndaj monedhave të huaja mbi treguesit e bilancit të sektorit bankar, ishte më i zbutur. Megjithatë, ai vlerësohet të ketë ndikuar negativisht në vlerën e bilancit për rreth 30 miliardë lekësh. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka mbetur e qëndrueshme në 50-51%. Pozicioni kreditor neto i sektorit bankar ndaj jorezidentëve mbeti pranë nivelit 19%. Indeksi i shëndetit bankar tregon për një përmirësim të gjendjes së sektorit gjatë periudhës, falë rritjes së ndjeshme në rezultatin financiar. Në periudhën 2014-2023, indeksi ka treguar përmirësim të gjendjes së sektorit bankar, me kontributin kryesor nga përmirësimi në cilësinë e aktiveve dhe nivelet e kapitalizimit.

Teprica e kredisë u rrit me 4% gjatë periudhës dhe me rreth 3% në terma vjetorë. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht rritja e kredisë në lekë dhe e asaj për prona të paluajtshme për individë e biznese. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e kredisë do të ishte rreth 8%. Ristrukturimet e kredive dhe largimet nga bilanci të kredive të humbura kanë vijuar. Vëllimet e ristrukturimeve u rritën, ndërsa ato të fshirjeve treguan rënie. Teprica e kredisë së pambrojtur në valutë ka shënuar rënie si në terma gjashtëmujorë, ashtu edhe në krahasim me një vit më parë. Kjo rënie vërehet në vlerë absolute dhe relative, madje konstatohet

³ Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar. Baza e të dhënave për sektorin bankar, shoqëritë e kursim-kreditit, institucionet financiare jobanka dhe fondet e pensionit i përket tremujorit të katërt 2023, kurse për segmentet e tjera përfshirë PBB-në i përket tremujorit të tretë të vitit 2023.

edhe kur ky portofol shprehet në monedhë origjinale. Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rënia në kredinë e pambrojtur në valutë për individët. Kredia e pambrojtur në valutë për bizneset është tkurrur lehtë. Kredia e re e dhënë gjatë periudhës ishte dukshëm më e lartë se ajo e një viti më parë. Ajo pasqyron një performancë më të mirë të kredisë në lekë, ndërsa fluksi i kredisë në euro ka rënë nga viti i kaluar. Kredia e re e akorduar individëve u rrit në terma vjetorë dhe qëndroi e pandryshuar gjatë periudhës. Kjo kredi ka shkuar kryesisht për blerjen e pasurive të paluajtshme. Në tërësi, gjatë periudhës bankat kanë qenë të kujdesshme në dhënien e kredisë së re, duke ruajtur norma të qëndrueshme të refuzimit të aplikimeve. Norma e peshuar e interesit për të gjitha kreditë e reja të akorduara gjatë periudhës mbeti pothuajse e pandryshuar, në 6.3%. Normat e interesit për kreditë e reja në lekë kanë rënë dhe niveli i tyre është më i ulët se norma e interesit për kreditë e reja në euro.

Depozitat u zgjeruan gjatë periudhës dhe në terma vjetorë, duke ruajtur strukturën e tyre. Rritja lidhet me zgjerimin e llogarive rrjedhëse të individëve dhe të bizneseve, dhe të depozitave me afat të individëve. Kjo rritje është e shpërndarë në mënyrë të balancuar midis depozitave në lekë dhe valutë. Rritja e regjistruar gjatë periudhës dhe në terma vjetorë ishte rreth 6-7% dhe në fund të vitit, depozitat arritën në 1,600 miliardë lekë. Në terma vjetorë, depozitat në lekë u zgjeruan me 7%, ndërsa depozitat në valutë me 5%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë rezultoi rreth 14%. Rritja e depozitave në lekë është mbështetur nga zgjerimi i llogarive rrjedhëse të individëve dhe bizneseve, ndërsa rritja e depozitave në valutë pasqyron rritjen e depozitave me afat të individëve dhe llogarive rrjedhëse të të dy sektorëve. Normat e interesit të depozitave të reja kanë vijuar të rriten, ndërsa flukset e depozitave të reja në valutë gjatë periudhës, janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me periudhat e mëparshme.

Spektori bankar e mbylli vitin 2023 me një nivel të mirë të kapitalizimit të veprimtarisë. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit rezultoi 19.4%, duke u rritur me 0.4 pikë përqindje gjatë periudhës, dhe me 1.3 pikë përqindje në terma vjetorë. Në rritjen e këtij treguesi ka kontribuar rritja e vlerave të kapitalit rregullator. Bankave iu kërkohet të përmbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit, ku përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe ato për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL). Me qëllim forcimin e pozitave të kapitalit gjatë periudhës, bankat kanë rritur rezervat nga fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Në fund të periudhës, sektori bankar në tërësi arriti t'i përmbushte këto kërkesa sipas kalendarit të përcaktuar, dhe të regjistronte një tepicë kapitali pozitive.

Rezultati neto dhe treguesit e përfitueshmërisë së sektorit bankar kanë shënuar rritje të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së konsiderueshme në të ardhurat neto nga interesat. Fitimi i akumuluar neto i sektorit bankar për vitin 2023 ishte rreth 32 miliardë lekë ose rreth 50% më i lartë se një vit më parë. Rritja e fitimit është pasqyruar në tregues më të lartë mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar, ku kthimi nga aktivet (RoA) rezultoi 1.7% dhe kthimi nga kapitali (RoE) 17.3%. Krahas të ardhurave neto nga interesat, rritje kanë shënuar edhe të ardhurat jo nga interesat, që kanë reflektuar një performancë më të mirë të investimeve në instrumentet financiare. Një efekt negativ në rezultatin financiar të sektorit bankar dha rritja e provigjioneve të përgjithshme, të ndikuara nga rritja e provigjioneve për rrezikun e kredisë. Performanca shumë më e mirë e të ardhurave në krahasim me rritjen e shpenzimeve të veprimtarisë ka përmirësuar nivelin e mbulimit të këtyre të fundit. Rritja e fitimit të bankave përfaqëson një mundësi shumë të mirë për të përdorur pjesën më të madhe të tij për fuqizimin e pozicioneve të kapitalit në mënyrë që t'iu paraprihet kërkesave rregullative të planifikuara për nivelet e ardhshme të kapitalizimit.

Në tërësi, ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar në vend kanë treguar një qëndrueshmëri të mirë ndaj rreziqeve të periudhës, por sfidat mbeten të pranishme. Rritja e qëndrueshme ekonomike, performanca shumë e mirë e turizmit, përmirësimet në tregun e punës, konsolidimi fiskal, rënia e normës

së inflacionit dhe ecuria e mirë e balanceve të institucioneve financiare janë zhvillime që, së bashku, kontribuojnë në qëndrueshmërinë e kuadrit makroekonomik të vendit dhe në stabilitetin financiar. Këto zhvillime konfirmohen edhe nga treguesit e Hartës së Stabilitetit, e cila reflekton rreziqe më të ulëta dhe relativisht të kontrolluara pothuaj në të gjithë faktorët e ekonomisë së brendshme. Nga ana tjetër, zhvillimet ekonomike ndërkombëtare kanë qenë pozitive, por ato po ndodhin në kushtet e pasigurisë së lartë prej tensioneve gjeopolitike. Në vrojtimin periodik që kryhet me bankat, ky faktor është evidentuar prej tyre si burimi kryesor i rrezikut, i ndjekur prej ndjeshmërisë nga sulmet potenciale kibernetike. Paralelisht, sektori bankar duhet të ruajë një monitorim të kujdesshëm për ekspozimet e tij në tregun e pasurive të paluajtshme, për hendeqet në afatet e maturimit mes aktiveve dhe pasiveve, dhe për ndikimet nga lëvizjet në normën e interesit. Në zbatim të politikës makroprudenciale, në muajin tetor, Banka e Shqipërisë miratoi një rregullore të veçantë e cila synon të përmirësojë informacionin që mblidhet nga bankat për standardet që zbatohen për ekspozimet e tyre në formën e kredisë dhe investimeve në prona të paluajtshme (rezidenciale dhe tregtare). Në të njëjtën kohë, kjo rregullore i jep Bankës së Shqipërisë të drejtën për t'i përdorur treguesit e këtyre standardeve si instrumente të politikës makroprudenciale, me qëllim administrimin e rreziqeve nga të tilla ekspozime. Në tërësi, vlerësohet e rëndësishme që politikat ekonomike ta përdorin këtë periudhë të favorshme në zhvillimet ekonomike e financiare, për të konsoliduar arritjet dhe për të reformuar ekonominë me qëllim vendosjen e saj në një shtrat zhvillimi të qëndrueshëm.

Në terma të rreziqeve më specifike për veprimtarinë e sektorit bankar vlerësohet se:

Gjatë periudhës, cilësia e kredisë vijoi të përmirësohej në kushtet e rënies së stokut të kredive me probleme. Kjo rënie, e shoqëruar me rritjen e përgjithshme të stokut të kredisë, rezultoi në rënie e raportit të kredive me probleme me 0.5 p.p. në nivelin 4.7%. Ky përmirësim është vënë re në të gjitha portofolet e kredisë, por ka qenë më i dukshëm në portofolin e kredisë në monedhë të huaj, në kredinë afatgjatë dhe në kredinë për bizneset. Për kredinë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet e kursit të këmbimit, cilësia e kredisë ka rënë lehtë në krahasim me një vit më parë. Rënia e kredive me probleme lidhet me riklasifikimin e kredive me probleme në klasa më të mira, fshirjen e kredive të humbura, si dhe shlyerjen e një pjese të kredive me probleme. Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme u rrit deri në nivelin 71%, ndërsa mbulimi me kolateral i tepricës së kredisë ka rënë lehtë.

Rreziku i likuiditetit të sektorit bankar mbetet i ulët dhe treguesit e likuiditetit vijojnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë rregullativë. Hendeku negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj është ngushtuar lehtë, ndërsa hendeku i përgjithshëm mbetet pozitiv, në vlera të afërta me periudhat e kaluara. Diferenca midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve ka rënë si pasojë e rënies në maturitetin mesatar të aktiveve dhe rritjes së maturitetit mesatar të pasiveve. Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, bankat kanë një vëllim disi më të lartë aktiveve likuide në raport me aktivet e përgjithshme dhe detyrimet afatshkurtra. Por, përqendrimi i aktiveve likuide në tituj të borxhit të qeverisë shqiptare mbetet i lartë dhe evidenton rëndësinë për zhvillimin e tregut ku tregtohen këta tituj.

Elementet e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të tregut kanë qenë të kontrolluara. Pavarësisht rritjes së lehtë në treguesin e pozicionit të hapur valutë të bankave, ekspozimi i sektorit bankar ndaj *rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit* mbetet i kufizuar. Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i cili merr në konsideratë dhe kredinë e rezidentëve në valutë, ka ardhur në rënie. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë *të normës së interesit* ka shënuar rënie gjatë periudhës, siç paraqitet nga treguesi përkatës, i cili mbetet ndjeshëm nën kufirin e sipërm rregullator. Sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në lekë, ato me normë interesi të ndryshueshme dhe për maturitetin afatgjatë. Për shkak të ekspozimeve me normë interesi të ndryshueshme,

efekti i tërthortë i ndikimit të lëvizjeve të normës së interesit në cilësinë e këtyre ekspozimeve duhet monitoruar në mënyrë të vazhdueshme.

Rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës mbështesin vlerësimet për gjendjen e mirë financiare të sektorit bankar dhe evidentojnë një ulje të ndjeshmërisë ndaj skenarëve të supozuar të stresit. Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve nga ekonomia reale ose tregjet financiare në një horizont afatmesëm, Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike ushtrimet e provës së rezistencës. Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit ose aftësinë paguese tregon shkallën e rezistencës së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë përshtatshmërinë e tij në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike, kredinë, nivelet e kursit të këmbimit dhe normat e interesit. Prova e rezistencës së likuiditetit vlerëson aftësinë e bankave për të përballuar goditje me natyrë ekstreme mbi gjendjen e likuiditetit dhe kapacitetin e tyre për të shitur aktivet likuide. Edhe ky ushtrim paraqet një situatë mjaft të përmirësuar në krahasim me një vit më parë, si në nivel banke, ashtu edhe në nivel sektori.

Në tërësi, këto ushtrime të kryera për fundin e vitit 2023 dhe të shtrira në periudhën 2024-2025, tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike të supozuara. Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar dukshëm në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit në skenarët më pak të favorshëm është më i vogël. Sfidat për veprimtarinë e sistemit financiar dhe të sektorit bankar mbeten të pranishme, në kushtet e pasigurisë që ruajnë zhvillimet ndërkombëtare dhe të brishtësive që shoqërojnë zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit.

Si rezultat, është e nevojshme që në afat të mesëm bankat të forcojnë sistemet e përgjithshme të kontrollit dhe të rrisin investimet për të garantuar qëndrueshmërinë dhe përdorimin e sigurt të teknologjive që përdorin. Rritja e fitimit të bankave gjatë vitit 2023 përfaqëson një mundësi shumë të mirë për të fuqizuar investimet e nevojshme në këto drejtime dhe në përgjithësi për të forcuar treguesit e qëndrueshmërisë.

Si zakonisht, Banka e Shqipërisë do të monitorojë me kujdes zhvillimet në sektorin bankar dhe në treguesit makroekonomikë e financiarë. Mbi bazën e një komunikimi të ngushtë me industrinë bankare, autoritetet e tjera publike dhe me institucionet financiare ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë do të veprojë në mënyrë proaktive për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe financiar.

1. Zhvillimet makroekonomike

1.1 Harta e stabilitetit financiar


Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2023, rreziqet e monitoruara nga Harta e Stabilitetit Financiar kanë qenë në nivele të përmbajtura dhe shfaqen përgjithësisht në zbutje.

Krahasuar me një vit më parë, kjo ecuri është diktuar nga zhvillimet ekonomike të brendshme dhe të jashtme, si dhe sektori i qeverisë. Nivelet e rrezikut nga sektori i individëve dhe bizneseve nuk kanë shfaqur ndryshime duke mbetur në nivele të ulëta.

Edhe rreziqet e veprimtarisë bankare vlerësohen të kontrolluara dhe në rënie, ndikuar nga përmirësimi i përfitueshmërisë dhe nivelet e mira të likuiditetit dhe kapitalizimit.

Harta e stabilitetit financiar tregon një nivel të përmbajtur dhe përgjithësisht në rënie të rreziqeve nga mjedisi makroekonomik. Në krahasim me një vit më parë, vërehet një zbutje e mëtejshme e nivelit të përgjithshëm të rreziqeve të lidhura me zhvillimet në ekonominë e brendshme, sektorin e qeverisë dhe mjedisin e jashtëm. Në të njëjtën kohë, nivelet e vlerësuara të rrezikut për sektorët e individëve dhe të bizneseve kanë mbetur në nivele të ngjashme me një vit më parë, por me një prirje për rritje në sektorin e individëve. Rreziqet lidhur me veprimtarinë e sektorit bankar kanë rezultuar gjithashtu në rënie gjatë periudhës, veçanërisht për shkak të kontributit të treguesve të kapitalizimit dhe përfitueshmërisë.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreziqet në mjedisin e përgjithshëm ekonomik


Rreziku që buron nga ekonomia e brendshme ka rënë nën nivelin "mesatar" gjatë periudhës, ndikuar nga ecuria pozitive e pothuajse gjithë nëntreguesve përbërës. Përmirësimi pasqyron kryesisht zbutjen e nevojave për financim të jashtëm, si rezultat i përmirësimit të bilancit të pagesave, mbiçmimit të kursit të këmbimit dhe rënies së normës së inflacionit.

Rreziku nga mjedisi i jashtëm ka vijuar të zbutet gjatë gjithë vitit 2023. Kjo ecuri është ndikuar nga rënia e normave të papunësisë në vendet që janë burimi kryesor i dërgesave të emigrantëve shqiptarë dhe rënia e çmimeve të naftës gjatë periudhës. Këta faktorë kanë balancuar rritjen e rrezikut nga ngadalësimi ekonomik i disa prej partnerëve kryesorë tregtarë të vendit tonë dhe rritja e normave afatshkurtra të interesit në tregjet ndërkombëtare.

Rreziqet e lidhura me veprimtarinë e agjentëve të ekonomisë reale⁴

Rreziku nga sektorët e individëve dhe bizneseve mbetet "i ulët", por me prirje rritëse nga një vit më parë për sektorin e individëve dhe rënësë për sektorin e bizneseve. Niveli i përgjithshëm i rrezikut nga sektori i individëve është rritur lehtë, si pasojë e zhvillimeve në çmimet e tregut të banesave dhe ngadalësimit vjetor të dërgesave të emigrantëve. Nga ana tjetër, përmirësimi i pritjeve të individëve dhe rritja e niveleve të kredisë në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), kanë pasur një kontribut zbutës në nivelin e përgjithshëm të rrezikut për këtë sektor. Për sektorin e bizneseve, niveli i rrezikut ka rezultuar disi më i ulët krahasuar me një vit më parë, diktuar kryesisht nga përmirësimi i indeksit të gjendjes financiare, që ka zbutur rritjen e rrezikut nga përkeqësimi i treguesit të pritshmërisë së bizneseve. Rreziku nga *qeveria* vlerësohet gjithashtu i "ulët" dhe në rënie krahasuar me një vit më parë, falë kurrjes së peshës së borxhit publik ndaj PBB-së, rënies së primit të rrezikut sovran dhe ecurisë së mirë të të ardhurave buxhetore, që kanë balancuar rritjen e kostos së borxhit gjatë periudhës.

Grafik 2. Ndryshimi vjetor në notën e rrezikut sipas sektorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Vlerësimet për rrezikun nga "Qeveria" janë kryer duke u bazuar në të dhënat zyrtare për tremujorin e tretë (T3) 2023.

Rreziqet e lidhura me veprimtarinë e sektorit bankar

Rreziku nga kapitalizimi dhe përfitueshmëria vlerësohet në nivelin "i ulët" dhe në rënie krahasuar me një vit më parë, diktuar kryesisht nga rritja e ndjeshme e të ardhurave të sektorit bankar dhe përmirësimi i treguesve të kapitalit. Rreziku nga likuiditeti dhe financimi ka rezultuar në nivelin "mesatar" dhe i pandryshuar krahasuar me një vit më parë, ndikuar nga efekti zbutës i rritjes së depozitave të individëve dhe rënies së nivelit të financimit nga jorezidentët (që është gjithsesi shumë i ulët). Rreziku që

⁴ Vlerësimet janë kryer duke u bazuar në vlerat më të fundit zyrtare të publikuara që i përkasin tremujorit të tretë, 2022.

lidhet me strukturën e sektorit bankar ka mbetur gjithashtu në nivelin "mesatar" dhe me rënie të lehtë falë përmirësimit të treguesve të përqendrimit të kredisë dhe natyrës së burimeve të financimit të sektorit bankar.

1.2 Mjedisi makroekonomik i jashtëm

Aktiviteti ekonomik botëror është zgjeruar gjatë periudhës. Zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregun e punës, ecuria e mirë në sektorin e shërbimeve dhe mbështetja fiskale në rajonet e zhvilluara, mbështetën ecurinë e mirë të konsumit dhe të investimeve private pavarësisht kushteve më të shtrënguara monetare.

Presionet inflacioniste kanë rënë më shpejt nga pritjet në shumicën e rajoneve, si pasojë e normalizimit të politikës monetare, efektit bazë dhe rënies së çmimeve veçanërisht në tregjet e energjisë.

Ekonomia botërore pritet të vijojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme por të ngadaltë gjatë periudhës 2024-2025, e kryesuar nga rajonet në zhvillim.

Niveli i pasigurisë mbetet i lartë dhe i ndikuar nga shpejtësia e rënies të inflacionit, kostot ekonomike të konsolidimit fiskal të orientuar drejt uljes së borxhit, përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike të cilat mund të gjenerojnë goditje të reja ndaj zinxhirëve të prodhimit, si dhe ndryshimet strukturore të nxitura nga ndryshimet e klimës dhe teknologjisë.

Ekonomia e Eurozonës u karakterizua nga mungesa e rritjes në gjysmën e dytë të

Ekonomia botërore ka vijuar të rritet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, me ritëm me të ulët por të qëndrueshëm. Rimëkëmbja e ekonomisë botërore, pas pandemisë dhe efektit fillestar të luftës së Rusisë në Ukrainë mbi koston e jetesës, ishte e ndjeshme dhe u mbështet kryesisht nga rritja ekonomike në SHBA dhe një pjese të mirë të vendeve të mëdha në zhvillim, ndërkohë që ecuria ekonomike e Evropës rezultoi më e dobët. Zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregun e punës, ecuria e mirë në sektorin e shërbimeve dhe mbështetja fiskale në rajonet e zhvilluara, mbështetën ecurinë e mirë të konsumit dhe të investimeve private pavarësisht kushteve më të shtrënguara monetare. Zinxhirët botërorë të prodhimit dhe shpërndarjes vijuan të normalizohen deri në tremujorin e tretë të vitit, por shqetësimet rreth tyre u rishfaqen në tremujorin e fundit të vitit 2023 pas rindezjes së konfliktit izraelo-palestinez dhe mundësisë së zgjerimit të tij në Lindjen e Mesme. Pasiguria që shoqëron zhvillimet gjeopolitike mbetet e lartë dhe do të ketë një efekt frenues në aktivitetin ekonomik global. Ecuria e treguesve makroekonomikë thekson pritjet për një rritje të dobët në gjysmën e parë të vitit 2024, ndikuar nga tkurrja e prodhimit dhe investimeve, si dhe kushtet ende të shtrënguara të financimit në shumicën e vendeve.

Inflacioni ka rënë më shpejt nga sa pritej në shumicën e rajoneve të botës. Në rang global, në tremujorin e fundit të vitit 2023, nivelet e inflacionit bazë dhe atij total ranë pranë niveleve mesatare të periudhës së para-pandemisë. Në këtë ecuri, kanë ndikuar dinamikat më të favorshme të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht për energjinë, dhe kushtet më të shtrënguara monetare. Megjithatë, presionet inflacioniste kanë mbetur të rëndësishme për shkak të efektit pozitiv që ka ardhur prej përmirësimeve në tregjet e punës. Si rezultat, ndonëse kanë ndaluar rritjen e normave të interesit në tremujorin e fundit të vitit 2023, bankat qendrore të vendeve me ekonomi të zhvilluar kanë theksuar angazhimin për të kthyer normën e inflacionit në nivelet që kanë si objektivi.

Në tregjet financiare, kushtet e financimi kanë qenë përgjithësisht të shtrënguara gjatë periudhës, por shpejtësia e frenimit të inflacionit ka forcuar pritjet e investitorëve për një lehtësim të mundshëm të politikës monetare. Kjo ka sjellë përmirësim të dinamikës në tregjet e kapitalit dhe rritjen e vlerave në bursat kryesore. Nivelet e *yield*-eve të titujve të borxhit në tregjet e zhvilluara kanë mbetur relativisht të larta. Kredia bankare ka rënë në nivel global, si rezultat i rënies së kërkesës, ndërkohë që rritja e kostove të huamarrjes ka nisur të reflektohet në rënie të cilësisë së kredisë në segmente të caktuara të tregut. Në tregjet

vitet 2023, duke reflektuar dobësimin e kërkesës së jashtme dhe tkurrjen e prodhimit dhe investimeve në kushtet e rritjes së kostove të financimit. Normat e inflacionit erdhën në rënie, por mbeten mbi objektivin e Bankës Qendrore Evropiane. Kjo e fundit ka vijuar me normalizimin e politikës monetare, duke realizuar rritjen e fundit në shtator 2023. Transmetimi i fortë monetar është pasuar me rritjen në tërësi të normave të interesit në treg dhe rënien e kërkesës për kredi.

Megjithë pasigurinë, rritja ekonomike e Eurozonës pritet të rigjallërohet gradualisht gjatë këtij viti, ndërsa presionet inflacioniste pritet të lehtësohen dhe norma e inflacionit të rikthehet në objektivin e BQE-së në vitin 2025.

e këmbimit të monedhave, dinamikat kanë qenë të luhatshme dhe të ndikuara nga pritjet e tregut mbi efektet e politikës monetare shtrënguese të bankave qendrore, diferencat në rimëkëmbjen ekonomike mes rajoneve dhe përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike. Vlera e monedhës Euro është luhatur gjatë periudhës duke shfaqur një prirje të lehtë mbiçmuese ndaj dollarit amerikan, por duke u nënçmuar ndaj monedhave të tjera kryesore si franga zvicerane, jeni japonez, paundi britanik dhe monedhat e një pjese të rajoneve të mëdha në zhvillim.

Me gjithë normalizimin e zinxhirëve të shpërndarjes, çmimet e lëndëve të para dhe të ushqimeve kanë vijuar të bien dhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, ndikuar nga një kërkesë më e dobët.

Në tregjet e naftës dhe të lëndëve të para djegëse zhvillimet kanë qenë të luhatshme. Pas një periudhe ku çmimet e naftës pësuan rënie, ato u rritën në fund të vitit për shkak të shqetësimeve lidhur me tensionet në Lindjen e Mesme dhe sulmet ndaj anijeve transportuese në Detin e Kuq. Nga ana tjetër, çmimet e gazit natyral në Evropë kanë ardhur në rënie, si rezultat i rënies së kërkesës nga një kombinim faktorësh (dimri i butë, ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve, aktivitetet me i dobët industrial) dhe rritjes së mëtejshme të rezervave të gazit. Çmimet e ushqimeve dhe lëndëve të para jo energjetike gjithashtu kanë ndjekur një trajektore rënëse gjatë periudhës.

Parashikimet e ekspertëve sugjerojnë një rritje të qëndrueshme, por të ngadaltë gjatë periudhës 2024 - 2025, duke mbetur nën mesataren historike të para pandemisë, ndikuar nga rritja e kostove të financimit, mbyllja e programeve të mbështetjes fiskale dhe produktiviteti i ulët. Sipas FMN-së⁵, rritja ekonomike e vendeve të zhvilluara pritet të ngadalësohet në 1.5% gjatë vitit 2024 (nga 1.6% në vitin 2023) dhe të zgjerohet me 1.8% në vitin 2025, me rimëkëmbjen ekonomike të Eurozonës nga nivelet e ulëta të vitit të kaluar dhe moderimin e aktivitetit në SHBA. Ekonomitë në zhvillim parashikohet të rriten në mënyrë të qëndrueshme, duke mbetur në nivelet 4.1%-4.2%, por me dallime mes rajoneve. Megjithë skenarët e ndryshëm të rrezikut, normat e inflacionit pritet të vijojnë rënien gjatë periudhës në vazhdim. Rënia parashikohet të jetë më e shpejtë në vendet e zhvilluara krahasuar me ato në zhvillim dhe e diktuar kryesisht nga politikat ende të shtrënguara të bankave qendrore, zbutja e presioneve në tregun e punës dhe efekti i rënies së çmimeve të energjisë.

FMN-ja parashikon që inflacioni në shkallë botërore do të bjerë mesatarisht nga niveli 6.8% në vitin 2023, në 5.8% dhe 4.4%, respektivisht në vitet 2024 dhe 2025. Rreziqet afatshkurtra ndaj perspektivës së ekonomisë botërore vlerësohen të balancuara në kushtet e frenimit të inflacionit dhe neutralizimit të goditjeve në kahun e ofertës. Gjithsesi, niveli i pasigurisë mbetet i lartë dhe i ndikuar nga rreziqe që lidhen me ecurinë e ardhshme të inflacionit, kostot ekonomike të konsolidimit fiskal me synim uljen e niveleve të borxhit, përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike të cilat mund të gjenerojnë goditje të reja ndaj zinxhirëve të prodhimit, si dhe me ndryshimet strukturore të nxitura nga ndryshimet e klimës dhe teknologjisë.

⁵ Në parashikimin e muajit janar 2024, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vlerëson që zgjerimi i ekonomisë botërore do të rezultojë 3.1% në vitin 2024 dhe do të rritet në 3.2% në vitin 2025 (*World Economic Outlook, update*).

Eurozona

Ekonomia e Eurozonës hyri në një fazë stanjacioni në gjysmën e dytë të vitit 2023. Aktiviteti u tkurr me 0.1% në tremujorin e tretë të vitit (rritje 0% në terma vjetore), ndërkohë që vlerësimet paraprake të treguesve dëshmojnë se nuk pa pasur rritje në tremujorin e katërt të tij (rritje me 0.1% në terma vjetore). Kjo ecuri ka reflektuar dobësimin e tejzgjatur të tregtisë botërore, ngadalësimin e prodhimit dhe investimeve ndikuar nga rritja e kostove të financimit, ndërkohë që efekti i shtrëngimit të politikës monetare të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) ka vijuar të transmetohet në ekonomi. Ekspertët parashikojnë që ekonomia e Eurozonës do të hyjë gradualisht në fazën e rritjes gjatë vitit 2024, mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit të brendshëm dhe forcimit të kërkesës së jashtme, ndërkohë që presionet inflacioniste do të vijojnë të bien.

Me gjithë luhatjet, norma mesatare e inflacionit ka rënë në mënyrë të qëndrueshme. Ajo shënoi 2.4% në muajin nëntor dhe 2.9% në muajin dhjetor 2023. Dinamikat e inflacionit janë diktuar kryesisht nga ecuria e çmimeve të energjisë, rënia e mëtejshme e inflacionit të ushqimeve dhe efekti i bazës krahasuese. Faktorët e jashtëm të inflacionit kanë kontribuar negativisht gjatë periudhës, ndërkohë që edhe efekti i faktorëve të brendshëm është moderuar. Në tregun e punës, dinamikat kanë qenë pozitive, por me diferenca mes sektorëve. Norma e papunësisë u stabilizua në 6.5% gjatë periudhës, ndërsa presionet mbi rritjen e pagave u zbutën disi në muajt e fundit të vitit.

Në tregjet financiare evropiane, normat e interesit janë shfaqur të qëndrueshme. Në vijim të dobësimit të presioneve inflacioniste, BQE ka ndaluar rritjen e normës bazë që nga muaji shtator 2023, gjë që ka rritur pritjet e tregut për përmbylljen e fazës së shtrëngimit monetar. Si rezultat, me përjashtim të disa luhatjeve të nxitura nga ecuria e *yield*-eve në tregjet amerikane, vlerat dhe *spread*-et në tregjet evropiane kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme, veçanërisht në fund të vitit. Nga ana tjetër, transmetimi i fortë i politikës monetare ka sjellë shtrëngim të mëtejshëm të standardeve të kreditimit ndaj familjeve dhe bizneseve dhe tkurrje të kërkesës për kredi, gjë që pritet të shtrihet dhe në tremujorin e parë të vitit 2024. Në fund të vitit normat e kredisë për bizneset shënuan një rënie të lehtë, çka mund të sinjalizojë një pikë kthese.

Sipas parashikimeve më të fundit të publikuara nga BQE, aktiviteti ekonomik në Eurozonë pritet të rigjallërohet gradualisht gjatë vitit 2024. Kjo ecuri do të mbështetet nga rritja e të ardhurave të disponueshme, si rezultat i rritjes së qëndrueshme të pagave dhe dobësimit të presioneve inflacioniste, duke kompensuar kështu tërheqjen graduale të masave mbështetëse fiskale. Në të njëjtën kohë, eksportet evropiane pritet të rigjallërohen me forcimin e kërkesës së jashtme dhe normalizimin e mëtejshëm të zinxhirëve të tregtisë. Këto parashikime mbeten të rrethuara nga një nivel i lartë pasigurie, lidhur me tensionet gjeopolitike, dinamikat e ofertës së lëndëve të para dhe zhvillimet në tregun e punës. Normat e inflacionit pritet të vijojnë të bien dhe të rikthehen brenda nivelit 2% në vitin 2025. Deri atëherë, BQE-ja ka deklaruar se mbetet e angazhuar në misionin e saj për të rikthyer inflacionin brenda objektivit të synuar, duke ruajtur njëkohësisht stabilitetin ekonomik dhe financiar të rajonit.

Tabelë 1. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)			Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	2023*	T3'23	T4'23**	Sht'23	Dhj'23	Sht'23	Dhj'23	T2'22	T3'23
SHBA	2.5	2.9	3.1(0.8)	3.7	3.4	3.8	3.7	119.5	120.1
Eurozonë	0.5	0.0	0.1(0.0)	4.3	2.9	6.5	6.5	90.4	90.0
Gjermani	-0.3	-0.3	-0.2(-0.3)	4.3	3.8	3.1	3.1	64.7	64.8
Francë	0.8	0.6	0.7(0.0)	5.7	4.1	7.3	7.3	111.8	111.9
Itali	0.7	0.5	0.6(0.2)	5.6	0.5	7.5	7.2	142.5	140.6
Greqi	:	2.1	1.2(0.2)	2.4	3.7	10.2	10.4	167.1	165.5

Burimi: BQE, Eurostat, *-vlerësim i FMN-së (Korrik 2023), Zyra e Analizave Ekonomike; Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labor Statistics); “: mungesë informacioni.

**Në kllapa janë vendosur shifrat e rritjes tremujore të PBB-së.

Në Ballkanin Perëndimor, ekonomia është rritur me norma të kënaqshme dhe më të shpejta krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka sjellë përmirësim të bilanceve fiskale dhe ulje të borxhit publik. Në sektorin e jashtëm, llogaria korrente është përmirësuar ndjeshëm në të gjitha vendet.

Shtrëngimi i politikës monetare gjatë vitit të kaluar ka dhënë efektet e veta në rënien e mëtejshme të normave të inflacionit dhe ngadalësimin e rritjes së kredisë.

Cilësia e kredisë në rajon ka mbetur e qëndrueshme dhe raportet e kredive me probleme janë në nivele relativisht të ulëta.

Ballkani Perëndimor

Ekonomia e vendeve të Ballkanit Perëndimor u rrit mesatarisht me 3.1% në tremujorin e tretë të vitit 2024 krahasuar me një vit më parë (nga 2% në tremujorin paraardhës).

Pothuajse të gjitha vendet regjistruan rritje pozitive të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), mbështetur kryesisht nga forcimi i kërkesës së brendshme dhe rritja e eksporteve të shërbimit të përqendruara në aktivitetin e turizmit. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik, kontribuoi në rritjen e të ardhurave buxhetore dhe përmirësimin e bilanceve fiskale, ndërkohë që vende si Kosova dhe Mali i Zi kanë regjistruar teprica pozitive buxhetore. Kjo ecuri ka krijuar hapësirë për uljen e mëtejshme të borxhit publik në raport me PBB-në në gjithë rajonin, ku Mali i Zi dhe Shqipëria shënojnë nivelet më të larta, respektivisht 60.2% dhe 59.2%.

Në sektorin e jashtëm, llogaria korrente ka vijuar të përmirësohet në të gjitha vendet dhe deficitin e saj në nivel rajoni në fund të tremujorit të tretë u përgjysmua krahasuar me një vit më parë. Kjo ecuri u mbështet gjerësisht nga rritja e qëndrueshme e eksportit të shërbimeve, rritja e dërgesave të emigrantëve dhe ngushtimi i deficitit tregtar si pasojë e rënies së çmimeve të importit. Presionet inflacioniste janë zbutur diktuar nga rënia e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Normat e inflacionit në fund të vitit kanë rënë, duke u luhatur nga 2.3% në Kosovë, në 8% në Serbi, dhe shpejtësia e normalizimit të politikës monetare përgjithësisht është ngadalësuar në të gjithë rajonin.

Me përjashtim të Serbisë, aktiviteti kreditues ka vijuar të zgjerohet në të gjitha vendet e rajonit, por me ritëm disi më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë. Shtrëngimi i politikës monetare nga bankat qendrore të rajonit është transmetuar në rritje të kostos së kredisë bankare, duke frenuar disi rritjen e saj në shumicën e vendeve. Pavarësisht kësaj ecurie, rritja e kredisë mbetet pozitive dhe në vlera të mira. Raporti i kredive me probleme është shfaqur i qëndrueshëm dhe në vlera relativisht të ulëta. Pavarësisht pritjeve, rritja e normave të interesit nuk ka shfaqur ende një ndikim të dukshëm negativ në cilësinë e kredisë.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (në %)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në%)	
	T2'23	T3'23	2024p	T2'23	T3'23	T3 23	T4'23*	T3'23	T4'23*
Bosnje-Hercegovinë	1.2	1.9	2.0	13.1	13.6	5.0	6.1	4.1	:
Maqedoni e Veriut	1.1	1.2	2.7	13.2	12.9	5.9	5.2	2.7	2.7
Mali i Zi	6.9	6.6	2.7	13.5	12.0	10.0	10.8	5.0	4.8
Kosovë	2.4	3.0	:	10.8		13.5	13.4	2.0	2.0
Serbi	1.6	3.6	3.1	9.6	9.0	0.3	-0.4	3.2	3.2

Shqipëri**	3.4	3.5	3.8	11.1	10.7	0.8	3.4	5.2	4.7
------------	-----	-----	-----	------	------	-----	-----	-----	-----

Burimi: Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse, INSTAT. Shpjegime: 'p'- parashikimi i ECFIN në Janar, 2024 '!' mungesë informacioni; "*" të dhënat të muajit nëntor, 2023, "***" të dhënat të muajit dhjetor 2023.

1.3 Mjedisi makroekonomik në vend

Në terma vjetorë, ekonomia shqiptare u zgjerua me 3.8% deri në fund të tremujorit të katërt të vitit.

Rritja ekonomike ka pasur një bazë të gjerë sipas sektorëve, por kontributin më të fortë në rritje e dha sektori i shërbimeve.

Nga ana e kërkesës, aktiviteti ekonomik u mbështet nga konsumi final, investimet e sektorit privat, dhe ngushtimi i deficitit të llogarisë korrente.

Tregu i punës u karakterizua nga zhvillime pozitive si rritja e punësimit, rënia e normës së papunësisë dhe rritja e pagave në sektorin privat dhe atë shtetëror.

Sektori real dhe tregu i punës

Në fund të tremujorit të fundit të vitit, norma e rritjes vjetore të ekonomisë ishte rreth 3.8%⁶. Nga këndvështrimi sektorial, rritja ekonomike ka pasur një bazë të gjerë, por rritja më e fortë është regjistruar në sektorin e shërbimeve. Të dhënat e periudhës tregojnë që rritja ka ardhur kryesisht nga aktivitetet e klasifikuara si: "ndërtim", "administrim publik, arsim dhe shëndetësi", "aktivitete profesionale, administrative" dhe "pasuri të paluajtshme".⁷ Edhe nga ana e kërkesës, rritja ekonomike kishte një bazë të gjerë, por u mbështet kryesisht nga konsumi final dhe investimet e sektorit privat. Rënia në flukset e importeve të mallrave dhe shërbimeve, shoqëruar me zgjerimin e eksporteve të tyre, ka ndikuar gjithashtu në kahun pozitiv. Treguesi i ndjesisë ekonomike është rritur, duke sinjalizuar besimin e qëndrueshëm të bizneseve dhe familjeve në ecurinë e ekonomisë.

Punësimi u rrit me 0.6% në terma vjetorë⁸. Kjo ecuri reflektoi rritjen e numrit të të punësuarve në sektorin privat, kryesisht në degën e shërbimeve⁹. Si rrjedhojë, norma e papunësisë u ul në nivelin 10.7% kundrejt 10.8% një vit më parë. Papunësia për grup-moshën 30-64 vjeç është 7.9%, lehtësisht më e lartë se një vit më parë (7.6%). E njëjta prirje vërehet edhe në treguesin e papunësisë të rinjtë (15-29 vjeç), e cila arriti në nivelin 22.0%, duke regjistruar një rritje vjetore prej rreth 0.6 pikë përqindjeje.

Në sektorin shtetëror dhe në atë privat ka vijuar rritja e pagave. Në terma vjetorë, norma mesatare e rritjes së pagave¹⁰ arriti në rreth 14% gjatë tremujorit të katërt të vitit, duke reflektuar rritjen e pagave në sektorin privat (rreth 12%) dhe në sektorin publik (rreth 18%). Në sektorin privat, rritja e pagave është shtrirë në të gjithë sektorët, por mbetet më e theksuar në sektorin e shërbimeve.

⁶ Rritja vjetore e PBB-së në tremujorin e katërt të vitit 2022 ishte rreth 4.44%; ndërsa, në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2023 ishte përkatësisht rreth 3.29% dhe 3.83%.


⁷ Këta sektorë kontribuuan përkatësisht me rreth 1.28%, 1.01%, 0.66% dhe 0.58% në terma vjetorë.

⁸ I referohet numrit të të punësuarve për popullsinë 15 vjeç e lart.

⁹ Rritja e punësimit në këtë degë ishte 2.8% në terma vjetorë. Ndërsa në degët e bujqësisë dhe të industrisë, punësimi ra përkatësisht me 2.0% dhe 0.1%.


¹⁰ Paga mesatare mujore bruto.

Grafik 3. Rritja vjetore e PBB-së




Burimi: INSTAT.

Grafik 4. Norma e inflacionit¹¹



Burimi: INSTAT.

Grafik 5. Balanca buxhetore ndaj PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë e rriti normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje, në nivelin 3.25%. Presionet inflacioniste erdhën në rënie, duke mbetur sidoqoftë mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë. Kjo ecuri e inflacionit ka reflektuar efektin e normalizimit të politikës monetare, mbiçmimin e monedhës vendase dhe rënien e inflacionit të importuar, si edhe efektin e bazës së krahasimit. Në vijim, politika monetare do të mbetet e orientuar prej ecurisë së të dhënave dhe analizës së faktorëve të rrezikut.

Gjatë periudhës, politika fiskale ka qenë në tërësi konsoliduese. Objektivat për deficitin buxhetor u përmbushen në muajin e fundit të vitit, kur u përshpejtua realizimi i

Zhvillimet monetare dhe fiskale

Ecuria e inflacionit shënoi rënie të vazhdueshme. Norma mesatare e inflacionit vjetor zbriti në nivelin 4.0% në dhjetor 2023 kundrejt 7.4% një vit më parë. Kjo ecuri e çmimeve ka reflektuar efektin e normalizimit të politikës monetare, mbiçmimin e monedhës vendase dhe rënien e inflacionit të importuar, si edhe efektin e bazës së krahasimit. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e rritjes së aktivitetit ekonomik në vend, shoqëruar me zhvillimet pozitive në tregun e punës dhe të pagave, kanë kontribuar në qëndrueshmërinë e presioneve të brendshme inflacioniste. Për këto arsye, në muajin nëntor, Banka e Shqipërisë e rriti normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje, në nivelin 3.25%. Megjithatë presionet inflacioniste duken përgjithësisht në rënie, politika monetare do të mbetet e orientuar prej ecurisë së të dhënave dhe analizës së faktorëve të rrezikut.

Gjatë periudhës, politika fiskale ka qenë në tërësi konsoliduese. Objektivat për deficitin buxhetor u përmbushën në muajin e fundit të vitit, kur u përshpejtua realizimi i shpenzimeve publike të planifikuara¹². Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficitin buxhetor dhe borxhi publik në total - kanë shfaqur një rënie të ndjeshme gjatë vitit 2023¹³. Në fund të dhjetorit 2023, balanca buxhetore regjistroi një deficit prej rreth 30 miliardë lekësh kundrejt një deficitin prej 80 miliardë lekësh një vit më parë. Ngushtimi i deficitit fiskal në terma vjetorë ka ardhur për shkak të rritjes më të lartë të të ardhurave me rreth 70 miliardë lekë ose me 12%. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u rritën me rreth 32 miliardë lekë ose me 8%. Nga ana tjetër, shpenzimet u rritën me rreth 24 miliardë lekë ose me rreth 4%, dhe u orientuan drejt

¹¹ Norma mesatare tremujore e rritjes vjetore të IÇK-së.

¹² Në muajin dhjetor 2023, politika fiskale ndryshoi kah në vijim të vlerave më të larta të shpenzimeve kundrejt të ardhurave, përkatësisht rreth 674.7 miliardë lekë kundrejt rreth 643.4 miliardë lekëve të arkëtuara.

¹³ Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave, borxhi publik në fund të vitit 2023 zbriti në nivelin e rreth 59%, niveli më i ulët që nga viti 2010. Njëkohësisht, balanca primare buxhetore është rikthyer në vlera pozitive.

shpenzimeve publike të planifikuara. Në raport me PBB-në, treguesit e qëndrueshmërisë fiskale - deficitit buxhetor dhe borxhi publik në total - kanë shfaqur një rënie të ndjeshme gjatë vitit 2023.

Bilanci i pagesave, që tregon marrëdhëniet e ekonomisë shqiptare me botën, u përmirësua ndjeshëm gjatë tremujorit të fundit të 2023. kryesisht si rezultat i rritjes së flukseve neto të valutës nga shërbimet e udhëtimit, nga investimet e huaja direkte dhe nga dërgesat e emigrantëve.

Stoku i pozicionit debitor të vendit ndaj jorezidentëve u zgjerua gjatë 2023, për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat në formën e investimeve të huaja direkte dhe të portofolit.

shpenzimeve korrente për fondet speciale dhe ato për paga. Deficiti buxhetor është financuar më shumë nga huamarrja e huaj sesa ajo e brendshme. Shpërndarja më e drejtë e shpenzimeve të planifikuara përgjatë vitit mbetet një nevojë e administrimit fiskal.

Sektori i jashtëm

Në bilancin e pagesave, përmirësimet në llogarinë korrente ishin të ndjeshme. Balanca e llogarisë korrente shënoi një deficit prej 232.1 milionë eurosh në tremujorin e katërt të vitit 2023, pas një suficiti të përkohshëm, por historik në tremujorin e tretë. Ky deficit është rreth 51% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Rënia e deficitit është shkaktuar nga përmirësimi i vazhdueshëm i llogarisë së shërbimeve ndikuar nga rritja e eksporteve të turizmit. Në raport me PBB-në, deficitit korrent është rreth 1.0%, pse 5 pikë përqindjeje më pak në krahasim me një vit më parë. Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve u rritën me 30%. Ndikimi kryesor ka ardhur nga rritja e eksportit të shërbimeve me 39%. Sikurse edhe më parë, rritja e eksportit të shërbimeve është shkaktuar nga eksportet e turizmit. Rritja përkatëse është 48%. Në të njëjtën kohë, edhe eksporti i mallrave është rikthyer rritjes pozitive me një rritje vjetore prej rreth 9%. Importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me rreth 11%. Edhe në këtë rast, ndikimin kryesor e kanë dhënë importet e shërbimeve, kryesisht për qëllime turizmi, rritja vjetore e të cilëve shënoi 38%. Nga ana tjetër, rritja e importit të mallrave ka rezultuar mjaft e ulët, duke shënuar vetëm 1.3%.


Balanca tregtare shënoi një deficit prej 470 milionë eurosh, ose 33% më të ulët në krahasim me një vit më parë. Në raport me PBB-në, deficitit tregtar ka rënë në nivelin 8.1%. Llogaria e "të ardhurave parësore" shënoi një deficit prej 85.6 milionë eurosh, me rënie 7.7%. Ndikimi nga rritja e të ardhurave hyrëse nga puna ka rezultuar përsëri më i lartë krahasuar me atë të të ardhurave dalëse nga investimet. Në rastin e të ardhurave dytësore, teprica pozitive është rritur me 0.5%. Remitancat hyrëse shënuan 250 milionë euro, me një rritje prej 4.3%. Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte shënuan vlerën 346 milionë euro, me një rritje prej 0.5%. Raporti i tyre ndaj PBB-së vlerësohet në 6.0%. Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte për këtë tremujor ishin rreth 400 milionë euro, me një rritje vjetore 3.5%.

Pozicioni i jashtëm i vendit mbetet debitor dhe vlera e tij u zgjerua kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve neto të sektorit privat. Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2023 mjetet dhe detyrimet financiare të vendit ndaj jorezidentëve ishin përkatësisht 12,2 dhe 21,8 miliardë euro, ndërkohë që pozicioni neto u zgjerua me rreth 8% në terma vjetorë¹⁴. Ky thellim i pozicionit debitor lidhet me rritjen në detyrimet e lidhura me investimet e portofolit dhe ato të huaja direkte. Këto të fundit, arritën në 13,3 miliardë euro deri në fund të tremujorit të katërt të vitit 2023, dhe ky nivel ishte rreth 20% më i lartë në krahasim me një vit më parë. Borxhi i jashtëm i vendit u zgjerua lehtë gjatë tremujorit të katërt dhe në fund të periudhës shënonte rreth 10.15 miliardë euro. Peshën kryesore në stokun e borxhit të jashtëm, prej rreth 49%, vijon ta mbajë sektori i qeverisë së përgjithshme me një borxh prej 3.5 miliardë eurosh në formë huaje dhe një borxh

¹⁴ Krahasuar me një tremujor më parë, pozicioni i investimeve ndërkombëtare neto regjistron një zgjerim të pozicionit negativ prej rreth 386 milionë euro, ose rreth 4%.


prej 1.4 miliardë eurosh në formën e titujve të borxhit. Sektori i korporatave depozituese ka një borxh të jashtëm prej 1.9 miliardë eurosh, të përfaqësuar pothuajse plotësisht nga depozitat e jorezidentëve në sistemin financiar vendas, ndërsa borxhi i sektorëve të tjerë dhe borxhi në formën e huave ndërkompani të rrjedhura nga marrëdhëniet e investimit direkt llogaritet në përkatësisht 1.5 dhe 1.7 miliardë euro gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Grafik 6. Llogaria korrente dhe investimet e huaja direkte



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Grafik 7. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare




Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.4 Zhvillimet në llogaritë financiare

Sipas statistikave më të fundit të llogarive financiare që i përkasin fundit të vitit 2022, në krahasim me një vit më parë, pozicioni i përgjithshëm debitor i ekonomisë shqiptare u ngushtua me 50 miliardë lekë, në nivelin 890 miliardë lekë. Përmirësimi erdhi pasi rritja në pozicionin kreditor të ekonomive familjare (familjet/individët) ishte disi më e lartë sesa zgjerimi në pozicionin debitor të korporatave jofinanciare (bizneseve) dhe qeverisë së përgjithshme. Në fakt, bizneset dhe familjet mbeten dy sektorët më të mëdhenj huamarrës dhe huadhënës të ekonomisë vendase dhe të dhënat, tregojnë se këta dy sektorë e zgjeruan pozicionin përkatësisht debitor (në -2,150 miliardë lekë) dhe kreditor (në +2,280 miliardë lekë) me rreth -50 miliardë lekë dhe +150 miliardë lekë kundrejt fundit të vitit 2021.


Kontributin më të madh në financimin neto të sektorit të bizneseve vijnë ta japin sektori i jorezidentëve, nëpërmjet investimeve të huaja direkte, dhe sektori i individëve nëpërmjet kapitalit të investuar dhe pretendimeve të tjera ndaj bizneseve vendase. Në terma të ekspozimit të përgjithshëm, gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e varësisë së sektorit të bizneseve ndaj sektorit të familjeve dhe subjekteve jorezidente dhe tkurrje e ekspozimit të këtij sektori ndaj korporatave financiare. Në të njëjtën kohë sektori i individëve, përveç rritjes së ekspozimit ndaj bizneseve, ka vijuar të zgjerojë ekspozimin e tij ndaj sektorit financiar duke regjistruar rritje më të shpejtë të pretendimeve (depozitave) sesa të detyrimeve të tij ndaj subjekteve financiare (kredive). Në fakt, sektori i korporatave financiare, i kryesuar nga bankat, paraqitet si kredidhënës neto ndaj sektorit të bizneseve dhe atij të qeverisë së përgjithshme, dhe kredimarrës neto ndaj sektorit të individëve.

Grafik 8. Pozicioni neto i ekonomisë sipas sektorëve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Pozicioni neto i bizneseve dhe individëve sipas kundërpasive




Njohja e pozicioneve neto të marrëdhënieve ndërsektoriale të ekonomisë është e rëndësishme për të vlerësuar ndikimin e sektorëve të veçantë mbi pjesën tjetër të ekonomisë. Rezultatet e ushtrimit të lidhjeve ndërsektoriale¹⁵ tregojnë që sektorët me ndikimin më të fortë dhe më të shpejtë në shëndetin e sektorëve të tjerë, ose sektorët me vlerën më të lartë të indeksit të rrezikshmërisë, janë sektori i bizneseve, sektori i korporatave financiare dhe sektori jorezident. Sektori me ndjeshmëri më të lartë ose me ekspozimin më të madh si huadhënës ndaj sektorëve të tjerë është sektori i korporatave financiare i ndjekur nga sektori i qeverisë së përgjithshme dhe ai i individëve. Në krahasim me periudhën e mëparshme, vihet re një ekspozim më i lartë i sektorit të qeverisë ndaj sektorit të korporatave financiare i lidhur me pakësimin e pretendimeve (depozitave) të qeverisë në sistemin financiar, dhe përmirësim i ekspozimit të sektorit të bizneseve ndaj pjesës tjetër të botës, që mund të shpjegohet me pakësimin e detyrimeve neto të bizneseve vendase ndaj jorezidentëve.

Grafik 10. Pozicioni dhe financimi neto midis sektorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Indeksi i dobësisë dhe i rrezikshmërisë¹⁶



¹⁵ Ushtrimi supozon një situatë stresi/dështimi të një sektori të caktuar dhe humbje të plotë të pretendimeve të sektorëve të tjerë ndaj këtij sektori.

¹⁶ Vlera e treguesit është në përpjesëtim të drejtë me karakteristikën përkatëse.

1.2.1 Pozicioni financiar i bizneseve

Sipas të dhënave të llogarive financiare, pozicioni i bizneseve është debitor dhe ai është thelluar gjatë vitit 2023.

Sipas instrumenteve, ky zhvillim lidhet me rritjen e mëtejshme të detyrimeve në formën e investimeve të huaja direkte. Në terma të kundërpasive, bizneset kanë pakësuar detyrimet neto ndaj korporatave financiare, për shkak të rritjes më të shpejtë të depozitave sesa të kredive, që ata kanë në banka, dhe kanë zgjeruar detyrimet neto ndaj jorzidentëve.

Kredia bankare për bizneset është rritur gjatë 2023, me një ritëm të përshpejtuar gjatë periudhës. Kjo rritje ishte më e ndjeshme nëse korrigjohet për efektin pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit.


Norma mesatare e interesit për kreditë e reja u rrit në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, me kontributin pozitiv vetëm nga kreditë e reja për biznesin në valutë. Aktualisht, normat mesatare të interesit për kredinë e re në lek, janë më të ulëta se ato për kredinë në euro.

Pavarësisht rritjes së normës së interesit, kërkesa e bizneseve për kredi ishte më e fortë në krahasim me gjysmën e parë të vitit, ndërkohë që bankat kanë

Sipas të dhënave të llogarive financiare për fundin e vitit 2022, mjetet dhe detyrimet financiare të bizneseve vendase ishin përkatësisht 1,740 dhe 3,890 miliardë lekë. Pretendimet ose mjetet financiare të bizneseve dominohen nga llogaritë e arkëtueshme - detyrime financiare brenda sektorit dhe detyrime të sektorit të qeverisë ndaj bizneseve - dhe nga monedhat dhe depozitat e bizneseve pranë sektorit bankar. Në anën e detyrimeve mbizotëron kapitali i investuar në ndërmarrjet vendase nga individët dhe nga jorzidentët. Sipas të dhënave, sektori jorzident zinte rreth 30% të të gjitha detyrimeve financiare të bizneseve vendase në fund të vitit 2022; sektori i individëve mbetet sektori i dytë për nga rëndësia në financimin e bizneseve me 27% të totalit, ndërsa pjesa tjetër e detyrimeve të bizneseve përbëhet nga detyrime brenda sektorit, detyrime ndaj qeverisë së përgjithshme dhe detyrime ndaj korporatave financiare në formën e kredisë.

Për vitin 2023¹⁷ të dhënat tregojnë për një thellim të pozicionit debitor të sektorit të bizneseve me rreth 17%. Sipas instrumenteve, ky zhvillim lidhet me rritjen e mëtejshme të detyrimeve në formën e investimeve të huaja, ndërsa në terma të kundërpasive, bizneset kanë pakësuar detyrimet neto ndaj korporatave financiare dhe kanë zgjeruar detyrimet neto ndaj jorzidentëve. Tkurrja në financimin neto të bizneseve nga sektori i korporatave financiare ka ardhur si pasojë e rritjes më të shpejtë në depozitat e bizneseve sesa në stokun e kredisë së bizneseve. Zgjerimi i detyrimeve neto ndaj jorzidentëve lidhet me rritjen e mëtejshme të stokut të investimeve të huaja direkte, që përfaqësojnë mbi 90% të detyrimeve të bizneseve ndaj pjesës tjetër të botës.

Grafik 12. Mjetet (+), detyrimet (-) dhe pozicioni neto i bizneseve sipas instrumenteve dhe kundërpasive



Burimi: Banka e Shqipërisë.


¹⁷ Në mungesë të tablosë së plotë të llogarive financiare për vitin 2023, analiza mbështetet mbi treguesit e sektorit të jashtëm deri në fund të tremujorit të tretë dhe treguesit e aktivitetit bankar deri në fund të muajit dhjetor 2023.

lehtësuar kushtet dhe termat e përgjithshme të kredisë për bizneset gjatë periudhës.

Thellimi i pozicionit debitor të bizneseve ka reflektuar rritjen e varësisë ndaj burimeve të huaja të financimit. Në fakt, në fund të vitit 2023, borxhi i jashtëm i sektorit të bizneseve shënoi rreth 2.4 miliardë euro, nga të cilat një stok prej 1.7 miliardë eurosh ka formën e huave ndërkompani¹⁸ të lindura nga marrëdhënia e investimit direkt. Pjesa më e madhe e rritjes vjetore të borxhit të jashtëm të bizneseve me rreth 4% gjatë viteve 2022-2023, lidhet me zgjerimin e detyrimeve në formën e kredive tregtare.


Gjatë këtyre viteve, pozicioni i investimeve ndërkombëtare ose huamarrja neto e bizneseve vendase nga jashtë është rritur shumë më shpejt sesa treguesi i borxhit, për shkak të zgjerimit të stokut të investimeve të huaja direkte. Në fund të vitit 2023, stoku i investimeve direkte ishte 20% më i lartë ndaj një viti më parë, ndërsa për vitet 2021 dhe 2022, ky ndryshim llogaritet në 8% dhe 18%. Deri në fund të vitit 2023, sektorët me stokun më të madh të investimeve të huaja ishin sektori i energjisë, gazit dhe avullit (3.3 miliardë euro), sektori i industrisë nxjerrëse (2.2 miliardë euro) dhe sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (1.6 miliardë euro). Përveç këtyre sektorëve, të cilët vazhdojnë të tërheqin investime nga jashtë, rritje e fortë është vënë re edhe në investimet në aktivitete të pasurive të paluajshme që aktualisht llogariten në rreth 1.6 miliardë euro.

Grafik 13. Borxhi i jashtëm i bizneseve sipas instrumenteve



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 14. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare për sektorin e bizneseve



Pozicioni debitor neto i bizneseve ndaj sektorit financiar është ngushtuar në mënyrë të konsiderueshme. Vlerësohet që në periudhën 2017-2022, ky pozicion neto ka rënë me rreth 120 miliardë lekë, pranë nivelit 20 miliardë lekë. Kjo ecuri lidhet me faktin që zgjerimi i tepricës së kredisë së marrë nga bizneset gjatë këtyre viteve ka qenë më i vogël sesa rritja e depozitave dhe pretendimeve të tjera të bizneseve ndaj korporatave financiare, si ato në formën e aksioneve dhe kuotave në fondet e investimit. Kjo ecuri u vu re edhe në vitin 2023, gjatë të cilit depozitat e bizneseve pranë bankave u zgjeruan me rreth 40 miliardë lekë (në 300 miliardë lekë), ndërsa teprica e kredisë bankare u shtua me vetëm 10 miliardë lekë (duke arritur në 450 miliardë lekë në fund të vitit). Për shkak të rritjes më të shpejtë në depozitat e bizneseve në krahasim me kredinë, raporti kredi/depozita për bizneset ka rënë në 1.5 herë në fund të vitit 2023, nga 2.3 herë në fund të vitit 2017.


¹⁸ Kredi nga ndërmarrja/subjekti nga ka origjinën investimi i huaj direkt.

Grafik 15. Mjetet dhe detyrimet e bizneseve ndaj sektorit financiar




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Rritja e kredisë së bizneseve sipas sektorëve (kontribut, p.p.)



Gjatë vitit 2023 kredia bankare për bizneset u rrit me 2%, dhe rritja në gjashtëmuorin e dytë ishte më e shpejtë se në pjesën e parë të vitit. Rritja e kredisë bankare për bizneset është raportuar si për portofolin në lekë, ashtu edhe për atë në valutë, por ndryshimi në nivelin e kursit të këmbimit ka pasur një efekt statistikor negativ në vlerat e raportuara në lekë të kredive në valutë. Kredia e bizneseve në lekë u rrit me 12% në terma vjetorë dhe me 7% në terma gjashtëmuorë. E shprehur në lekë, kredia për bizneset në valutë u tkurr me 8% në terma vjetore dhe nuk ndryshoi në terma gjashtëmuorë. E shprehur në Euro, kredia për bizneset në këtë monedhë u rrit me 7% në terma vjetore dhe me 5% në terma gjashtëmuorë.

Grafik 17. Rritja e kredisë së bizneseve sipas qëllimit (kontribut, p.p.)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në zgjerimin e portofolit të kredisë për bizneset ka ndikuar rritja e kredisë për sektorin e transportit, akomodimit, aktiviteteve të pasurive të paluajtshme dhe shërbimeve të tjera. Kredia për sektorin e tregtisë në fund të vitit 2023 u paraqit më e ulët sesa një vit më parë, kryesisht si pasojë e efektit statistikor të kursit të këmbimit. Stoku i kredive të biznesit, të klasifikuara sipas qëllimit të përdorimit dominohet nga kreditë për blerje pasurish të paluajtshme dhe nga kreditë – kufi me përkatësisht 38% dhe 24%, ndërkohë që kredia për blerje pajisjesh dhe ajo për kapital qarkullues kanë peshë të njëjta prej rreth 17-18%. Treguesit e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit pasqyrojnë rritje të fortë në kredinë për pasuri të paluajtshme dhe rënie të kredisë për blerje pajisjesh. Kjo ecuri është ndikuar edhe nga procesi i riklasifikimit

të një pjese të portofolit të kredisë nga sektori bankar midis këtyre dy kategorive. Ky efekt statistikor do të shfaqet në ndryshimet vjetore të treguesve përkatës të kredisë deri në tremujorin e tretë të vitit 2024.

Norma mesatare e interesit të kredisë së re për sektorin e bizneseve është rritur në 6.7% gjatë periudhës, nga 6.4% gjashtë muaj më parë dhe 5.8% në fund të vitit 2022. Në këtë rritje ka ndikuar rritja e normës së interesit për kreditë në monedhën Euro me 0.7 pikë përqindjeje në 6.9%, ndërkohë që normat e interesit për kreditë në lek kanë shfaqur prirje për rënie gjatë periudhës dhe në fund të dhjetorit shënuan vlera më të ulëta në krahasim me ato në Euro. Gjatë gjysmës së parë të vitit, ashtu si edhe gjatë periudhave të mëparshme, normat e interesit për kredinë e re në lek ishin më të larta sesa normat për kredinë e re në monedhën Euro, por gjatë gjashtëmujorit të dytë diferenca midis tyre është ngushtuar dukshëm.


Kërkesa e bizneseve për kredi, sipas vlerësimit të bankave¹⁹, shënoi një rritje të ndjeshme gjatë tremujorit të katërt të vitit pavarësisht nivelit më të lartë të normave të interesit. Kërkesa gjatë kësaj periudhe është mbështetur kryesisht nga nevoja e bizneseve për të realizuar investime fikse. Bankat vlerësojnë që rritja në kërkesën për kredi nga biznesi i vogël dhe i mesëm ishte disi më e ndjeshme në krahasim me rritjen në kërkesën nga biznesi i madh, ndërkohë që pritet për kërkesën e përgjithshme për kredi nga sektori i biznesit mbeten optimiste për tremujorët e ardhshëm.

Grafik 18. Normat e interesit për kredinë e re për bizneset



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 19. Ecuria e kushteve dhe termave të kreditimit për bizneset



Gjatë gjysmës së dytë të vitit kushtet dhe termat e përgjithshme të kreditimit për bizneset u paraqitën disi më të lehtësuara. Bankat kanë vijuar të shtrëngojnë marzhet mbi kreditë me rrezik, dhe, në një masë më të vogël, kushtet mbi madhësinë e kredisë dhe nivelin e kolateralit ndaj kredisë. Sipas bankave, në kahun shtrëngues të termave të kredidhënies për bizneset ka ndikuar rreziku i perceptuar, ndërsa në kahun lehtësues kanë ndikuar faktorë të lidhur me koston e fondeve dhe me konkurrencën në tregun bankar.

¹⁹ "Vrojtimi i aktivitetit kreditues" i publikuar në:

https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/

1.2.2 Përballueshmëria e borxhit dhe pritjet për të ardhmen

Sipas vërtimit të Bankës së Shqipërisë, shumica e dërmuese e bizneseve kanë raportuar fitime gjatë periudhës, dhe ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar vlerësohen pozitive krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Pritjet mbeten optimiste, megjithë problematikat që ekzistojnë lidhur me gjetjen e tregut, rritjen e kostove të prodhimit dhe të punës, si dhe me gjetjen/ruajtjen e stafit të kualifikuar.

Pesha e bizneseve huamarrëse ka shënuar rënie gjatë periudhës, gjë që është e pritshme në kushtet e niveleve më të larta të normave të interesit dhe gjendjes së mirë të likuiditetit të ndërmarrjeve. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të borxhit ndaj kapitalit, dhe në formën e shërbimit të tij ndaj të ardhurave të ndërmarrjes, vlerësohet në nivele të përballueshme për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve, dhe pa ndryshime të rëndësishme nga gjashtëmujori i mëparshëm.

Bizneset presin që kërkesa e tyre për kredi të mbetet e qëndrueshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2024.

Sipas vërtimit "Mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën me borxh të ndërmarrjeve", rreth 94% e ndërmarrjeve të vrojtuarra kanë raportuar fitim gjatë periudhës. Ecuria e shitjeve dhe performanca financiare vlerësohen pozitive, veçanërisht në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe atyre që i përkasin sektorit të tregtisë. Për gjysmën e parë të vitit 2024, të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha) presin rritje të mëtejshme të shitjeve dhe të rezultatit financiar, megjithëse në vlera disi më të dobëta krahasuar me periudhën paraardhëse.

Përsa i përket sfidave të aktivitetit gjatë periudhës, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme listojnë 'konkurrencën' dhe 'gjetjen e tregut', ndërsa ndërmarrjet e mëdha i lidhin vështirësitë kryesore me 'rritjen e kostove të prodhimit dhe të punës' dhe me 'gjetjen/ruajtjen e stafit të kualifikuar'.

Pesha e ndërmarrjeve që kanë hua për të paguar ka rezultuar në rënie. Rreth 36% e ndërmarrjeve deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Kjo peshë ka rënë me 2 pikë përqindjeje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 3 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë, gjë që është e pritshme në kushtet e rritjes së kostove të financimit në vend dhe gjendjes së mirë të likuiditetit të ndërmarrjeve. Rreth 87% e ndërmarrjeve e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes, por ndërmarrjet e vogla shfaqin kërkesë më të lartë për financim. Huamarrja është realizuar vetëm në monedhën vendase për 61% të ndërmarrjeve të vogla, 58% të ndërmarrjeve të mesme dhe 43% të ndërmarrjeve të mëdha, ndërkohë që pjesa tjetër është në valutë ose e kombinuar.


Raporti "Hua/kapital" ka shënuar rënie për totalin e ndërmarrjeve të vrojtuarra krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e kapitalit të ndërmarrjes për rreth 85% të tyre dhe pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit për 8% të tyre, ndërkohë që pjesa e mbetur prej 7% raportojnë që vlera e huasë e tejkalon atë të kapitalit. Gjatë periudhës, ky raport ka rezultuar më i lartë dhe në rritje tek ndërmarrjet e mesme, ku rreth 21% shprehen se huaja është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh ka shënuar rënie për të gjitha degët e ekonomisë ku operojnë ndërmarrjet. Vlerën më të lartë të raportit hua/kapital vijon ta ketë sektori i ndërtimit, ku 18% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se vlera e huasë është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit.

Tabelë 3. Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali

Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve				
	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MII 2021	23%	25%	24%	22%
6MI 2022	21%	21%	25%	22%
6MII 2022	22%	29%	26%	25%
6MI 2023	10%	20%	24%	18%
6MII 2023	15%	15%	18%	15%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës



Shumica e ndërmarrjeve (rreth 84%) raportojnë pagesa e huasë nuk ka ndryshuar gjatë periudhës.

Përgjigjet e pjesës tjetër kanë balanca neto pozitive, gjë që tregon për një rritje të këtij shpenzimi, por rritja ka rezultuar më e ngadaltë se në periudhën paraardhëse. Kjo balancë ka rezultuar më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha dhe ato të mesme dhe e pandryshuar tek ndërmarrjet e vogla. Rreth 85% e ndërmarrjeve nuk presin ndryshim të kostos së huasë në gjysmën e parë të vitit 2024, ndërsa pjesa tjetër pret rritje të mëtejshme, dhe këto pritje janë më të theksuara tek ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme. Kosto e huasë arrin në 20% të të ardhurave për 77% të ndërmarrjeve, dhe në 20%-50% të të ardhurave për 21% të tyre, dhe kjo peshë është më e lartë tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmuajorin e ardhshëm, ndërmarrjet janë përgjigjur se kërkesa për kredi pritet të mbetet në kahun pozitiv, dhe disi në rritje krahasuar me gjashtëmuajorin e kaluar. Kështu, rreth 43% e tyre deklarojnë se 'nuk ka asnjë mundësi' që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme dhe kjo peshë ka rënë për të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha), ndërkohë që pesha e atyre që pohojnë në shkallë të ndryshme sigurie ('ka pak mundësi', 'shumë mundësi' apo 'është e sigurt') që të kërkojnë një kredi në gjysmën e parë të vitit 2024, ka shënuar rritje.

1.2.3 Pozicioni financiar i individëve

Familjet ruajnë një bilanc të theksuar pozitiv midis mjeteve dhe detyrimeve të tyre financiare. Kreditë nga korporatat financiare vendase zënë pjesën dërrmuese të detyrimeve të individëve, por vlera e tyre është disa herë më e vogël se vlera e depozitave pranë sektorit bankar.

Pozicioni kreditor i individëve ndaj sistemit financiar vijoi të zgjerohej gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe nominale të kursimeve, duke përfshirë depozitat në banka dhe investimet në tituj, në krahasim me kreditë.

Gjatë periudhës, depozitat e individëve në banka u zgjeruan me 55 miliardë lekë, dhe në fund të vitit ato shënonin 1,245 miliardë lekë.

Kredia për individët u ngjiti në 270 miliardë lekë në fund të periudhës, duke u zgjeruar ndjeshëm pavarësisht vijimit të rritjes së normës mesatare të interesit.

Kërkesa për kredi është mbështetur në nevojën për konsum dhe për blerje pasurish të paluajtshme, të cilën bankat e presin të qëndrueshme edhe në periudhën e ardhshme.

Familjet ruajnë një bilanc të konsiderueshëm pozitiv në terma të mjeteve dhe detyrimeve financiare dhe kanë vijuar të financojnë sektorin privat, sistemin financiar dhe qeverinë e përgjithshme.

Deri në fund të vitit 2022, mjetet dhe detyrimet e përgjithshme të sektorit të familjeve ishin përkatësisht 2,640 dhe 360 miliardë lekë. Kreditë nga sistemi financiar vendas përfaqësojnë mbi 80% të detyrimeve financiare të sektorit të familjeve. Në raport me mjetet financiare të këtij sektori, kreditë janë sa 11% e totalit. Në raport me kursimet në formë monedhash dhe depozitash, kreditë e familjeve janë 4.5 herë më të vogla, dhe ky raport ka qenë i qëndrueshëm gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Peshën më të madhe në mjetet e sektorit të familjeve e zënë depozitat në sektorin bankar, ndërsa në vend të dytë renditet kapitali i investuar në korporatat jofinanciare ose në ndërmarrjet vendase. Sektori financiar është njëkohësisht kreditori dhe debitori kryesor i sektorit të familjeve.

Pozicioni kreditor i individëve ndaj sistemit financiar vijoi të zgjerohej gjatë periudhës, për shkak të rritjes më të madhe nominale të depozitave në krahasim me kreditë.


Depozitat dhe kreditë e individëve u zgjeruan me rreth 5% gjatë periudhës, ndërsa në krahasim me një vit më parë, zgjerimi i kredisë ishte më i fortë me një rritje rreth 9% në krahasim me një rritje prej 3% në tepricën e depozitave. Kjo ecuri bëri që diferenca pozitive midis depozitave dhe kredive të ngushtohej disi në fund të gjashtëmujorit të parë në krahasim me fundin e vitit 2022, dhe të zgjerohej me rreth 40 miliardë lekë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023.

Gjatë periudhës, kredia për individët u rrit me ritme më të shpejta në krahasim me gjysmën e parë të vitit, duke u ngjitur në 270 miliardë lekë në fund të vitit.

Kontributin kryesor në rritjen vjetore të kredisë për individët e dha zgjerimi me rreth 8% i tepricës së kredisë së marrë nga individët për blerje banesash, ndërkohë që kredia për konsum u rrit me rreth 14% në terma vjetorë. Rritja e fortë e kredisë së marrë nga individët për blerje banesash ka rezultuar në një rritje të peshës së kredisë për banesa në 67% të kredisë së përgjithshme për individët.


Në reflektim të mbiçmimit të kursit të këmbimit, gjatë periudhës vihet re një rënie e dukshme e ritmit të rritjes së kredisë për blerje banesash dhe kredisë për konsum në monedhën Euro, dhe përshpejtim i rritjes së kredisë për blerje banesash në Lek. Rritja në stokun e kredive për konsum lidhet me rritjen vjetore prej 15% në kredinë për mallra jo të qëndrueshme, ku përfshihen kryesisht kreditë për shërbime dhe mallra që konsumohen për një periudhë më të shkurtër se një vit. Kreditë për të vetëpunësuarit zënë rreth 2% të kredisë së përgjithshme për individët, por janë rritur me 20% në terma vjetorë dhe rreth 4 herë në krahasim me mesin e vitit 2021.

Grafik 21. Mjetet dhe detyrimet financiare të individëve sipas sektorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 22. Rritja vjetore e kredisë për konsum dhe për pasuri të paluajtshme (PP) për individët



Norma mesatare e interesit për kredinë e re për individët²⁰ ka ardhur në rritje gjatë pjesës së dytë të vitit, por niveli në fund të vitit prej 6.3% ishte disi më e ulët nga norma mesatare e muajit qershor.


Kredia për konsum në monedhën Lek ka normat më të larta të interesit, por këto norma mbeten nën nivelet e regjistruara gjatë vitit 2022. Në muajin dhjetor, kredia për pasuri të paluajtshme për individët kishte një normë mesatare interesi prej 4.5% për kreditë në lekë, dhe prej 5.2% për kreditë në monedhën Euro. Në krahasim me normat e raportuara në fillim të vitit, të dyja këto norma kanë shënuar rritje por ajo për kreditë për pasuri të paluajtshme në monedhën Euro ishte më e lartë.

Grafik 23. Rritja vjetore e kredisë për individët, kontribut në p.p.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Normat e interesit për kredinë e re për individë




Kërkesa e familjeve për kredi është rritur gjatë periudhës dhe ka reflektuar kryesisht nevojat për blerje banesash dhe për konsum.

Sipas vlerësimit të bankave, që nga fillimi i vitit 2022 rritja e normave të interesit, zhvillimet në tregun e banesave dhe, në një masë më të vogël, besimi i konsumatorit kanë ndikuar në frenimin e kërkesës së kredive për konsum dhe për blerje banese, por treguesit janë përmirësuar gjatë pjesës më të madhe të vitit 2023. Bankat presin që kërkesa e familjeve për kredi për konsum dhe për kredi për blerje banesash të vijojë të mbetet e qëndrueshme edhe gjatë periudhave në vazhdim, por intensiteti i kërkesës së pritshme paraqitet më i dobët.


²⁰ Pa përfshirë kredinë – kufi dhe kartat e kreditit.

Grafik 25. Ecuria e kërkesës së individëve për kredi



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 26. Ecuria e faktorëve që përcaktojnë kërkesën e individëve për kredi



Gjatë tremujorit të fundit të vitit, bankat kanë shtrënguar disi kushtet dhe termat e përgjithshme të kredisë dhe kanë lehtësuar standardet e kreditimit. Shtrëngimi i kushteve e termave të kreditimit u arrit në sajë të marzheve më të larta të përcaktuara prej bankave, si në kreditë normale, ashtu edhe në ato me rrezik. Nga ana tjetër, elementet joçmim patën ndikim lehtësues në kushtet e termat e kreditimit, pasi bankat kanë ulur kërkesat për kolateral, dhe kanë rritur madhësinë e kredisë për individët. Lehtësimi i standardeve të kreditimit u vërejt në të dyja kategoritë e qëllimit të përdorimit të kredisë, si në kreditë për blerjen e banesave, ashtu edhe në ato konsumatore. Faktorët kryesorë që mbështetën lehtësimin e standardeve të kreditimit për individët ishin trysnia e shtuar nga konkurrenca në sistemin bankar dhe perceptimi i bankave për rrezik më të ulët lidhur me aftësinë paguese të kredimarrësve. Sipas bankave, standardet e kreditimit për individët priten të shtrëngohen disi në tremujorin e parë të vitit 2024, kryesisht në kreditë për blerjen e banesave.


Kursimet në formën e monedhës dhe depozitave vijojnë të zënë pjesën kryesore në mjetet financiare të individëve, ndërsa në vend të dytë renditen investimet në formën e kapitalit në ndërmarrjet e sektorit privat. Deri në fund të vitit 2022 investimet e familjeve në këto dy forma ishin përkatësisht 1,320 dhe 1,080 miliardë lekë. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, depozitat e individëve në banka u zgjeruan me 55 miliardë lekë, duke rikuperuar rënien prej rreth 16 miliardë lekësh të gjashtëmujorit të parë, dhe në fund të vitit ato shënonin rreth 1,245 miliardë lekë. Kontribut pozitiv në zgjerimin e pozicionit financiar të individëve dhanë depozitat në lekë dhe në valutë dhe investimet në titujt e qeverisë kryesisht në bono thesari.

Grafik 27. Mjetet dhe detyrimet e individëve sipas instrumenteve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 28. Kursimet e individëve



1.2.4 Përballueshmëria e borxhit dhe pritjet për të ardhmen

Rezultatet e vërtetimit të Bankës së Shqipërisë, tregojnë se, megjithë luhatjet, pesha e familjeve huamarrëse dhe aftësia paguese e tyre paraqiten të qëndrueshme.


Pesha e familjeve që kanë një hua për të paguar nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, por ka rënë disi krahasuar me nivelin e një viti më parë.

Aftësia paguese e familjeve vlerësohet e përmirësuar krahasuar me rezultatet e vërtetimeve të kaluara. Pritjet për aftësinë paguese në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten më optimiste.

Megjithatë, familjet presin që kërkesa e tyre për kredi të vijë në rënie në pjesën e parë të vitit 2024.


Niveli i huamarrjes së familjeve dhe aftësia paguese e tyre paraqiten të qëndrueshme dhe pa ndryshime të rëndësishme nga periudha e mëparshme. Rezultatet e vërtetimit “Mbi gjendjen financiare dhe ngarkesën në borxh të familjeve”²¹ për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, tregojnë që rreth 24% e familjeve kishin të paktën një hua për të paguar në momentin e intervistimit. Kjo peshë ka mbetur pothuaj e pandryshuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, dhe ka rënë me 2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke mbetur nën mesataren historike të treguesit prej 27%. Rreth 83% e familjeve deklarojnë se pagesa e huasë zë ‘më pak se 30% të të ardhurave mujore’²² dhe ky tregues është rritur me 9 pikë përqindje në terma gjashtëmujorë dhe me 10 përqindje në terma vjetorë. Nga ana tjetër, pesha e familjeve ku ‘pagesa e huasë’ tejkalon 30% të të ardhurave’ ka rënë me përkatësisht 14 dhe 12 pikë përqindje krahasuar me periudhat e mësipërme, duke sinjalizuar zbutje të ngarkesës financiare të borxhit, pavarësisht rritjes së normave në vend. Rreth 55% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese ‘nuk ka ndryshuar’ gjatë periudhës, ndërsa pjesa tjetër raportojnë ‘përkeqësim të aftësisë’ së tyre paguese, por ndjeshëm më të zbutur krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Prirje të ngjashme paraqet edhe indeksi i pritjeve mbi aftësinë paguese për gjysmën e parë të vitit 2024, i cili ndonëse me vlerë negative, sinjalizon pritje më optimiste të familjeve krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë.

Grafik 29. Indekset e aftësisë paguese për 6 muajt e kaluar dhe 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 30. Indeksi i planifikimit të huamarrjes dhe shpërndarja e familjeve që planifikojnë hua të re



Familjet presin një ngadalësim të lehtë të kërkesës së tyre për kredi gjatë gjysmës së parë të vitit 2024. Rreth 57% e të përgjigjurve kanë deklaruar se ‘nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm’. Pesha

²¹ Vërtetimi është gjashtëmujor dhe për 6MII-2023, është kryer mbi një kampion prej 1200 familjesh, ku shkalla e përgjigjes ka rezultuar 88%. Kampioni i familjeve përzgjidhet, intervistohet dhe rishikohet në mënyrë periodike nga Instituti i Statistikave, në bazë të regjistrave që përdoren nga agjencia për anketat pranë familjeve.

²² “deri në 10% të të ardhurave” për 38% të familjeve huamarrëse, “10-30% të të ardhurave” për 46% të familjeve.

e atyre që deklarojnë se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie²³ mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re, është rritur me 2 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por ka rënë me 1 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Rënia në terma vjetore e vlerës së *indeksit të planifikimit të huamarrjes*, sinjalizon një ngadalësim të kërkesës së individëve për kredi në gjysmën e parë të vitit 2024.

2. Tregjet dhe sistemet e pagesave

2.1 Tregjet e kapitalit, tregu ndërbankar dhe tregu i këmbimit të monedhave

2.1.1 Tregjet e letrave me vlerë

Në tregun parësor të titujve të borxhit të qeverisë, vëllimi i emetimeve gjatë periudhës ishte 30% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, por i krahasueshëm me vëllimin e një viti më parë. Në volumin e emetimeve të periudhës, emetimet afatshkurtra zbritën në nivelin më të ulët historik prej 53%.

Normat e interesit shënuan rënie për pjesën më të madhe të titujve, duke rezultuar në ulje të kostos së borxhit të qeverisë dhe duke reflektuar pritjet e investitorëve për rënie graduale të normës së inflacionit.

Gjatë periudhës, norma mesatare (e ponderuar) e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në lekë ra me 0.4 p.p. duke arritur në nivelin 4.1%. Për titujt afatshkurtër norma mesatare e interesit ra me 1.2 p.p. në nivelin 3.2%, ndërsa për titujt afatgjatë ajo qëndroi pranë nivelit të gjashtëmujorit të kaluar prej 5.2%.

Tregu parësor i titujve të borxhit të Qeverisë Shqiptare gjatë periudhës u karakterizua nga rënie e vëllimit të emetimeve dhe rënie e normës mesatare të interesit. Në këtë treg, u emetuan 160 miliardë lekë borxh nga ana e qeverisë, dhe i gjithë emetimi ishte në monedhën vendase. Gati gjysma e emetimeve ishin në tituj të borxhit afatshkurtër, që mbizotërohen nga ato me afat 12 muaj. Në emetimet e titujve afatgjatë peshën kryesore e zënë obligacionet me maturim 2-vjeçar. Vlera e emetimeve të periudhës ishte rreth 30% më e ulët në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe 3% më pak në krahasim me vëllimin e emetuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Norma mesatare e ponderuar e interesit për të gjitha maturitetet e titujve të emetuar në lekë ra me 0.4 pikë përqindjeje në nivelin 4.1%. Borxhi i marrë nëpërmjet emetimit në tituj afatshkurtër ra ndjeshëm duke kapur nivelin më të ulët historik në peshën e borxhit të përgjithshëm prej 53% nga një mesatare 10-vjeçare prej 70%.


Emetimet në tituj afatshkurtër ishin 85 miliardë lekë ose 43% më pak në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Prej tyre, emetimet në tituj me maturim 12-mujor ishin rreth 80 miliardë lekë. Borxhi i emetuar nëpërmjet bonove të thesarit 12-mujore ishte 40% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe 28% më i ulët në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor të vitit paraardhës. Bonot e thesarit 3 dhe 6-mujore zënë një peshë të vogël të borxhit të brendshëm dhe vëllimi i emetuar gjatë periudhës ishte më i vogël në krahasim me dy gjashtëmujorët paraardhës.

²³ Alternativat e dhëna janë: "ka pak mundësi", "ka shumë mundësi" dhe "është e sigurt".

Oferta e investitorëve ka qenë e lartë dhe në shumicën e rasteve i ka mbuluar nevojat e qeverisë për huamarrje.

Volumet e tregtuara në tregun dytësor të titujve, mbeten të ulëta dhe mbizotërohen nga transaksionet që bankat kryejnë për portofolin e tyre.


Grafik 31. Ecuria e normës mesatare të ponderuar të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Vëllimi i titujve afatgjatë të emetuar gjatë periudhës ishte i krahasueshëm me atë të emetuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit por 2 herë më i lartë në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë. Me përjashtim të titujve me maturitet 10 vjet, të gjitha të tjerët me maturitet afatgjatë shënuan rënie të vëllimit të emetuar për periudhën. Emetimi në obligacione 2-vjeçare ishte rreth 20 miliardë lekë, ose 28% më pak nga gjashtëmujori i kaluar, por në nivel të krahasueshëm me vëllimin e emetuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Emetimet në tituj me maturim 3 dhe 5-vjet ranë me përkatësisht 6% dhe 8% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, por në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë ishin rreth 3 herë më shumë. Vëllimi i titujve me maturim 7-vjet u ul me 2% për periudhën por ishte rreth 60% më i lartë në krahasim me një vit më parë. Emetimi i obligacioneve 10-vjeçare shënoi rritje me rreth 2 dhe 5 herë më shumë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë dhe pesha e tyre në borxhin afatgjatë u rrit në 20% nga 8% në periudhën e mëparshme. Obligacionet me maturim 2-vjeçar vijnë të përbëjnë pjesën kryesore, me rreth 26% të vëllimit të borxhit afatgjatë.

Grafik 32. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 33. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar



Norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt afatshkurtër në fund të periudhës arriti në 3.2%, duke rënë me 0.9 pikë përqindjeje ndaj nivelit të gjashtë muajve më parë. Në krahasim me gjashtëmujorin e njëjtë një vit më parë, norma e interesit ishte rreth 1.2 pikë përqindjeje më e ulët. Ndikimin kryesor në këtë ecuri e dha ecuria e normës së interesit për bonot e thesarit 12-mujore, e cila për periudhën regjistroi një vlerë mesatare prej 3.2%, nga nivelet 4.2% dhe 4.6% të regjistruara gjatë gjashtëmujorëve të

kaluar. Megjithatë, norma e interesit për bonot 12-mujore ka ardhur duke u rritur nga niveli prej 3.1% në emetimet e muajit korrik, në nivelin 3.4% në emetimin e fundit të muajit dhjetor 2023. Kërkesa e investitorëve për tituj borxhi me maturim afatshkurtër ka qenë e lartë dhe në rreth 80% të rasteve ka përmbushur nevojat për huamarrje të qeverisë.

Në fund të vitit norma mesatare e ponderuar e interesit për titujt afatgjatë qëndroi në nivelin 5.2%.

Normat e interesit të titujve të borxhit me maturim 2 dhe 10-vjet ranë me përkatësisht 0.7 dhe 0.4 pikë përqindjeje në nivelet 4.0% dhe 6.6%, ndërsa norma e interesit për titujt me maturim 15 vjet u rrit me 0.8 pikë përqindjeje në nivelin 7.7%. Titujt e tjerë të borxhit afatgjatë shënuan luhatje të lehta të normës së interesit. Kërkesa e investitorëve për të investuar në tituj afatgjatë ka qenë e lartë dhe në rreth 70% të rasteve ka përmbushur nevojat e Qeverisë për huamarrje të brendshme.


Vëllimet e tregtimit në tregun dytësor të titujve mbeten të ulëta dhe mbizotërohen nga tregu i titujve të qeverisë shqiptare.

Transaksionet e titujve mes bankave për portofolin e tyre zënë rreth $\frac{3}{4}$ e transaksioneve të përgjithshme në këtë treg, ku përfshihen edhe transaksionet mes bankave për klientët e tyre. Tregtimi në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE, vijon të mbetet i ulët dhe i përqendruar në tregtimin e letrave me vlerë të qeverisë. Megjithatë, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, në ALSE u treguan obligacione private, në vlerën 0.03 miliardë lekë. Megjithëse një vlerë e ulët, tregtimi i titujve privatë në bursë, jep një sinjal optimist për zhvillimin e ardhshëm të tregut të kapitaleve, drejt instrumenteve joqeveritare. Me qëllim zhvillimin e tregut të kapitaleve, funksionon prej pak vjetësh modeli i zhvilluesve të tregut (*market-makers*) të cilët ofrojnë kuotime ditore të titujve referencë (*benchmark*) me maturitet 3- dhe 5-vjeçare. Kuotimi me bazë ditore i titujve referencë mundëson llogaritjen e kurbës së *yield*-it, që shërben si referencë për titujt e tjerë të borxhit në treg dhe mundëson llogaritjen e çmimit të tyre. Përmes kurbës së *yield*-it, investitorët potencialë mund të vlerësojnë nëse *yield*-i nga investimet më afatgjata është i mjaftueshëm për të kompesuar rrezikun e shtuar nga investimet me afat më të gjatë në raport me ato me afat më të shkurtër.

Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, kurba e yield-it për titujt referencë paraqitet e zhvendosur për lart dhe me pjerrësi më të madhe për maturitetin më afatgjatë.


Kjo pjerrësi më e madhe paraqet një normë kthimi më të lartë për maturitetin më afatgjatë, në krahasim me ato me afat më të shkurtër të cilat kanë norma të përafërta dhe japin një pamje më të sheshtë të gjysmës së kurbës. Në kushtet kur maturitetet më afatshkurtra kanë norma shumë të përafërta kthimi, investitorët janë të prirur të orientohen drejt investimit më afatgjatë.

Grafik 34. Volumi i transaksioneve të kryera në tregun sekondar të LV të Qeverisë



Burimi: Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Grafik 35. Nivelet e yield-it fiks në datën 31.12.2023



Burimi: Banka e Shqipërisë.


2.1.2 Tregu ndërbankar i financimit

Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve të financimit në tregun ndërbankar shënoi rënie. Kontributi kryesor erdhi nga rënia e vëllimeve të transaksioneve 1-javore.

Norma e interesit në transaksionet ndërbankare është rritur duke ndjekur nga afër ecurinë e normës bazë të interesit dhe duke reflektuar vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Tregu ndërbankar ka regjistruar ulje të vëllimit të transaksioneve dhe rritje të normës së interesit. Vëllimi i transaksioneve ra me përkatësisht 58% dhe 44% në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë reflektuar rritjen e normës bazë të interesit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në muajin nëntor me 0.25 pikë përqindje, dhe janë luhatur pranë nivelit të normës bazë të interesit.

Grafik 36. Vëllimi i transaksioneve dhe normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ulja e vëllimit të transaksioneve ndërbankare lidhet me rënien me rreth 60% në transaksionet 1-javore, të cilat përbëjnë 80% të vëllimit të huamarrjes ndërbankare. Gjatë periudhës, transaksionet 1-javore shënuan rreth 530 miliardë lekë. Në krahasim me të njëjtin gjashtëmujor në vitin e kaluar vëllimi i transaksioneve 1-javore u përgjysmua. Transaksionet 1-ditore të kryera gjatë këtij gjashtëmujori u rritën me 64% në nivelin rreth 100 miliardë lekë, megjithatë në krahasim me 1 vit më parë ishin rreth 20% më të ulëta. Volumi i transaksioneve 1-ditore përbën rreth 16% të volumit të përgjithshëm të transaksioneve të kryera gjatë periudhës. Pjesa tjetër e transaksioneve, përfaqësohet nga ato 2 ditore, 3 ditore dhe 2 javore, të cilat së bashku zënë rreth 3% të transaksioneve ndërbankare. Megjithëse në nivele të ulëta, ato u rritën rreth 2 herë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione të rregullta duke injektuar likuiditetet përmes marrëveshjeve të anasjella të riblerjes me afat një javor, që përfaqësojnë dhe instrumentin e saj kryesor. Po ashtu, injektimet me maturitet njëditor dhe 3-mujor kanë qenë të pranishme, por në një masë më të ulët.


2.1.3 Tregu i këmbimit të monedhës

Kursi i këmbimit të Lekut ka vijuar të mbiçmohet ndaj valutave kryesore, duke reflektuar zhvillimet pozitive në flukset hyrëse të valutës në bilancin e pagesave.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, vijoi prirja e mbiçmimit të lekut kundrejt euros, e cila u mbështet nga rritja e konsiderueshme e hyrjeve valutore nga eksporti i shërbimeve në bilancin e pagesave. Në fund të periudhës, kursi i këmbimit të euros ishte 104.1 lekë, dhe kjo vlerë përfaqësonte një mbiçmim të lekut me gati 3% kundrejt gjashtë muajve më parë dhe me 9% kundrejt një viti më parë. Mbiçmimi i lekut u përshpejtua veçanërisht në muajin gusht (me gati 4%) si efekt dhe i sezonalitetit. Gjatë këtij muaji, monedha Euro regjistroi vlerën më të ulët historike të këmbimit të saj ndaj monedhës Lek, prej 103.2 lekësh për 1 euro.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvillojë ankande për blerjen e euros, sipas kalendarit të publikuar paraprakisht duke i shërbyer objektivit për rritjen e rezervës valutore.

Grafik 37. Kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbiçmimi i lekut ka qenë i ndjeshëm edhe ndaj dollarit amerikan. Në muajin dhjetor, 1 dollar amerikan këmbehej me mesatarisht 96.6 lekë duke pasqyruar një mbiçmim të lekut me 2% kundrejt gjashtë muajve më parë dhe me 11% në krahasim me një vit më parë. Gjatë periudhës, Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvillojë ankande për blerjen e euros, sipas kalendarit të publikuar dhe me objektiv rritjen e rezervës valutore.

2.2 Tregu i pasurive të paluajtshme

Sipas vërtimit të posaçëm të Bankës së Shqipërisë mbi kushtet e tregut të pasurive të paluajtshme dhe çmimet për pasuritë e paluajtshme rezidenciale, rezulton që subjektet e pyetura e vlerësojnë pozitivisht gjendjen e përgjithshme të tregut por raportuan për rënie të çmimeve të pasurive të paluajtshme rezidenciale.

Shitjet u rritën lehtë në krahasim me dy gjashtëmujorët e mëparshëm, ndërkohë që numri i pronave të pashitura ka rënë. Kërkesa nga jorzidentët mbetet e pranishme dhe ka ardhur në rritje në krahasim me periudhat e kaluara.

Kërkesa u mbështet nga kredia bankare për blerjen e pronave të paluajtshme për

Kërkesa për pasuri të paluajtshme rezidenciale është paraqitur e qëndrueshme. Ky vlerësim mbështetet mbi të dhënat e vërtimit për gjendjen e tregut të pasurive të paluajtshme dhe ecurinë e çmimit të banesave, të dhënat e raportuara nga bankat dhe të dhënat e tjera administrative. Sipas vërtimit, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme raportojnë për ecuri të mirë të vëllimit të shitjeve dhe rënie të numrit të pronave të pashitura. Kërkesa e jorzidentëve ka shfaqur rritje në periudhën e fundit, duke zënë rreth 26% të blerjeve gjatë periudhës.

Koha mesatare e shitjes, sipas vërtimit, është rritur lehtë në 10.9 muaj nga 10.6 muaj, por ecuria sipas zonave paraqitet e ndryshme. Koha e shitjes për zonën e Tiranës është shkurtuar me 2 muaj, ndërsa koha mesatare e shitjes për zonat bregdetare dhe për zonat e tjera paraqitet me rritje. Pavarësisht numrit të kufizuar të raportimeve lidhur me shitjet në përgjithësi dhe këtë tregues në veçanti, qëndrueshmëria nga periudha në periudhë, tregon që ky tregues mund të lexohet si një sinjalizues i mirë i ecurisë së kërkesës dhe ofertës në tregun e pronave të paluajtshme.

Kredia për blerje të pasurive të paluajtshme për individët vijoi të rritet. Në fund të periudhës teprica e saj shënoi vlerën 180 miliardë lekë, duke u rritur me 4.7% gjatë periudhës dhe me 8.4% kundrejt një viti më parë. Pjesa më e madhe e kredisë së marrë nga individët për të financuar blerjen e pasurive të paluajtshme përfaqësohet nga kredia në monedhën Lek dhe pesha relative e këtij portofoli gjatë 5 vjetëve të fundit është rritur nga 50% në 62%. Gjatë periudhës, bankat kanë shtrënguar përgjithësisht kushtet e

individë dhe biznese, e cila ka vijuar të rritet me ritme të shpejta pavarësisht niveleve më të larta të normave të interesit.

Në tërësi, oferta për prona të paluajtshme, e matur nga ecuria e numrit të lejeve të ndërtimit, ka vijuar të rritet me ritme të ngjashme me ato të periudhave të kaluara, ndërkohë që sipërfaqja mesatare e lejeve të reja të ndërtimit është rritur.

Teprica e kredisë bankare për ndërtim e drejtuar për bizneset, nuk ka treguar ndryshime gjatë periudhës, ndërsa kostot e ndërtimit janë rritur, kryesisht për shkak të rritjes në shpenzimet për paga dhe energji.

Vrojtimi tregon se indeksi i çmimit të banesave në rang vendi dhe për Tiranën ra me përkatësisht 7.6% dhe 10.1% në terma gjashtëmujorë, duke u rikthyer pranë nivelit mesatar të një viti më parë. Nga ana tjetër, çmimet e qirasë janë raportuar në rritje.

kësaj kredie nëpërmjet rritjes së normave të interesit. Cilësia e saj mbetet e mirë, por raporti i kredive me probleme u rrit në 3.2%, nga rreth 2% një gjashtëmujor më parë dhe 2.3% një vit më parë.

Një pjesë e konsiderueshme e kërkesës në tregun e pasurive të paluajtshme vjen nga sektori i biznesit dhe ky tregues i kredisë²⁴ ka shënuar rritje të lartë gjatë vitit 2023. Me një stok prej rreth 160 miliardë lekësh, kredia e marrë nga bizneset për pasuri të paluajtshme deri në fund të vitit 2023 zinte rreth 38% të tepricës së kredisë së përgjithshme të bizneseve. Në ndryshim nga kredia për sektorin e individëve, në kredinë e marrë nga bizneset për blerjen e pasurive të paluajtshme mbizotëron kredia në valutë, që zë 60% të stokut të të gjithë kredisë për këtë qëllim. Në fund të periudhës, stoku i të gjitha kredive bankare të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme ishte 330 miliardë lekë ose 50 miliardë lekë më i ulët nga niveli i gjashtë muajve më parë. Rreth 47% e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme mbahet nga sektori i individëve.

Treguesit e ofertës për ndërtesa banimi u paraqitën të qëndrueshëm.

Sipas të dhënave të INSTAT, numri prej 520 lejevash për ndërtesa të reja banimi të dhëna gjatë gjysmës së dytë të vitit ishte më i ulët nga 770 leje të dhëna gjatë gjashtëmujorit të parë, por sipërfaqja e vlerësuar për lejet e reja është pranë asaj të periudhës paraardhëse. Ky zhvillim tregon se çdo leje ndërtimi e re është raportuar me sipërfaqe (mesatarisht) më të madhe. Analiza më afatgjatë, evidenton që *numri i lejeve* për ndërtesa banimi në raport me numrin e lejeve të përgjithshme për ndërtesa, është rikthyer në vlerat e fillimit të vitit 2020 (76%), pasi u ngjiti deri në rreth 84% në tremujorin e dytë të vitit 2023.


Në tremujorin e fundit të 2023, numri i lejeve për ndërtesat e banimit me 3 ose më shumë kate zinin 20% të totalit të lejeve të ndërtesave për banim ose diçka më pak nga mesatarja afatmesme prej 24%. *Në terma të sipërfaqes*, pesha e lejeve për ndërtesa banimi ndaj lejeve të përgjithshme për ndërtesa është rreth 77%, pa ndryshime të dukshme ndaj mesatares afatgjatë. Në tremujorin e fundit të vitit 2023, sipërfaqja e lejeve për ndërtesat e banimit me 3 ose më shumë kate zinte 92% të sipërfaqes së përgjithshme të ndërtesave për banim.

Gjatë viteve të fundit, pjesa dërrmuese e lejeve për ndërtesa banimi ka shkuar për rezidenca banimi me një deri në dy kate, të cilat kanë një segment tregu më të përzgjedhur dhe një vlerë relativisht më të lartë se mesatarja e tregut. Pavarësisht kësaj, kur analizohet sipërfaqja e banimit për lejet e dhëna, vërehet se ajo që përfaqëson banesa për përdorim të gjerë nga publiku (rezidenca banimi me tre ose më shumë kate), ka pasur një ecuri të qëndrueshme duke zënë kështu peshën kryesore në totalin e sipërfaqes së miratuar për ndërtesa banimi. Në linjë me qëndrueshmërinë e ecurisë së ofertës, vërehet që pesha e kredisë për ndërtim ndaj tepricës së kredisë së bizneseve ka mbetur thuajse e pandryshuar nga periudhat e mëparshme, duke zënë rreth 17% në fund të periudhës. Kostot e ndërtimit të matura nga Indeksi i Kushtimit në Ndërtim vijuan të rriten. Ndryshimi vjetor në indeksin e përgjithshëm ishte 4.1%, ndërkohë që zërat me rritjen më të lartë

²⁴ Një pjesë e rritjes së këtij stoku gjatë tremujorëve të tretë dhe të katërt të vitit 2023 lidhet me riklasifikimin e një pjese të portofolit të kredisë "për blerje pajisjesh" në kredi "për blerjen e pasurive të paluajtshme".


ishin shpenzimet për energji (+9%), shpenzimet për paga (+4.5%), shpenzimet e transportit (+3.9%) dhe kosto të tjera (+3.9%). Kredia për ndërtim u rrit lehtë me 1.5% gjatë gjashtëmujorit dhe nuk tregoi ndonjë ndryshim të dukshëm ndaj një viti më parë.

Grafik 38. Numri i lejeve të ndërtimit sipas llojit




Burimi: Instat.

Grafik 39. Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit sipas llojit




Pavarësisht qëndrueshmërisë së kërkesës, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme dhe përfaqësues të kompanive të ndërtimit, kanë raportuar çmime shitjeje më të ulëta në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Sipas indeksit Fischer²⁵, çmimi mesatar i banesave të shitura gjatë periudhës është ulur me 7.6% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, duke mbetur rreth 3.2% mbi nivelin e një viti më parë. Indeksi i çmimeve për pronat e shitura në Tiranë regjistroi një rënie prej 10.1% ndaj periudhës paraardhëse, dhe vetëm pak më i lartë në krahasim me vlerën e një viti më parë. Në të njëjtën kohë vërehet se në gjashtëmujorin e dytë, është rritur pesha e transaksioneve ku çmimi i blerjes së pronës për shitjet e kryera ishte i njëjtë me çmimin e kërkuar nga shitësi.

Grafik 40. Indeksi Fischer i Çmimit të Banesave për Tiranën dhe për të gjithë territorin



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 41. Çmimi i transaksionit të shitjes në krahasim me çmimin e kërkuar



Çmimet e qirasë sipas agjentëve kanë shënuar rritje gjatë periudhës. Ky informacion mbi kërkesën dhe çmimet e qirasë vjen kryesisht nga agjentët që kryejnë aktivitetet në zonën e kryeqytetit. Sipas tyre, kërkesa e përgjithshme për marrje me qira raportohet më e lartë nga kërkesa gjatë gjashtëmujorit të mëparshëm. Vlerësimet e subjekteve për gjendjen e tregut dhe çmimet në tregun e banesave mbeten përgjithësisht pozitive për afatin e shkurtër dhe afatin më të gjatë.

²⁵ Ky indeks ndërtohet mbi bazën e një vrojtimi të posaçëm. Analiza për këtë vrojtim publikohet e plotë në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë (www.bankofalbania.org).

Hapësirë informuese 1. Përmbledhje e rezultateve të vërtetimit “Tregu i pasurive të paluajtshme” dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për 6M II-2023

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës nga ana e agjentëve në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vërtetimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme. Subjektet e zgjedhura janë agjentë të zyrave të tregimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëri ndërtimi shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar. Krahas informacionit për ecurinë e Indeksit Fischer të çmimit të banesave të shitura në rang vendi, të përmendur më sipër në këtë raport, informacioni nga vërtetimi tregon që:

Vlerësimi i përgjithshëm i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut u raportua si lehtësisht më pozitiv në krahasim me periudhën e kaluar. Në përgjigje të pyetjes “Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?”, balanca neto e përgjigjeve ishte thuhet neutrale 2%, por me përgjigje më optimiste për zonën e qyteteve bregdetare, ku vlera e balancës ishte dukshëm më pozitive sesa mesatarja afatgjatë. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje rezultoi ndjeshëm më pozitiv gjatë periudhës, me një balancë neto rreth 13%.

Numri i banesave të reja të regjistruara nga agjentët paraqet një rënie të lehtë në krahasim me periudhën paraardhëse. Balanca neto e atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre, ishte rreth -4.5%, ose pranë nivelit neutral. Numri i pronave të pashitura, si për banesa, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjashtëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi u rrit shumë lehtë në 10.9 muaj nga 10.6 muaj në vërtetimin e mëparshëm. Në rastin e Tiranës koha mesatare e shitjes është raportuar e ulur ndjeshëm, në 8.3 nga 10.5 muaj. Koha mesatare për shitjet në zonat bregdetare u rrit lehtë në 10.9 muaj, ndërsa për zonat e tjera kohëzgjatja e shitjes ishte dukshëm më e lartë sesa në gjashtëmujorin e kaluar, nga 10.9 në 13.6 muaj.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare ka vijuar të figurojë në një pjesë të mirë të shitjeve të pronave. Sipas agjentëve, ashtu si periudhën e kaluar, rreth 60% e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Nga këto, në 60% të rasteve, kredia ka mbuluar deri në 60% të vlerës.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të viti 2023, rreth 26% të banesave të shitura janë raportuar të blera nga shtetas jorezidentë. Nga këta, rreth 2/3 rezultojnë shtetas të vendeve të BE-së. Në tërësi, pesha e blerësve jorezidentë është rikthyer në rritje pas një ecurie në rënie që prej vitit 2020.

Pritjet për të ardhmen paraqiten pozitive pavarësisht pasigurive të ndryshme. Agjentët kanë pritje pozitive për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe për periudhën më afatgjatë (deri në dy vjet).

2.3 Sistemet e pagesave


Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase dhe në euro, ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Gjatë periudhës është regjistruar rritje e vlerës

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan gjatë periudhës 82 mijë pagesa me një vlerë prej 5,500 miliardë lekësh, ku përkatësisht numri i transaksioneve ka pësuar një rënie të lehtë

dhe numrit të transaksioneve në sistemet e pagesave. Sipas instrumenteve të pagesave, përdorimi i kartave për kryerjen e pagesave ka vijuar të rritet në mënyrë të ndjeshme dhe aktualisht zë peshën kryesore në pagesat e kryera.

prej 2.6%, dhe një rënie më të ndjeshme në vlerë prej 22%²⁶ krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës janë kleruar rreth 730 mijë pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 142 mijë lekësh. Ndër vite ka vijuar rritja e numrit të transaksioneve dhe nga ana tjetër rënia e vlerës mesatare për transaksion, e cila tregon edhe një përdorim më të lartë të sistemit AECH nga publiku në tërësi. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje të transaksioneve si në numër, ashtu edhe në vlerë, me përkatësisht 13% dhe 10%.


Grafik 42. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjashtëmujorin e dytë të viteve 2022-2023



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Edhe sistemi AIPS-EURO ka regjistruar rritje të ndjeshme të transaksioneve, në numër dhe në vlerë, me përkatësisht 25% dhe 20%. Kjo infrastrukturë ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet. Për periudhën në fjalë në këtë sistem janë shlyer 138 mijë pagesa me një vlerë prej 2,260 milionë euro. Sistemi AIPS-EURO është një mekanizëm shtesë për Bankën e Shqipërisë që jo vetëm mundëson uljen e kostos së subjekteve që kryejnë transaksione pagesash në euro, por ndihmon në monitorimin e këtij segmenti të tregut dhe në formalizimin e ekonomisë.

Grafik 43. Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 44. Ecuria e pagesave për klientë në sistemin AIPS - EURO përgjatë vitit 2023



²⁶ Rënia e vlerës së transaksioneve reflekton zhvendosjen/ekzekutimin e mjaft veprimeve për realizimin e shpenzimeve të fundit të vitit 2023, në muajin janar 2024.

Përdorimi i instrumenteve të pagesave për kryerjen e tyre ka njohur gjithashtu rritje në numër dhe në vlerë. Gjatë periudhës janë kryer rreth 21 milionë pagesa me një vlerë totale prej 3,240 miliardë lekësh, dhe rritja në numrin dhe vlerën e këtyre pagesave në krahasim me gjashtëmuajorin e parë ishte përkatësisht 13% dhe 12%. Pagesat me karta zënë vendin kryesor të instrumenteve të pagesave, duke përfaqësuar rreth 62% të totalit dhe kjo vlerë ka ardhur në rritje të vazhdueshme. Numri i pagesave me kartë gjatë periudhës ishte 23% më i lartë në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit dhe rreth 8% më i lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Kjo ecuri flet për një rritje të ndjeshme të përdorimit të kartave në tregun shqiptar. Në të njëjtën kohë, vihet re një rritje e ndjeshme e numrit dhe vlerës së transfertave të kreditit në formë joleter (*internet banking, mobile banking*) me rreth 20% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

3. Sistemi financiar


Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, pesha e aktiveve të sistemit financiar²⁷ ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u rrit me 2 pikë përqindjeje, në nivelin 93.9%. Në terma vjetorë, ky tregues ka rënë me 2.6 pikë përqindje, dhe kjo lidhet me faktin që norma vjetore e rritjes së PBB-së ishte më e lartë në krahasim me atë të rritjes së bilancit të sistemit financiar. Në këtë rënie, sektori bankar ka kontribuar me pothuaj 3 pikë përqindje. Brenda sistemit financiar, sektori bankar vijon të mbizotërojë me gati 91% të totalit të aktiveve. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe ka shënuar rritje gjatë periudhës. Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht treguesit e ndërlidhjes në kuadër të vlerësimit periodik të rreziqeve sistematike.

Tabelë 4. Peshat e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së²⁸ në vite (në %)

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë			Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare			Ndërmjetësimi financiar
	Spektori bankar	IFJB	SHKK dhe	Shoqëri sigurimi	Fonde pensioni	Fonde investimi	
Sistemi financiar							
2011	86.1	2.6	0.8	1.5	0.0		91.0
2012	89.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	95.4
2013	91.4	2.6	0.7	1.6	0.0	3.7	100.2
2014	92.7	2.8	0.8	1.8	0.0	4.6	102.7
2015	91.9	2.7	0.7	2.0	0.1	4.7	102.0
2016	95.5	2.8	0.6	2.0	0.1	4.5	105.5
2017	93.2	2.9	0.5	2.0	0.1	4.7	103.4
2018	88.8	3.2	0.6	1.9	0.1	4.2	98.8
2019	87.2	3.9	0.6	2.0	0.2	4.0	97.9
2020	97.8	4.2	0.7	2.4	0.2	4.2	107.5
2021	95.5	4.1	0.7	2.2	0.2	4.2	107.0
2022	87.8	3.8	0.7	2.0	0.3	1.9	96.5
2023	85.0	3.8	0.7	2.0	0.3	2.2	93.9

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 45. Peshat e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2023



²⁷ Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar. Baza e të dhënave për të gjitha subjektet e sistemit financiar dhe PBB-ja i përkasin tremujorit të katërt të vitit 2023, me përjashtim të shoqërive të sigurimit, bilanci i të cilave i referohet tremujorit të tretë të vitit 2023.

²⁸ Peshat në tabelë janë llogaritur duke përdorur PBB-në nominale me çmime korrente sipas INSTAT.

3.1 Sektori bankar

3.1.1 Zhvillimet kryesore në sektorin bankar


E gjithë rritja e bilancit të sektorit bankar për vitin 2023, prej rreth 5%, u përqendrua në gjashtëmujorin e dytë të vitit.

Në zgjerimin e aktivitetit të sektorit bankar kontribuuan së bashku, investimet në tituj, kreditimi dhe veprimet me thesarin dhe ndërbankare. Në krahun e pasivit, në këtë ecuri kontribuuan rritja e depozitave të publikut dhe rritja e kapitalit.

Gjatë periudhës, efekti statistikor negativ i mbiçmimit të lekut ndaj monedhave të huaja mbi treguesit e bilancit të sektorit bankar, ishte më i zbutur. Megjithatë ai vlerësohet të ketë ndikuar negativisht në vlerën e bilancit për rreth 30 miliardë lekë.


E gjithë rritja e bilancit të sektorit bankar për vitin 2023, prej rreth 5%, u përqendrua në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 100 miliardë lekë gjatë periudhës duke arritur në rreth 1,960 miliardë lekë në fund të vitit. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë zgjerimi i investimeve në tituj me rreth 50 miliardë lekë dhe atyre në kredi me rreth 30 miliardë lekë. Veprimet me thesarin dhe ndërbankare u shtuan me 40 miliardë lekë nga rritja në zërin "marrëdhënie me bankën qendrore". Zëri i vetëm që regjistroi rënie gjatë periudhës ishte ai i veprimeve ndërbankare që ra me 9 miliardë lekë (ose 6%), ndikuar nga pakësimi në nivelin e depozitave me bankat dhe institucionet e tjera financiare, kryesisht jorezidente. Tkurrja e fondeve të provigjioneve të sektorit bankar kontribuoi në rritjen e aktiveve me 1 miliardë lekë. Gjatë periudhës, efekti statistikor negativ i mbiçmimit të lekut ndaj monedhave të huaja ndaj treguesve të bilancit të sektorit bankar, ishte më i zbutur.

Grafik 46. Ecuria e aktivitetit sipas përbërësve, kontribut në p.p



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 47. Struktura e bilancit të bankave në %




Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj

Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të bilancit ka mbetur e qëndrueshme. Në fund të periudhës, aktivet dhe detyrimet e sektorit bankar në valutë zinin përkatësisht 51% dhe 50% të totalit të bilancit,

totalit të bilancit ka mbetur e qëndrueshme në 50-51%. Pozicioni kreditor neto i sektorit bankar ndaj jorezidentëve, mbeti pranë nivelit 19%.

dhe këto raporte janë ruajtur gjatë periudhës pavarësisht efektit të mbiçmimit të kursit të këmbimit. Në vlerë absolute, bankat raportuan nivele të përafërta të aktiveve dhe detyrimeve në valutë, në vlerat 1,000 miliardë dhe 983 miliardë lekë, duke paraqitur kështu një pozicion të ekuilibruar të aktivitetit në valutë për sektorin bankar. Nga ana e aktiveve në valutë, zërat me peshën më të madhe mbeten aktiviteti kreditues dhe investimet ndërbankare. Por gjatë tre viteve të fundit është vërejtur edhe rritje e peshës së investimeve në letrat me vlerë. Nga ana e detyrimeve në valutë, struktura paraqitet më e qëndrueshme në vite dhe mbizotërohet nga depozitat në valutë. Zërat e mësipërm kanë përcaktuar në masën më të madhe ndryshimin e sektorit bankar ndaj ndryshimeve në kursin e këmbimit.

Grafik 48. Struktura e aktiveve dhe detyrimeve në valutë, dhjetor 2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma vjetorë, aktivet dhe detyrimet në valutë u zgjeruan me 1% dhe 2%, por të korrigjuara për efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit, këto norma rritjeje llogariten përkatësisht në 10% dhe 12%. Efekti statistikor i mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut, në krahasim me një vit më parë, ishte negativ, dhe ky efekt e pakësoi me rreth 30 miliardë lekë vlerën e raportuar të bilancit valutor të sektorit bankar. Në krahasim me gjysmën e parë të vitit, efekti statistikor paraqitet më i ulët, ndërkohë që në tremujorin e tretë të vitit ky efekt rezultoi pozitiv.

Në anën e aktivitetit, forcimi i monedhës vendase ka pasur ndikim më të madh në zërat kryesorë të bilancit si veprimet me titujt, veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare (nga rreth 10 miliardë lekë). Në anën e pasivit, efekti i kursit mbi vlerën e raportuar të depozitave në valutë vlerësohet në rreth 25 miliardë lekë. Efekti pakësues statistikor i kursit të këmbimit është ndjerë edhe mbi pjesën në valutë të kapitalit të sektorit bankar, me një vlerë rreth 15 miliardë lekë.


Grafik 49. Efekti i kursit të këmbimit në kundërvlerën në lekë të zërave kryesorë të aktivitetit (majtas) dhe pasivit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Financimi i veprimtarisë së bankave ka vijuar të mbështetet në depozitat dhe fondet e veta, ndërkohë që rritja më e madhe e aktiveve ndaj detyrimeve me jorezidentët ka zgjeruar pozicionin kreditor të bankave vendase. Depozitat dhe fondet e veta zënë 93% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë ka qenë e qëndrueshme gjatë periudhës. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e ulët megjithatë për periudhën shënoi rritje, si pasojë e rritjes së detyrimeve të bankave ndaj jorezidentëve. Rritja e detyrimeve ka ardhur si rezultat i zgjerimit të veprimeve me klientët në formën e depozitave dhe burimeve të përhershme në formën e borxhit të varur. Të dy këta zëra zënë një peshë të konsiderueshme në strukturën e detyrimeve ndaj jorezidentëve, prej 53% dhe 17%. Aktivitetet e vendosura pranë subjekteve jorezidente u zgjeruan për shkak të rritjes së investimeve në tituj të emtuar nga jorezidentët. Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 22% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve zinin vetëm 2% të totalit të bilancit. Pozicioni kreditor neto shënoi rritje në terma absolutë ndaj një gjashtëmujori dhe një viti më parë, por në terma relativë ruajti thujtë të pandryshuar nivelin prej 19% të totalit të aktiveve të sektorit bankar.

Grafik 50. Detyrimet ndaj jorezidentëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 51. Pozicioni neto me jorezidentët²⁹



3.1.1.1 Indeksi i shëndetit bankar

Indeksi i shëndetit bankar tregon për një përmirësim të gjendjes së sektorit gjatë periudhës, falë përmirësimit të ndjeshëm në rezultatin financiar.

Në periudhën 2014-2023, indeksi ka treguar përmirësim të gjendjes së sektorit bankar, me kontributin kryesor nga përmirësimi në cilësinë e aktiveve dhe nivelet e kapitalizimit.


Indeksi i shëndetit bankar tregon që situata e përgjithshme e sektorit bankar është përmirësuar gjatë periudhës. Indeksi i shëndetit bankar i llogaritur me të dhënat e fundit të periudhës shënoi vlerën 0.36³⁰, duke shfaqur një përmirësim ndaj situatës së gjashtë muajve dhe një viti më parë. Kjo ecuri u diktua kryesisht nga përmirësimi i notës së treguesit të përfitueshmërisë, që erdhi si rezultat i rritjes së ndjeshme të fitimit të sektorit bankar dhe i përmirësimit të treguesit të kthimit nga aktivitetet. Me përmirësim gjatë periudhës u shfaqën nënindekset e likuiditetit dhe të eficiencës, nënindeksi i cilësisë së aktiveve u shfaq i qëndrueshëm, ndërsa nënindeksi i kapitalizimit erdhi në rënje duke reflektuar rënien e peshës së kapitalit të nivelit të parë në vlerën e kapitalit rregullator.

Për grupin e bankave sistematike, indeksi sinjalizon përmirësim në krahasim me të dy gjashtëmujorët e kaluar. Këto banka shfaqin përmirësim në nënindekset e cilësisë së aktiveve, likuiditetit dhe veçanërisht atë të eficiencës që tregon për përmirësim të treguesve që lidhen me shpenzimet.

²⁹ Vija e zezë vertikale (grafiku djathtas) pasqyron periudhën e transformimit të degës së BKT-së në Kosovë, në Filial.


³⁰ Rënia e vlerës së indeksit përfaqëson një përmirësim të gjendjes financiare dhe e kundërta.

Grafik 52. Indeksi i shëndetit bankar³¹



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Harta e shëndetit bankar³²



Indeksi i shëndetit bankar tregon një ecuri më të mirë të bankave me kapital të huaj në krahasim me bankat me kapital shqiptar. Për bankat me kapital vendas vërehet përmirësim në drejtim të përfitueshmërisë, cilësisë së aktiveve dhe eficiencës, ndërkohë që kapitali dhe likuiditeti paraqiten në nivele më pak të mira në krahasim me dy periudhat paraardhëse.

Në tërësi, gjatë viteve 2014-2023, indeksi i agreguar i shëndetit bankar flet për përmirësim të shëndetit dhe rritje të qëndrueshmërisë së të gjithë sektorit bankar. Ky përmirësim lidhet në mënyrë të veçantë me përmirësimin e cilësisë së aktiveve dhe të kapitalit. Në të njëjtën kohë, ndjeshmëria e indeksit ndaj niveleve të përfitueshmërisë është bërë më e rëndësishme që nga tremujori i parë i vitit 2020.

3.1.1.2 Kapitalizimi i veprimtarisë

Mjaftueshmëria e kapitalit


Sektori bankar e mbylli vitin 2023 me një nivel të mirë të kapitalizimit të veprimtarisë. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit rezultoi 19.4%, duke u rritur me 0.4 pikë përqindje gjatë periudhës, dhe me 1.3 pikë përqindje në terma vjetorë. Në rritjen e këtij treguesi ka kontribuar rritja e vlerave të kapitalit rregullator.

Rritja e kapitalit rregullator të bankave gjatë periudhës sollti rritjen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin 19.4% në fund të vitit 2023. Ky tregues për secilën bankë është mbi nivelin minimal të kërkuar prej 12%. Gjatë periudhës, kjo normë u rrit me 0.4 pikë përqindje, ndërsa në terma vjetorë rritja është 1.3 pikë përqindjeje. Në nivel mesatar, normën më të lartë të mjaftueshmërisë së kapitalit e mbajnë bankat me kapital evropian dhe bankat josistemike. Bankat me kapital shqiptar raportojnë një nivel më të ulët të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në krahasim me grupet e bankave të tjera, por ky nivel gjatë vitit 2023 është rritur me 1 pikë përqindje.


³¹ Sa më e lartë vlera, aq më i lartë rreziku. Gjerësia e çdo dimensionit nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.

³² Larg nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1.

Grafik 54. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Grafik 55. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit




Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në rritjen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë periudhës, ndikimi negativ i rritjes me 3% të aktiveve të peshuara me rrezik, u shua nga rritja me rreth 5% e kapitalit rregullator. Gjatë periudhës, kapitali rregullator i bankave u rrit me rreth 10 miliardë lekë, duke u ngjitur në nivelin e 190 miliardë lekëve. Ecuria e kapitalit rregullator u përcaktua nga rritja e kapitalit të paguar, zgjerimi i fitimit të pashpërndarë si dhe rritja e borxhit të varur të njohur si kapital i nivelit të dytë. Në terma vjetorë, ritmi i rritjes së kapitalit rregullator ishte më i ulët ndikuar kryesisht nga thellimi i diferencave negative të rivlerësimit. Fitimi i pashpërndarë i periudhave të mëparshme ka ndihmuar në rritjen e kapitalit rregullator dhe ky kontribut ka ardhur në rritje.

Rritja e aktiveve të peshuara me rrezik, që në fund të vitit arritën në 960 miliardë lekë, u mbështet kryesisht nga zgjerimi i atyre për rrezikun operacional. Aktivitet e peshuara me rrezik sipas rreziqeve vijojnë të dominohen nga aktivitet e peshuara për rrezikun e kredisë (86%), ndërsa aktivitet e peshuara për rrezikun e tregut dhe atij operacional zënë përkatësisht 1% dhe 13% të totalit. Në raport me totalin e aktiveve, pesha e aktiveve të peshuara me rrezik u tkurr në nivelin 49% nga niveli mesatar i 3 viteve të fundit prej 52%, si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të investimeve në aktive të klasifikuara si pa rrezik.

Grafik 56. Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit rregullator sipas elementeve përbërëse (në pikë përqindjeje)



Grafik 57. Ecuria e levës financiare sipas përbërësve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, raporti i levës financiare³³ në dhjetor 2023 ka rënë me 0.1 pikë përqindje, në nivelin 8.5%. Kjo ecuri erdhi si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të ekspozimeve totale për efekt të levës financiare

³³ Në 1 janar 2022 hyri në fuqi rregullorja nr. 63/2020 "Për raportin e levës financiare të bankave", sipas të cilës raporti i levës financiare llogaritet si raport i kapitalit të nivelit të parë të bankës me ekspozimin total të bankës në datën e raportimit.

krahasuar me rritjen e kapitalit të nivelit të parë. Bankat kanë siguruar një raport të levës financiare mbi nivelin rregullator 5.75% në baza individuale. Raporti i levës financiare për sektorin bankar përcaktohet kryesisht nga bankat me rëndësi sistemike. Bankat me kapital të huaj kanë nivelin më të lartë të raportit të levës financiare, duke rritur kështu potencialin për të financuar vijueshmërinë e aktivitetit. Bankat me kapital shqiptar llogarisin një raport më të ulët të levës financiare krahasuar me grupet e tjera.

Teprica e kapitalit dhe përmbushja e kërkesave rregullative për shtesat makroprudenciale të kapitalit

Aktualisht, bankave iu kërkohet të përmbushin disa kërkesa për nivelet e kapitalit, ku përfshihen shtesat makroprudenciale të kapitalit dhe ato për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL).

Me qëllim forcimin e pozitave të kapitalit gjatë periudhës, bankat kanë rritur rezervat nga fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur.

Në fund të periudhës, sektori bankar në tërësi arriti t'i përmbushte këto kërkesa për fundin e vitit 2023 sipas kalendarit të përcaktuar, dhe të regjistronte një tepricë kapitali pozitive.

Gjatë vitit 2023 bashkësia e shtesave makroprudenciale të kapitalit nuk ka ndryshuar me përjashtim të rritjes, sipas Rregullores³⁴, së shtesës konservuese të kapitalit nga 1.5% në 2%. Shtesat makroprudenciale të kapitalit kanë për qëllim përmirësimin e rezistencës së bankave ndaj rreziqeve sistemike me natyrë ciklike dhe strukturore. Për këtë qëllim, bankat ndërtojnë rezerva kapitali për të përthithur humbjet e mundshme, dhe këto rezerva krijojnë hapësirë për mbështetjen e ekonomisë reale me financim në kohë më të vështira. Në përputhje me rregulloren "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", bankat janë subjekt i shtesës konservuese të kapitalit (Kons), shtesës kundërciklike të kapitalit (Kunc), shtesës për bankat me rëndësi sistemike (Sist) dhe shtesës për rrezikun sistematik (Struk). Shtesa konservuese e kapitalit për vitin 2023 ishte 2% për të gjitha bankat e sektorit, ndërsa shtesa për bankat sistemike lëviz në vlerat 0.5%, 1% dhe 1.5%, në varësi të rëndësisë sistemike të bankës. Shtesa kundërciklike e kapitalit është 0% dhe deri në kohën e përgatitjes së këtij raporti, Banka e Shqipërisë nuk ka shpallur shtesë për rrezikun sistematik (Struk).

Në dhjetor 2023, bankat që janë subjekt i kërkesave për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL)³⁵ kanë vijuar me plotësimin e kërkesave shtesë sipas kalendarit të miratuar. Kundrejt një viti më parë, shtesa e MREL ishte 1.7 pikë përqindjeje. Përfshirja e MREL ndikon shkallën e përmbushjes së shtesave makroprudenciale për bankat që janë subjekt i zbatimit të MREL. Kjo ndodh në kushtet kur dhe deri në masën që, banka përdor instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë për përmbushjen e MREL. Plotësimi i MREL me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë shoqërohet me rënien e kapitalit neto të disponueshëm (KNDr) për përmbushjen e shtesave makroprudenciale të kapitalit (SHKOMAK).

Duke marrë në konsideratë shtesat e mësipërme, si dhe shtesën specifike që kanë disa banka të sektorit bankar, kufiri i raportit të kërkuar të mjaftueshmërisë së kapitalit lëviz në intervalin 18%-20% për bankat me rëndësi sistemike dhe 14%-17% për bankat e tjera. Në fund të periudhës, në tërësi, normat e

³⁴ Rregullorja nr. 41, datë 5.6.2019, "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".


³⁵ Vlerësohen 5 banka të sektorit, të cilat janë subjekt i plotësimit të "Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar" (MREL), në përputhje me kërkesat e parashikuara në rregulloren nr. 78, datë 16.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Banka ka detyrimin të plotësojë sipas radhës kërkesat minimale për kapitalin rregullator, kërkesën minimale për MREL dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit.

mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike dhe bankat e tjera, qëndronin mbi nivelet e mësipërme rregullative.

Në fund të periudhës, në tërësi, sektori bankar rezultonte me tepricë pozitive të kapitalit, të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave përkatëse rregullative. Ecuria e tepricës së kapitalit diktohet nga ecuria e fitimit të bankave, sjellja e elementeve të kapitalit rregullator, dhe kërkesat rregullatore që duhet të përmbushen (shtesat makroprudenciale të kapitalit/MREL). Teprica e kapitalit ose kapitali i disponueshëm deri në fund të periudhës arriti në nivelin 46 miliardë lekë, ose rreth 10 miliardë lekë më shumë se teprica në fund të gjysmës së parë të vitit. Rritja e kapitalit të disponueshëm ka ardhur si rrjedhojë e zhvillimeve në ecurinë e kapitalit rregullator³⁶. Me qëllim forcimin e vazhdueshëm të pozitive të kapitalit, bankat kanë rritur rezervat e krijuara nga fitimet e pashpërndara dhe kanë shtuar përdorimin e borxhit të varur. Të dy këta elementë kanë përmirësuar treguesit e kapitalit.


Bankat me rëndësi sistemike përcaktojnë ecurinë e tepricës së kapitalit të sektorit bankar, duke qenë se këto banka zotërojnë më shumë kapital në krahasim me bankat e tjera. Në fund të periudhës, teprica e kapitalit për këto banka shënonte 17 miliardë lekë, ose 2 miliardë lekë më shumë se teprica e një gjashtëmujori më parë, dhe zinte rreth 3% të aktiveve të peshuara me rrezik. Zgjerimi i kapitalit të disponueshëm për bankat me rëndësi sistemike ka ardhur si rrjedhojë e performancës së mirë financiare. Bankat e tjera në fund të vitit rezultojnë me një tepricë kapitali më të lartë se ajo e bankave sistemike si rezultat i nivelit më të ulët të kërkesave rregullative për t'u përmbushur nga këto banka. Në dhjetor 2023, kjo tepricë ishte 28 miliardë lekë, ose 8 miliardë lekë më shumë se teprica e kapitalit të një gjashtëmujori më parë.

Grafik 58. Teprica e kapitalit për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 59. Struktura e shtesave rregullatore të kapitalit, dhjetor 2023



3.1.1.3 Rezultati financiar

Rezultati neto dhe treguesit e përfitueshmërisë së sektorit bankar kanë shënuar rritje të fortë në krahasim me një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së konsiderueshme në të ardhurat neto nga interesat.

Gjatë vitit 2023, sektori bankar përmirësoi në mënyrë të ndjeshme treguesit e përfitueshmërisë. Fitimi i akumuluar gjatë vitit shënoi vlerën 32.5 miliardë lekë, rreth 50% më i lartë se fitimi i realizuar një vit më parë. Rritja e fitimit është pasqyruar në tregues më të lartë mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar; kthimi nga aktivet (RoA) rezultoi 1.7% dhe kthimi nga kapitali (RoE) rezultoi 17.3%. Një vit më parë këta tregues ishin përkatësisht 1.2% dhe 12.3%. Përmirësimi i fitimit ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes në të ardhurat neto nga interesat, në vijim të zgjerimit të marzhit të interesave. Sektori bankar raportoi rritje edhe në të ardhurat nga

³⁶ Ecuria e kapitalit rregullator në dhjetor 2023 u përcaktua nga rritja e kapitalit të paguar dhe zgjerimi i fitimeve të pashpërndara.

Kjo rritje lidhet me faktin që rritja e të ardhurave nga interesat ishte më e fortë sesa rritja në shpenzimet për interesa.

Rritje kanë shënuar edhe të ardhurat jo nga interesat, që kanë reflektuar një performancë më të mirë të investimeve në instrumentet financiare.

Rezultati neto i bankave është ndikuar pozitivisht edhe nga pakësimi i ndjeshëm i humbjeve nga investimet në instrumente financiare.

Një efekt negativ në rezultatin financiar të sektorit bankar dhe rritja e provigjioneve të përgjithshme të ndikuara nga rritja e provigjioneve për rrezikun e kredisë.


Performanca shumë më e mirë e të ardhurave në krahasim me rritjen e shpenzimeve të veprimtarisë ka përmirësuar nivelin e mbulimit të këtyre të fundit.

veprimtaritë e tjera, si rrjedhojë e kthimit të humbjeve nga instrumentet financiare në vlera pozitive. Nga ana tjetër, shpenzimet e veprimtarisë dhe ato për provigjione janë rritur, duke ndikuar negativisht në fitimin e sektorit bankar. Të ardhurat nga komisionet kanë vijuar të rriten dhe janë kthyer në një burim të rëndësishëm të ardhurash për sektorin bankar gjatë viteve të fundit.

Të ardhurat neto nga interesat, u rritën me 17.5 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë, duke arritur në rreth 70 miliardë lekë.

Rritja vjetore në rezultatin neto nga interesat për aktivitetin e bankave në monedhën vendase dhe në valutë ishte e krahasueshme. Të ardhurat nga interesat deri në fund të vitit llogariten në 83.4 miliardë lekë ose 22.6 miliardë më shumë në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për interesat ishin 5.1 miliardë lekë më të larta dhe arritën në rreth 14 miliardë lekë.

Grafik 60. Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Rritja e të ardhurave nga interesi u pasqyrua edhe në rritjen e marzhit neto nga interesat, në 4.3% nga 3.5% një vit më parë. Të ardhurat jo nga interesat të mbledhura nga bankat gjatë periudhës u rritën me 5.4 miliardë lekë, në nivelin 18.6 miliardë lekë, kryesisht pasi sektori bankar raportoi një fitim në vlera të vogla nga instrumentet financiare, të cilat gjatë vitit të kaluar kishin akumuluar humbje në nivelin 4.1 miliardë lekë. Të ardhurat nga komisionet gjatë vitit 2023 ishin rreth 1.6 miliardë lekë më shumë nga vlera prej 15 miliardë lekësh e regjistruar një vit më parë, duke kontribuar më tej në rritjen e fitimit të sektorit.

Tabelë 6. Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit bankar për qershor 2022-2023 (mld lekë)

	2023			2022
	Në lekë	Në valutë	Total	Total
Të ardhura nga interesat	49.7	33.7	83.4	61
Shpenzime për interesat	9.6	4.2	13.9	8.8
Të ardhura neto nga interesat	40.1	29.4	69.5	52
Të ardhura jo nga interesat	11.6	6.1	17.6	11.8
gjoja dhe komisione	10.0	6.5	16.6	15
humbje ose fitim nga instrumentet financiare	1.2	-0.7	0.4	-4.1
Shpenzime jo për interesa	36.3	10.1	46.5	38.5
Provizione (neto)	3.9	0.0	3.8	1.5
për kreditë	3.8	1.9	5.7	4.1
për mjete të tjera financiare	0.1	-2.0	-1.9	-2.6
Zëra të jashtëzakonshëm	-0.6	-0.2	-0.8	-1.4
Taksa mbi të ardhurat	5.2	0.0	5.2	3.5
Rezultati neto	6.8	25.7	32.5	21.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 61. Tregues të përfitueshmërisë dhe marzhi neto i interesit



Për shkak të rritjes më të shpejtë të të ardhurave, niveli i mbulimit të kostove të veprimtarisë nga të ardhurat e bankave është përmirësuar. Në krahasim me një vit më parë shpenzimet e veprimtarisë u rritën me 8 miliardë lekë në rreth 46.5 miliardë lekë. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave u ul ndjeshëm gjatë periudhës, në 53% nga 59%. Shpenzimet për provigjione për kredi gjatë vitit 2023 u rritën me 1.6 miliardë lekë kundrejt një viti më parë, në rreth 5.7 miliardë lekë. Në të njëjtën kohë, sektori bankar vazhdoi të raportojë rimarrje të shpenzimeve për provigjionimin e mjeteve të tjera financiare, por kjo vlerë ishte disi më e vogël në krahasim me atë të vitit 2022. Në total, shpenzimet për provigjione u rritën me 2.3 miliardë lekë, duke arritur në 3.8 miliardë lekë në fund të periudhës.

Përmirësimi i rezultatit financiar ka pasur një shpërndarje më të mirë midis bankave. Duke analizuar shpërndarjen e vlerave të treguesit të kthimit nga aktivet (RoA), vërehet se bankat që e kanë këtë tregues midis 2-3% zotërojnë rreth 29% të aktiveve të sektorit bankar, kundrejt një mesatare prej më pak se 10% e llogaritur për gjashtëmujorët përkatës të viteve 2020-2022. Pjesa më e madhe e bankave, që mbajnë rreth gjysmën e aktivitetit të përgjithshëm të sektorit bankar, raportojnë një tregues të kthimit nga aktivet në intervalin 1-2%.

3.1.1.4 Kredia

Teprica e kredisë u rrit me 4% gjatë periudhës dhe me rreth 3% në terma vjetorë. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht rritja e kredisë në lekë si dhe rritja e kredisë për prona të paluajtshme për individë dhe biznese. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e kredisë do të ishte rreth 8%.

Ristrukturimet e kredive dhe largimet nga bilanci të kredive të humbura kanë vijuar. Vëllimet e

Teprica e kredisë bankare është rritur gjatë periudhës dhe në terma vjetorë. Në fund të periudhës stoku i kredisë arriti në 740 miliardë lekë nga të cilat 400 miliardë lekë janë kredi të dhëna në monedhën vendase. Në terma relativë, kredia u rrit me 4% në krahasim me gjashtë muaj më parë dhe me 3% ndaj një viti më parë. Në zgjerimin e tepricës së kredisë gjatë periudhës ka ndikuar rritja e ndjeshme në kredinë për prona të paluajtshme, për sektorin e individëve, ashtu edhe për atë të bizneseve. Nga ana tjetër, kredia afatshkurtër ka ardhur në rënie, ndërsa ajo afatmesme qëndroi e pandryshuar.


Rritja e tepricës së kredisë në krahasim me një vit më parë, është mbështetur nga ecuria e portofolit të kredisë në lekë, kredisë për individët, dhe kredisë afatgjatë. Kredia për individë është zgjeruar me ritme veçanërisht të shpejta gjatë periudhës dhe ndryshimi vjetor në fund të vitit arriti në 9%. Kredia në lekë u zgjerua me 14%, ndërsa ajo në valutë e shprehur në lekë u tkurr me 7%. Duke korrigjuar efektin statistikor të

ristrukturimeve u rritën, ndërsa ato të fshirjeve treguan rënie.

kursit të këmbimit, i cili ishte negativ për rreth 32 miliardë lekë, ndryshimi vjetor i kredisë në valutë do të rezultonte pozitiv për rreth 2%, ndërsa rritja e tepicës së kredisë do të ishte rreth 8%.


Vëllimi i kredive të ristrukturuara ishte disi më i lartë ndaj gjashtëmuajorit të kaluar, ndërsa largimet nga bilanci të humbura janë pakësuar. Kredia e ristrukturuar gjatë gjashtë muajve të fundit të vitit ishte rreth 3 miliardë lekë ose sa 2% e fluksit të kredisë së re të periudhës dhe sa 8% e stokut të kredive me probleme. Portofolet e prekura nga ristrukturimi i kredisë lidhen me kreditë në lekë dhe valutë për sektorin e biznesit. Forma kryesore e ristrukturimit e kërkuar nga klientët dhe e miratuar nga bankat ishte zgjatja e afatit të maturimit. Fluksi vjetor i kredisë së ristrukturuar është zvogëluar gjatë dy viteve të fundit. Kështu, vlera e kredisë së ristrukturuar gjatë vitit 2023 është sa 43% e vlerës së kredisë së ristrukturuar në vitin 2021. Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilanci të bankave ka vijuar edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023 dhe vlera e kredive të humbura të fshira nga bilanci ishte rreth 1 miliardë lekë. Gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit janë fshirë rreth 2 miliardë lekë kredi të humbura dhe më shumë se gjysma e këtij vëllimi lidhet me kredi të marra nga individët. Vlera e kredive të fshira në periudhën e fundit ishte sa 4% e tepicës së përgjithshme të kredive me probleme në portofolin e bankave në fund të vitit 2023, ndërkohë që për gjashtëmuajorin e kaluar ky raport ishte 2%.

Grafik 62. Rritja vjetore e kredisë sipas valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 63. Ndryshimi në tepicën e kredisë sipas elementeve përbërëse



Kredia për subjektet jorezidente

Kredia për jorezidentët ra lehtë gjatë periudhës dhe pesha e saj ndaj kredisë së përgjithshme të sektorit bankar mbetet e ulët. Në fund të vitit 2023, kredia për jorezidentët ishte rreth 30 miliardë lekë ose sa 4% e tepicës së kredisë së sektorit bankar. Stoku i kredisë për subjektet jorezidente ra me rreth 3% ndaj gjashtë muajve më parë dhe rezultoi i pandryshuar ndaj një viti më parë.

Kredia e pambrojtur në valutë

Tepica e kredisë së pambrojtur në valutë ka shënuar rënie si në terma gjashtëmuajorë, ashtu edhe në krahasim me një vit më parë. Kjo rënie vërehet në vlerë absolute dhe

Kredia e pambrojtur në valutë ka vijuar të tkurret por rënia ishte më e ngadaltë në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit. Gjatë periudhës, stoku i kredisë së pambrojtur në valutë u pakësua me 4 miliardë lekë ose me 5%, ndërsa rënia në terma vjetorë ishte 16%. Treguesi i korrigjuar për efektin e kursit paraqet një rënie prej 2.5% gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023. Stoku i kredisë së pambrojtur në valutë është zvogëluar disi më shpejt krahasuar me stokun e kredisë në valutë, ndërkohë që niveli i kredisë së përgjithshme

relative, madje konstatohet edhe kur ky portofol shprehet në monedhë origjinale.

Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rënia në kredinë e pambrojtur në valutë për individët. Kredia e pambrojtur në valutë për bizneset është tkurrur lehtë.

është rritur. Si rrjedhojë, pesha e kredisë së pambrojtur ndaj këtyre tepricave ka ardhur në rënie, duke arritur në nivelet 26% dhe 12%, nga 32% dhe 16% gjashtë muaj më parë. Rënia absolute dhe relative e kredisë së pambrojtur në valutë tregon një rënie të ekspozimit të sektorit bankar ndaj efektit të tërthortë të kursit të këmbimit, dhe përfaqëson një zhvillim pozitiv si në drejtim të mbrojtjes së huamarrësve, ashtu edhe në drejtim të qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

Rënia në tepricën e kredisë së pambrojtur ka qenë më e fortë në portofolin e kredisë për individët, e cila u tkurr me 7% gjatë periudhës dhe me 4% në terma vjetorë. Pjesa kryesore e tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë përbëhet nga kredia në euro (mbi 90%) dhe stoku i këtij portofoli ka shënuar rënie gjatë periudhës. Gjysma e stokut të kredisë së pambrojtur zihet nga kredia për bizneset, e cila gjatë periudhës ra lehtë. Sipas sektorëve, peshën kryesore në këtë kredi e zë "pasuria e paluajtshme" me rreth 60%, e ndjekur nga "tregtia" me 16%.

Kredia e pambrojtur për individët e akorduar për blerje pasurish të paluajtshme vazhdon të përbëjë rreth 60% të tepricës së kredisë së pambrojtur të dhënë për blerje dhe zhvillim të pasurive të paluajtshme. Teprica e përgjithshme e kredisë së dhënë për këtë qëllim u tkurr me rreth 12% gjatë periudhës dhe rënia ka qenë e njëtrajtshme për sektorin e individëve dhe atë të bizneseve. Raporti i kredive me probleme për kreditë e pambrojtura nga kursi i këmbimit ishte 4.4% në fund të vitit. I njëjti raport vetëm për kreditë për pasuri të paluajtshme shënonte 3.5%.

Kredia e re

Kredia e re e dhënë gjatë periudhës ishte dukshëm më e lartë se ajo e një viti më parë. Ajo reflekton një performancë më të mirë të kredisë në lekë, ndërsa fluksi i kredisë në euro ka rënë nga viti i kaluar.

Kredia e re për individët u rrit në terma vjetorë, por ishte e krahasueshme me atë të gjashtëmujorit të parë. Ajo ka shkuar kryesisht për blerjen e pasurive të paluajtshme.

Në tërësi, gjatë periudhës bankat kanë qenë të kujdesshme në dhënie e kredisë së re, pasi normat e refuzimit të tyre për aplikantët, bizneset dhe

Kredia e re e akorduar nga bankat gjatë gjysmës së dytë të vitit, ishte rreth 180 miliardë lekë ose 26% më shumë se një vit më parë. Në krahasim me kredinë e re të dhënë gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, rritja ishte e krahasueshme. Sipas monedhës, rritja në fluksin e kredisë së re lidhet tërësisht me kreditë e reja në lekë ndërkohë që fluksi i kredisë së re në euro, i shprehur në lekë, shfaqet në rënie kundrejt vitit të kaluar dhe i njëjtë me fluksin e gjysmës së parë të vitit. Fluksi i kredisë së re për sektorin e bizneseve për gjashtëmujorin rezultoi 130 miliardë lekë, nga 90 miliardë dhe 100 miliardë lekë të raportuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 dhe gjysmës së dytë të vitit 2022. Rreth gjysma e kredisë së marrë nga sektori i bizneseve ka formën e kredisë – kufi ndërkohë që pjesa tjetër e kredisë së re është ndarë në blerje pajisjesh, kapital qarkullues dhe blerje pasurish të paluajtshme. Vlera dhe pesha e kësaj të fundit ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë periudhës, edhe si pasojë e disa riklasifikimeve midis kredive për blerje pajisjesh dhe kredive për pasuri të paluajtshme në portofolin e disa bankave.


Fluksi i kredisë së re për individë nuk ka shfaqur ndryshime të rëndësishme për periudhën, por u rrit me 12% në terma vjetorë. Rritja vjetore ka ardhur si pasojë e rritjes së fluksit të kredisë së re të marrë nga individët për blerje pasurish të paluajtshme. Në terma mesatarë, kjo lloj

individët, kanë mbetur përgjithësisht të qëndrueshme.

Norma e peshuar e interesit për të gjitha kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës mbeti pothuajse e pandryshuar, në 6.3%. Normat e interesit për kreditë e reja në lek kanë rënë, dhe niveli i tyre është më i ulët se norma e interesit për kreditë e reja në euro.


kredie përfaqëson rreth 52% të fluksit të përgjithshëm të kredisë së re për individët.

Grafik 64. Ecuria e normave të interesit të kredisë së re



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 65. Kredia e re për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma e peshuar e interesit për të gjitha kreditë e reja të akorduara gjatë periudhës mbeti pothuajse e pandryshuar, në 6.3%. Norma për kreditë në monedhën vendase dhe në euro kanë ecur në drejtim të kundërta. Kështu, norma e ponderuar e interesit për kreditë e reja në monedhën euro u rrit në 6.1% në fund të periudhës nga 5.7% gjashtë muaj më parë. Norma e interesit të kredive të reja në euro paraqet një prirje të qartë në rritje që nga fillimi i vitit 2022, ndërkohë që norma e interesit të kredive të reja në lek ra në 6.3% dhe tregon një prirje rënëse që nga vlera 7.5% e regjistruar në muajin tetor të vitit 2022.

Hapësirë informuese 2. Ecuria e numrit të aplikimeve për kredi dhe analiza e normës së refuzimit nga bankat në vend, për gjashtëmuajorin e dytë 2023

Gjatë gjashtëmuajorit të dytë 2023 (periudha 1 korrik - 31 dhjetor 2023), bankat raportojnë se kanë marrë në shqyrtim gjithsej 67,352 aplikime për kredi, nga të cilat 9% i përkasin "ndërmarrjeve" (5% ose 3,171 aplikime nga 'ndërmarrjet e vogla dhe të mesme' dhe 4% ose 2,567 aplikime nga "ndërmarrje të tjera") dhe 91% (ose 61,614 aplikime) i përkasin sektorit të "individëve". Kjo shpërndarje është zhvendosur disi në favor të ndërmarrjeve, krahasuar me periudhën e kaluar dhe me një vit më parë.

Grafik 66. Ecuria e numrit të aplikimeve të marra në shqyrtim dhe norma e refuzimit të kredive




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Numri total i aplikimeve për kredi të shqyrtuara nga bankat ka shënuar rritje me 3.6% krahasuar me gjatshëmujorin e kaluar. Rritja është vënë re në të tre segmentet e klientelës, por ishte më e theksuar tek “ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” (rritje me 6.2%). Krahasuar me një vit më parë, numri i përgjithshëm i aplikimeve gjithashtu ka rezultuar në rritje me 4.7%, e ardhur nga kategoria e “ndërmarrjeve të tjera” (rritje me 19.5%) dhe individët (rritje me 4.5%).

Në totalin e aplikimeve të marra në shqyrtim gjatë periudhës, rezulton se rreth 21% e tyre janë refuzuar nga bankat. Kjo normë ishte 1.7 pikë përqindje më e ulët se gjatshëm muaj më parë, shumë pak më e lartë (me 0.6 p.p.) se një vit më parë. Rënia e refuzimeve të bankave në gjysmën e dytë të vitit 2023 është shtrirë në të tre kategoritë e klientëve, por ishte më e theksuar në segmentin e “ndërmarrjeve të tjera”, ku përfshihen kryesisht ndërmarrjet e mëdha.

Norma e refuzimit ka qenë në rënie për bankat me kapital vendas dhe të huaj, veçanërisht në drejtim të segmentit të ndërmarrjeve të mëdha. Vihet re se gjatë periudhës, të dy grupet bankare kanë shfaqur prirje lehtësuese ndaj kërkesave për kredi të ndërmarrjeve të mëdha, duke refuzuar vetëm 4% të aplikimeve të tyre në rastin e bankave të huaja, dhe 3% në rastin e bankave me kapital vendas. Në rastin e “ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, të dy grupet e bankave kanë qenë gjithashtu më pranuese, duke refuzuar vetëm 6% të kërkesave të tyre për kredi. Përsa i përket segmentit të “individëve”, të dy grupet kanë vijuar të kenë qëndrime të kundërta, por me prirje lehtësuese në rastin e bankave të huaja. Kështu, bankat vendase kanë refuzuar vetëm 6% të aplikimeve të individëve, duke mbetur në të njëjtin nivel me periudhën e kaluar, ndërsa bankat e huaja kanë refuzuar rreth 28% të aplikimeve, duke shënuar një rënie me 2 pikë përqindjeje krahasuar me gjysmën e parë të vitit.

Grafik 67. Norma e refuzimit të kredive- banka vendase dhe të huaja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, nga analiza e mësipërme mund të arrihet në përfundimin se ecuria e aplikimeve të shqyrtuara nga bankat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, tregon për një rritje me bazë të gjerë të kërkesës për kredi, si nga sektori i individëve ashtu edhe nga ai i ndërmarrjeve krahasuar me gjysmën e parë të tij, si dhe një qëndrim disi më lehtësues të kredidhënies nga ana e bankave.

3.1.1.5 Depozitat

Depozitat u zgjeruan gjatë periudhës dhe në terma vjetorë, duke ruajtur strukturën e tyre. Rritja lidhet me zgjerimin e llogarive rrjedhëse të individëve dhe të bizneseve, dhe të depozitave me afat të individëve. Kjo rritje është e shpërndarë në mënyrë të balancuar midis depozitave në lek dhe valutë.


Rritja e regjistruar gjatë periudhës dhe në terma vjetore ishte rreth 6-7% dhe në fund të vitit depozitat arritën në 1,600 miliardë lekë. Në terma vjetore, depozitat në lekë u zgjeruan me 7%, ndërsa ato në valutë me 5%. E korrigjuar për efektin e kursit të këmbimit, rritja vjetore e depozitave në valutë rezulton rreth 14%.

Normat e interesit të depozitave të reja kanë vijuar të rriten, ndërsa flukset e depozitave të reja në valutë gjatë periudhës, janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me periudhat e mëparshme.

Depozitat u zgjeruan gjatë periudhës dhe në terma vjetorë, duke ruajtur strukturën e tyre. Rritja lidhet me zgjerimin e llogarive rrjedhëse të individëve dhe të bizneseve, dhe të depozitave me afat të individëve. Kjo rritje është e shpërndarë në mënyrë të krahasueshme midis depozitave në lek dhe valutë. Struktura e depozitave sipas afatit, sektorëve dhe valutës ka mbetur përgjithësisht e pandryshuar, por gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e lehtë e peshës së llogarive rrjedhëse dhe depozitave të bizneseve. Vëllimi i depozitave sipas afatit është i shpërndarë në mënyrë pothuajse të barabartë midis llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat që zënë përkatësisht 44% dhe 43% të totalit, ndërsa depozitat e individëve dhe depozitat në valutë zënë përkatësisht 78% dhe 53% të stokut të përgjithshëm të depozitave.

Rritja e regjistruar gjatë periudhës dhe në terma vjetore ishte rreth 6-7% dhe në fund të vitit depozitat arritën në 1,600 miliardë lekë. Depozitat në lekë u zgjeruan me 6%, ndërsa ndryshimi vjetor i këtij treguesi ishte 7%. Për depozitat në valutë, këto ndryshime ishin përkatësisht 7% dhe 5%. Në vlerë absolute, ndryshimi i depozitave në lekë dhe në valutë gjatë periudhës ishte përkatësisht 44 dhe 56 miliardë lekë, ndërsa në krahasim me një vit më parë ato u zgjeruan me 50 dhe me 40 miliardë lekë. Të shprehura në monedhën origjinale, ose të korrigjuara për efektin statistikor të kursit të këmbimit³⁷ depozitat në valutë u shtuan me rreth 10% gjatë periudhës dhe me 14.4% kundrejt një viti më parë.

Grafik 68. Rritja e depozitave sipas valutës (kontribut, p.p.)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

³⁷ Efekti statistikor i ndryshimit të kursit të këmbimit në kundërvlerën në lekë të depozitave në valutë llogaritet në -21 miliardë lekë për gjashtëmuajorin e dytë të vitit dhe me -80 miliardë lekë për 12 muajt e fundit deri në dhjetor 2023.


Depozitat me afat u zgjeruan me rreth 8% në terma vjetorë dhe kanë vijuar të japin një kontribut të rëndësishëm në rritjen e depozitave të përgjithshme. Stoku i depozitave pa afat qëndroi thuajse i pandryshuar gjatë periudhës dhe ra me 6% ndaj një viti më parë. Pakësimi i depozitave pa afat lidhet me tkurrjen e depozitave pa afat të individëve në monedhën vendase. Gjatë një periudhe të karakterizuar nga një rritje relativisht e shpejtë e normave të interesit, rritja e moderuar e depozitave me afat e shoqëruar me ngadalësim të ritmit të rritjes së llogarive rrjedhëse dhe tkurrje të depozitave pa afat, sugjerojnë një rritje të preferencës së depozituesve për depozitat me afat që ka filluar gjatë pjesës së parë të vitit 2022 dhe ka vijuar edhe gjatë vitit 2023.

Grafik 69. Rritja vjetore e depozitave sipas afatit dhe monedhës, në monedhë origjinale




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 70. Rritja vjetore e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontribut, p.p.)




Rritja e depozitave në lekë me 7%, pasqyron zgjerimin e llogarive rrjedhëse të bizneseve dhe individëve dhe zgjerimin e depozitave me afat të individëve. Në fund të vitit 2023, llogaritë rrjedhëse të bizneseve dhe të individëve në monedhën Lek shënonin përkatësisht 90 dhe 205 miliardë lekë, duke qenë 18% dhe 8% mbi nivelin e një viti më parë. Depozitat pa afat në lekë u tkurrën shumë lehtë gjatë periudhës, ndërsa depozitat me afat u rritën me 4% gjatë periudhës dhe me 5% në terma vjetorë. Pothuajse i gjithë stoku prej 350 miliardë lekësh i depozitave me afat në lekë përfaqësohet nga depozitat e individëve, të cilat në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë u zgjeruan me përkatësisht 1% dhe 3%.

Grafik 71. Ecuria e depozitave në lek sipas afatit dhe sektorit (kontribut, p.p.)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 72. Ecuria e depozitave në valutë sipas afatit dhe sektorit (kontribut, p.p.)




Rritja mesatare vjetore e depozitave në euro prej gati 15%, lidhet me zgjerimin e konsiderueshëm të depozitave me afat të individëve dhe të bizneseve. Depozitat me afat të bizneseve dhe individëve në euro në fund të periudhës ishin përkatësisht 16% dhe 25% më të larta në krahasim me nivelin e një viti më

parë, ndërsa ndryshimi vjetor në depozitat e përgjithshme në euro të secilit sektor ishte 22% dhe 15%. Rritja e depozitave në euro gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023 ishte dukshëm më e lartë në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, dhe pothuajse e njëjtë me atë të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2022.

Gjatë periudhës, depozitat në euro të bizneseve dhe të individëve u shtuan me përkatësisht 210 dhe 620 milionë euro, ndërkohë që gjatë së njëjtës periudhë një vit më parë, shtesat përkatëse ishin 170 dhe 450 milionë euro. Në linjë me ecurinë sezonale të depozitave, gjysma e dytë e viteve të fundit tregon vlera më të larta në krahasim me pjesën e parë, veçanërisht për depozitat e individëve. Kjo ecuri e depozitave në monedhën Euro, dhe veçanërisht vlera e lartë e depozitave të reja në valutë të raportuara gjatë muajit gusht, pasqyron ndikimin e ardhur nga rritja e fortë e flukseve hyrëse valutore në formën e remitancave dhe veçanërisht në formën e të ardhurave nga eksportet e shërbimeve të udhëtimit.


Periudha u karakterizua nga rritja e mëtejshme e normave të interesit të depozitave për të dy sektorët dhe për të tri monedhat kryesore dhe rritje e flukseve të depozitave të reja veçanërisht për euron. Në fund të periudhës normat e peshuara të interesit për depozitat e reja të bizneseve dhe individëve në lek ishin përkatësisht 2.6% dhe 1.6% ndërsa normat për depozitat e reja me afat në monedhën euro, për bizneset dhe individët, arritën në 1.7% dhe 1%. Rritja në normat e interesit për depozitat e reja me afat ka ndikuar në rritjen e normave të interesit për stokun e depozitave me afat nën dhe mbi 2 vjet. Për depozitat e individëve me afat mbi dy vjet në lek, kjo normë është rritur përgjatë vitit duke arritur 2.7% në fund të periudhës, dhe për depozitat e individëve me afat mbi dy vjet në euro norma e peshuar e interesit arriti në 1.6%, nga 1.3% në fund të muajit qershor. Flukset mesatare mujore të depozitave të reja të individëve gjatë periudhës ishin përkatësisht 23 miliardë lekë (për depozitat në lekë) dhe 270 milionë euro (për depozitat e reja në euro), nga 18 miliardë dhe 180 milionë gjatë gjysmës së parë të vitit. Nga ana tjetër, flukset e reja në monedhën lek dhe euro janë të krahasueshme me vlerën mesatare mujore të depozitave të reja gjatë së njëjtës periudhë një vit më parë.

Grafik 73. Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në lekë për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 74. Depozitat e reja dhe normat e interesit për stokun dhe depozitat e reja në euro për individët



3.1.2 Rreziqet e veprimtarisë së sektorit bankar

3.1.2.1 Rreziku i kredisë

Stoku i kredive me probleme vijoi të zvogëlohej gjatë periudhës. Kjo rënie, e shoqëruar me rritjen e përgjithshme të stokut të

Cilësia e kredisë ka shënuar përmirësim të lehtë gjatë periudhës.

Në këtë ecuri ka ndikuar tkurrja e stokut të kredisë në klasat e kredive "të dyshimta" dhe "nënstandard", si pasojë e shlyerjes së kredive me probleme, riklasifikimit të kredive me probleme në klasa performuese si

kredisë, rezultoi në rënien e raportit të kredive me probleme me 0.5 pikë përqindje, në nivelin 4.7%.

Ky përmirësim është vënë re në të gjitha portofolet e kredisë por ka qenë më i dukshëm në portofolin e kredisë në monedhë të huaj, në kredinë afatgjatë dhe në kredinë për bizneset. Për kredinë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet e kursit të këmbimit, cilësia e kredisë ka rënë lehtë në krahasim me një vit më parë.

Rënia e kredive me probleme lidhet me riklasifikimin e kredive me probleme në klasa më të mira, fshirjen e kredive të humbura, si dhe shlyerjen e një pjese të kredive me probleme.

Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme u rrit deri në nivelin 71%, ndërsa mbulimi me kolateral i tepricës së kredisë ka rënë lehtë.


dhe fshirjet e kredive të humbura nga bilancet e bankave. Raporti i kredive me probleme (RKP) ra me 0.5 p.p., në nivelin 4.7% në fund të periudhës. Stoku i kredive me probleme u zvogëlua me rreth 2 miliardë lekë dhe në fund të dhjetorit shënonte rreth 35 miliardë lekë, ose nivelin më të ulët të regjistruar gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Në krahasim me një vit më parë, stoku i kredive me probleme ka rënë me rreth 1 miliardë lekë, dhe RKP-ja ka rënë me rreth 0.3 p.p.

Bankat kanë raportuar përmirësim të cilësisë së kredisë kryesisht për kredinë me maturitet afatgjatë, kredinë për bizneset dhe kredinë në valutë. Gjatë periudhës janar 2015 – dhjetor 2023, bankat kanë fshirë nga bilancet e tyre rreth 80 miliardë lekë kredi të humbura, ndërsa vlera e kredive të fshira gjatë 12 muajve të fundit ishte rreth 2 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e kredive të fshira ishin kredi në monedhën vendase të mbajtura nga sektori i biznesit. Brenda portofolit të kredive me probleme, bankat kanë raportuar rritje të tepricës për klasën e kredive të humbura, që tashme zë 56% të kredive me probleme. Ndërsa stoku i kredive të dyshimta ka rënë në 16% te tepricës së kredive me probleme, nga 23% një vit më parë.

Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta, por gjatë periudhës ra me 4 pikë përqindjeje, në 75%. Kolaterali përfaqëson një element kritik midis instrumenteve mbrojtëse të sektorit bankar nga rreziku i moskthimit të huave. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë peshën kryesore ose rreth 60% të kredisë së kolateralizuar dhe 44% të tepricës së kredisë. Stoku i kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme është zvogëluar me 5% në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që portofolet e kredive të kolateralizuara me kolateral tjetër kanë shënuar rritje.


Provigjionet për rrezikun e kredisë janë rritur për shkak të rritjes së peshës së kredive ‘të humbura’ në totalin e kredive me probleme. Duke qenë se zvogëlimi i stokut të kredive me probleme ishte më i ngadaltë në krahasim me shtimin e fondit të provigjioneve gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, raporti i mbulimit të kredive me probleme me provigjione u rrit në 71% nga 64% që ishte niveli i regjistruar një vit më parë.

Grafik 75. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione dhe kolateral




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 76. Kontributi në ndryshimin tremujor të stokut të kredive me probleme




Cilësia e kredisë ka shënuar përmirësim për të gjitha kategoritë sipas qëllimit të përdorimit dhe përmirësimin më të madh e ka shënuar portofoli i kredisë për zhvillim biznesi. Raporti i kredisë me probleme i kësaj kategorie ra në nivelin 6%, nga 7% në qershor 2023. Portofolet e kredisë me vlerën më të lartë të raportit të kredisë me probleme janë kredia afatmesme, ajo për biznese si dhe kredia në lek, ndërkohë që raportin më të ulët e ka kredia për investime në pasuri të paluajtshme. Në fund të dhjetorit 2023, raportet e kredisë me probleme për këto lloj kredisë ishin përkatësisht 7%, 6% dhe 5% dhe 4.4%.

Grafik 77. RKP-ja për kredisë sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 78. Treguesit e vlerësimit të rrezikut të kredisë



Treguesi i normës së prurjeve të kredisë me probleme³⁸ dhe ai i kredisë me probleme të rikuperuara³⁹ sugjerojnë se gjatë vitit 2023, sektori bankar ka regjistruar më pak kredi të reja me probleme. Për vitin 2023, fluksi i kredisë të reja me probleme ishte sa 1.9% e kredisë të rregullta, nga 2.2% dhe 2.1% një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Norma e rikuperimit të kredisë me probleme shënoi rritje në 13% nga 12% një vit më parë. Kjo ecuri tregon rritje të aftësisë së bankave për të rikuperuar kreditë me probleme. Nga ana tjetër, norma e dështimit⁴⁰ që tregon shpejtësinë me të cilën akumulohen kreditë e humbura në krahasim me portofolin e përgjithshëm të kredisë, u rrit lehtë në 1.4% nga 1.2% dhe 1% një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Rritja e normës së dështimit gjatë 12 muajve të fundit sinjalizon një rrezik të shtuar të aktivitetit kreditues.

Cilësia e kredisë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit mbeti e pandryshuar në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të kaluar, ka rënë lehtë në krahasim me një vit më parë. Raporti i kredisë me probleme (RKP) për këtë portofol të kredisë shënoi 4.4% në fund të dhjetorit 2023 nga 4.2% një vit më parë. Në këtë ecuri ka ndikuar zgjerimi në stokun e kredisë me probleme të kredisë për zhvillim biznesi dhe kredisë për tregti. Peshën kryesore⁴¹ në tepricën e kredisë me probleme të pambrojtur nga luhatjet e kursit të këmbimit vijon ta mbajë kredia për investime në pasuri të paluajtshme, por RKP-ja për këtë kategori kredisë ra në rreth 3.5%, nga 6.2% një vit më parë.

³⁸ Fluksi i ri i kredisë me probleme gjatë periudhës ndaj tepricës së kredisë të rregullta në fund të periudhës.

³⁹ Fluksi i ri i kredisë me probleme që kanë kaluar në klasat performuese gjatë një viti ndaj tepricës së kredisë me probleme në fund të periudhës.

⁴⁰ Fluksi i ri i kredisë të humbura gjatë një viti ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë (me përjashtim të kredisë të humbura) në fund të periudhës.

⁴¹ Rreth 47% të totalit.

3.1.2.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit të sektorit bankar mbetet i ulët dhe treguesit e likuiditetit vijnë të qëndrojnë dukshëm mbi kufijtë rregullativë.

Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, bankat kanë një vëllim disi më të lartë aktiveve likuide në raport me aktivet e përgjithshme dhe detyrimet afatshkurtra.

Hendeku negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj është ngushtuar lehtë, ndërsa hendeku i përgjithshëm mbetet pozitiv, në vlera të afërta me periudhat e kaluara. Diferenca midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve ka rënë si pasojë e rënies në maturitetin mesatar të aktiveve dhe rritjes së maturitetit mesatar të pasiveve.

Rreziku i likuiditetit në aktivitetin e sektorit bankar mbetet i ulët.

Treguesit kryesorë të likuiditetit për monedhën vendase dhe të huaj vijnë të jenë dukshëm mbi kufijtë minimalë të përcaktuar nga aktet rregullative. Aktivitetet likuide janë zgjeruar me ritme disi më të shpejta në krahasim me detyrimet afatshkurtra, dhe treguesi kryesor i rrezikut të likuiditetit është përmirësuar lehtë në krahasim me nivelet e fundit të dy gjashtëmujorëve të kaluar. Megjithatë, përqendrimi i aktiveve likuide tek titujt e borxhit të qeverisë shqiptare, mbetet i lartë dhe evidenton rëndësinë e zhvillimit të tregut për tregtimin e tyre.

Gjatë periudhës, bankat kanë raportuar ngushtim të hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet deri në 3 muaj.

Në tërësi, hendeku i përgjithshëm midis aktiveve dhe pasiveve ka mbetur pothuajse i pandryshuar, në vlerën pozitive prej rreth 5% të aktiveve të përgjithshme të sektorit bankar. Diferenca midis maturitetit mesatar të mbetur të huave dhe depozitave u zgjerua lehtë, kryesisht nga rritja e maturitetit mesatar të mbetur të huave.


Burimi kryesor i financimit të aktivitetit kreditues të bankave mbeten depozitat, që mbulojnë rreth dy herë vëllimin e kredive të sektorit.

Gjatë periudhës, rritja e depozitave të përgjithshme është paraqitur disi më e shpejtë se ecuria e kredisë. Në fund të periudhës, raporti "hua/depozita" ishte 46%. Ky tregues është më i ulët se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ndjeshëm më i ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian. Për shkak të shpejtësive të ndryshme në zgjerimin e kredisë dhe depozitave në monedhat përkatëse, raporti "hua/depozita" ka shfaqur ecuri të ndryshme për monedhën vendase dhe për monedhat e huaja. Gjatë periudhës, për lekun ky raport u rrit lehtë në 53% (nga 52%) dhe për valutën ai ra në 40% (nga 43%).

Në fund të vitit, aktivet likuide ishin rreth 600 miliardë lekë, ose rreth 31% e totalit të aktiveve të sektorit bankar. Në krahasim me një vit më parë, ky raport është rritur lehtë. Kjo ecuri lidhet me faktin që aktivet likuide janë rritur më shpejt sesa aktivet e përgjithshme në terma gjashtëmujorë dhe në terma vjetorë. Treguesi i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, që është subjekt i kufizimeve sipas rregullores përkatëse për administrimin e rrezikut të likuiditetit⁴², u rrit në nivelin 43%, nga 42% dhe 41% gjashtë muaj dhe një vit më parë. Përmirësimi më i fortë është regjistruar në raportin e likuiditetit për monedhën euro, i cili u rrit në 26% nga 22% një vit më parë. Kjo rritje erdhi si pasojë e rritjes vjetore me 20% në stokun e aktiveve likuide, kundrejt rritjes shumë të lehtë (+2%) të detyrimeve afatshkurtra.


⁴² Bankat duhet të mbajnë mjete likuide për mbulimin e 15% të detyrimeve afatshkurtra për lekun, 20% për valutën, dhe me një kërkesë totale prej 20%.

Grafik 79. Diferenca në maturimin mesatar të mbetur midis aktive-pasive dhe kredi-depozita



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 80. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve⁴³



Gjatë periudhës, në bilancet e bankave është regjistruar zgjerim i aktiveve me afat kontraktual të mbetur deri në tre muaj, ndërkohë që detyrimet e tyre për të njëjtën shportë thuajse nuk kanë ndryshuar. Kjo ecuri bëri që hendeku negativ midis aktiveve dhe detyrimeve për këtë shportë⁴⁴ të ngushtohej në 17% të aktiveve të përgjithshme nga 26% në qershor 2023. Ky vijon të jetë hendeku më i madh negativ për të gjithë horizontin e maturiteteve. Hendeku për maturitetin 3 muaj deri në 1 vit është rikthyer gjithashtu në vlera negative (-5%), pas vlerës së ulët pozitive gjashtëmujorin e kaluar. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, në raport me aktivet e përgjithshme madhësia e hendekut të përgjithshëm midis aktiveve dhe detyrimeve vijon të mbetet e kufizuar dhe pozitive, pranë një vlere mesatare prej 5%, pa ndryshime të dukshme ndaj periudhave të mëparshme.

Diferenca midis maturimit mesatar të aktiveve dhe detyrimeve të bankave ka rënë në 21.3 muaj (nga 23.3 muaj), pasi maturitetet e mbetura mesatare kanë ecur në kahe të kundërta; ai i aktiveve është zvogëluar ndërsa maturiteti i pasiveve është rritur. Nga ana tjetër, diferenca midis maturitetit mesatar të mbetur të huave dhe depozitave u zgjerua lehtë, në 45.3 muaj (nga 44.4 muaj), kryesisht si rrjedhojë e rritjes së maturitetit mesatar të mbetur të huave, në 54.2 muaj (nga 52.7 muaj). Ecuria e këtyre treguesve sugjeron që diferenca në maturitetin mesatar të mbetur midis aktiveve të tjera si veprimet me thesarin dhe ndërbankare dhe veprimet në letrat me vlerë dhe pasiveve të tjera të ndryshme nga depozitat, ka rënë lehtë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Prej disa gjashtëmujorësh sektori bankar nuk ka raportuar linja financimi nga grupet zotëruese.

3.1.2.3 Rreziqet e tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

Pavarësisht rritjes së lehtë në treguesin e pozicionit të hapur valutor të bankave, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit

Treguesi i pozicionit të hapur valutor të bankave është rritur lehtë gjatë periudhës, por paraqitet në nivele të ulëta në krahasim me kufirin rregullativ. Pozicioni i hapur i bankave u raportua 'në blerje', duke qenë sa 6.1% e kapitalit rregullator, dhe kjo vlerë ishte përkatësisht 0.6 pikë përqindjeje dhe 1.1 pikë përqindjeje mbi nivelin e regjistruar gjashtë muaj dhe një vit më parë. Pavarësisht rritjes treguesi qëndron ndjeshëm nën vlerën kufi prej 30% të kërkuar nga kuadri rregullativ. Ky pozicion është luhatur midis vlerave 6-9%

⁴³ Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.


⁴⁴ I llogaritur si raporti i "diferencave midis aktiveve dhe pasiveve" ndaj "totalit të aktiveve" për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.

të këmbimit mbetet i kufizuar.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i cili merr në konsideratë dhe kredinë e rezidentëve në valutë, ka ardhur në rënie.


gjatë gjysmës së dytë të vitit, nga një mesatare prej 6% e regjistruar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023. Ecuria e treguesit të përgjithshëm është përcaktuar nga ecuria e treguesit për bankat me rëndësi sistemike, për të cilat pozicioni i hapur neto valutor "në blerje" ishte sa 8.8% e vlerës së kapitalit rregullator të tyre. Bankat josistemike paraqesin pozicion të hapur neto valutor 'në blerje' sa 0.9% e kapitalit rregullator të tyre dhe në përgjithësi, paraqesin një ekspozim të ulët dhe të qëndrueshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Pozicioni i hapur neto i bankave josistemike gjashtë muaj dhe një vit më parë ishte 'në shitje' dhe sa përkatësisht 0.7 dhe 0.9% të kapitalit rregullator të tyre.

Grafik 81. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin bankar dhe grupet




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 82. Ecuria e përbërësve të indeksit për sektorin bankar



Grafik 83. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare



Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i matur me treguesin e mospërputhjes valutore shënoi rënie gjatë periudhës. Ky tregues në fund të gjysmës së dytë të vitit ishte sa 14.4% e aktiveve të sektorit bankar ose 1.1 pikë përqindjeje më i ulët në krahasim me gjashtëmuajorin e kaluar. Kontributin kryesor në këtë rënie e ka dhënë ulja me rreth 1.2% e kredisë për rezidentët në valutë, ndërkohë që pasivet dhe aktivet në valutë janë rritur me ritme të ngjashme duke u zgjeruar me rreth 5% gjatë periudhës. Treguesi për bankat sistemike reflekton një ekspozim më të ulët në krahasim me sektorin bankar në tërësi. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, ky tregues ra me 1.0 pikë përqindje, duke arritur në 11.4% të aktiveve të grupit. Një vit më parë, ky tregues ishte sa 13.4% e aktiveve të bankave sistemike. Indeksi i mospërputhjes valutore për bankat josistemike ka vlerë më të lartë dhe tregon një ekspozim më të madh të këtyre bankave ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Në fund të gjashtëmuajorit të dytë të vitit, treguesi ra në 20.1% të aktiveve të grupit, nga 21% dhe 23% gjashtë muaj dhe një vit më parë.

Rreziku i normës së interesit

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit ka shënuar rënie gjatë periudhës, duke mbetur ndjeshëm nën kufirin e sipërm rregullator.

Sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së

Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të normës së interesit shënoi rënie. Pozicioni total neto i peshuar i ekspozimeve ndaj normave të interesit në librin e bankës në fund të periudhës ishte më pak se 1% e vlerës së kapitalit rregullator, ose 1.4 pikë përqindjeje dhe 2.1 pikë përqindjeje në nivelin e regjistruar gjashtë muaj dhe një vit më parë. Kufiri maksimal rregullator për këtë tregues është sa 20% e kapitalit rregullator. Ndikimin kryesor në këtë ecuri e dha diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë fikse interesi (FIR) e cila u zvogëlua me 1.6 pikë përqindjeje në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, dhe mori vlerë negative në nivelin 1.3% të kapitalit rregullator. Diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë të ndryshueshme interesi


interesi për pozicionet në lekë, ato me normë interesi të ndryshueshme dhe për maturitetin afatgjatë.

Për shkak të ekspozimeve me normë interesi të ndryshueshme, efekti i tërthortë i ndikimit të lëvizjeve në normën e interesit në cilësinë e këtyre ekspozimeve duhet monitoruar në mënyrë të vazhdueshme.

(VIR) shënoi 2.1% të kapitalit rregullator, pranë nivelit të gjashtëmujorit të kaluar duke qenë kështu 0.6 pikë përqindjeje më e ulët në krahasim me një vit më parë.


Sipas bankave, ndikimin kryesor në rënie e treguesit total neto për periudhën e dha ecuria e pozicionit të bankave sistemike, i cili u zvogëlua me 2.5 pikë përqindjeje, si pasojë e kalimit në vlera negative të nëntreguesit për pozicionin e instrumenteve me normë fikse. Në fund të periudhës, pasivet me normë fikse të interesit ishin më të larta në krahasim me aktivet me normë fikse, dhe ekspozimi përkatës ishte negativ dhe sa 2.5% e kapitalit rregullator. Gjashtë muaj dhe një vit më parë ky tregues ishte pozitiv në nivelet përkatësisht 0.2% dhe 1.9% të kapitalit rregullator. Ekspozimi ndaj luhatjes së normës për instrumentet me normë të ndryshueshme të interesit (VIR), mbeti pothuajse i pandryshuar dhe sa 2.5% e kapitalit rregullator. Për bankat josistemike, pozicioni për instrumentet me normë të ndryshueshme ka një vlerë të ulët pozitiv dhe ka ardhur në rënie, ndërkohë që pozicioni për instrumentet me normë fikse ka kaluar në vlera pozitive pas dy-tre gjashtëmujorësh me vlera negative.

Grafik 84. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 85. Pozicioni neto për normat fikse (FIR) dhe variabël (VIR) të interesit, sipas grupeve të bankave



Sipas monedhave, kontributin kryesor në ekspozimin ndaj luhatjes së normave të interesit vijon ta japë pozicioni neto në monedhën vendas, ndërkohë që zvogëlimi i pozicionit është përcaktuar nga thellimi i pozicionit negativ në Euro. Vlera e pozicionit neto në monedhën Lek në fund të periudhës ishte sa 2.9% e kapitalit rregullator ose 1.0 p.p. mbi nivelin e llogaritur në fund të dy gjashtëmujorëve paraardhës. Për monedhën evropiane, pasivet regjistruan vlera më të larta në krahasim me aktivet e ndjeshme ndaj luhatjes së normës së interesit, duke i dhënë treguesit vlerën negative në nivelin 2.2% të kapitalit rregullator.

Sipas maturiteteve, vihet re rënie e ekspozimit për instrumentet me maturitet afatshkurtër. Ky ekspozim ishte më pak se 1% e kapitalit rregullator nga rreth 3% gjashtë muaj më parë. Treguesi i pozicionit neto të peshuar për ekspozimet me maturitet afatmesëm vijon të jetë negativ; ai ishte sa 7.4% e kapitalit rregullator dhe është ngushtuar lehtë gjatë periudhës. Ekspozimi nga shporta me maturim afatgjatë, përfaqëson ekspozimin më të madh dhe mbetet pozitiv, duke qenë se vlera e aktiveve me maturitet afatgjatë është më e madhe sesa vlera e detyrimeve afatgjata të bankave. Treguesi përkatës është sa 7.6% e kapitalit rregullator dhe nuk ka shënuar ndryshime të ndjeshme në krahasim me fundet e dy gjashtëmujorëve paraardhës.

Grafik 86. Pozicioni neto i peshuar sipas monedhave (majtas) dhe afatit (djathtas) ndaj kapitalit rregullator, në %




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i rrezikut të tërthortë ndaj ndryshimit të normave të interesit⁴⁵ sinjalizon rënie të lehtë të rrezikut të shtuar në krahasim me periudhën e kaluar, dhe kjo ecuri është diktuar nga ecuria e normës së ponderuar të depozitave. Gjatë periudhës, diferenca midis normës së kredisë dhe depozitave u luhat në vlerat 4.3-5.0% dhe në fund të vitit ishte sa 4.6% ose 0.2 p.p. më pak në krahasim me nivelin e gjashtë muajve më parë. Norma e ponderuar e kredisë për individët dhe bizneset regjistroi 6.2%, pa ndryshim ndaj gjashtë muajve më parë, por 0.4 p.p. mbi vlerën e një viti më parë. Nga ana tjetër, norma e depozitave ka regjistruar rritje graduale nga niveli prej 1.5% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, në 1.7% në fund të vitit, ndërsa në muajin nëntor regjistroi vlerën më të lartë të 10 viteve të fundit prej 1.9%.


Diferenca midis normave të interesit të kredisë dhe depozitave është ngushtuar ndjeshëm për monedhën vendase për shkak të ecurisë së normave të interesit të kredisë dhe depozitave. Në fund të vitit, norma e interesit të kredisë ra në nivelin 6.3% nga 6.7% gjashtë muaj më parë, ndërsa ajo e depozitave në lekë u rrit lehtë në nivelin 2.1% duke rezultuar në ngushtimin e *spread*-it për monedhën vendase me 0.6 p.p. në vlerën 4.2%. *Spread*-i për monedhën evropiane u rrit lehtë në nivelin 4.9% si rezultat i rritjes më të lartë të normës së kredisë në krahasim me atë të depozitave, ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, *spread*-i në monedhën evropiane ishte 1.0 p.p. më i lartë.

Grafik 87. Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave dhe *spread*-i i normave të interesit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 88. Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në p.p.



⁴⁵ Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit jep tek klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ tek aftësia paguese e huamarrësve të bankës, kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i tërthortë). Megjithatë, ky efekt supozohet që kompensohet në masën më të madhe nëse në krahun tjetër, kemi një rritje të normës së interesit për depozitat.

Në kushtet kur pozicioni neto i peshuar i bankave vijon të dominohet nga pozicioni për instrumente me normë të ndryshueshme interesi, luhatshmëria e tyre mund të shoqërohet me volatilitet në cilësinë e kredisë. Lëvizja e normave të interesit shoqërohet me rritjen e luhatshmërisë së *spread*-eve dhe mund të sjellë ndryshime në pozicionin e peshuar neto të bankave për maturitete, monedha dhe lloje të caktuara instrumentesh. Për këtë arsye, në varësi të skenarëve, nevojitet rritja e vëmendjes së bankave ndaj ndikimit të këtyre faktorëve mbi aftësinë paguese të huamarrësve me kredi me norma interesi të ndryshueshme, veçanërisht për segmente ku ekspozimet janë më të mëdha ose po rriten më shpejt.

3.1.3 Rezistenca e sektorit bankar

3.1.3.1 Ushtrimi i provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës së aftësisë paguese tregojnë se sektori bankar, paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike të supozuara.


Ndjeshmëria e sektorit bankar është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, pasi numri i bankave që do të kishin nevojë për të forcuar pozicionet e tyre të kapitalit në skenarët më pak të favorshëm është më i vogël.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike dhe se ndjeshmëria e tij ndaj zhvillimeve të pafavorshme është ulur kundrejt një viti më parë. Gjithsesi, një numër i kufizuar bankash paraqet ndjeshmëri të shtuar ndaj supozimeve më ekstreme.

Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregon shkallën e qëndrueshmërisë së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë aftësinë e sektorit në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike dhe papunësinë, ecurinë e kursit të këmbimit, portofolin e kredisë, nivelin e normave të interesit dhe ecurinë e çmimeve të aktiveve jofinanciare.


Ushtrimi ndërtohet mbi tre skenarë: skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar, dhe periudha ushtrimore shtrihet deri në fund të vitit 2025. Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive gjatë këtij harku kohor, e cila shoqërohet me një rritje pozitive të kreditimit dhe rënie të papunësisë. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike mbetet në territor pozitiv gjatë periudhës ushtrimore, por norma e rritjes është më e ulët kundrejt skenarit bazë. Ndërsa, në skenarin e rënduar, supozimet janë më të pafavorshme duke u pasqyruar në një normë rritjeje minimale, thuhet afër vlerës zero. Në skenarin e moderuar dhe atë të rënduar, shtohen edhe supozimet për nënçmimin e kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritjen e normave të interesit dhe uljen e ritmit të kreditimit duke kaluar nga ndalimi i tij deri në një ritëm rritjeje negativ. Këto zhvillime reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë, si për individët ashtu edhe për bizneset, dhe ky përkeqësim paraqitet më i ndjeshëm në rastin e bankave me rëndësi sistemike.

Grafik 89. Projektionet mbi treguesit kryesorë (lart) dhe treguesit e rinj makroekonomikë (poshtë)



Tregues të tjerë makroekonomikë të përfshirë në ushtrim, në skenarët më të pavaforshtëm supozojnë një rënie të çmimeve të banesave dhe rritje të papunësisë deri në fund të periudhës.

Këto supozime ndikojnë në nivelin e kapitalizimit të bankave të veçanta dhe të sektorit bankar në tërësi, kryesisht gjatë vitit 2025.




Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës tregojnë se:

- në skenarin bazë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar vlerësohet në rreth 23% deri në fund të vitit 2025. Këto zhvillime tregojnë një qëndrueshmëri dhe nivele të mira të kapitalizimit të gjithë sektorit bankar. Numri i bankave që ka nevojë për injektim kapitali është zero.
- në skenarin e moderuar, RMK-ja për sektorin bankar ulet në nivelin e rreth 21% në fund të vitit 2025, duke vijuar të ruajë nivele të mira përgjatë gjithë harkut kohor ushtrimor. Vetëm një bankë, me aktive sa 2% e aktiveve të sektorit, ka nevojë për injektim kapitali në këtë skenar. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 100 milionë lekë ose sa rreth 0.01% e PBB-së.
- në skenarin e rënduar, sektori bankar vijon të jetë i kapitalizuar deri në fund të vitit 2025, me një RMK prej rreth 19%. Numri i bankave që ka nevojë për injektim kapitali në këtë skenar është tre në fund të periudhës dhe pesha e aktiveve të tyre në aktivet e sektorit bankar arrin në rreth 20%. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë rreth 6 miliardë lekë ose sa 0.34% e PBB-së.

Grafik 90. Vlerat e RMK-së përgjatë harkut kohor ushtrimor



Grafik 91. Kontributi në ndryshimin e RMK i zërave kryesorë të bilancit për skenarin e rënduar (fund 2025)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këtë skenar, për bankat me rëndësi sistemike norma e mjaftueshmërisë së kapitalit vlerësohet përkatësisht në rreth 18.8%, ndërsa për bankat e tjera josistemike në rreth 19%. Gjithashtu, grupi i bankave me kapital të huaj paraqet një nivel kapitalizimi prej rreth 21%, duke mbetur i mirëkapitalizuar, ndërsa grupi i bankave me kapital vendas ka një RMK më të ulët prej rreth 15%. Kontribut kryesor në rënien e kapitalizimit në skenarin e rënduar në fund të vitit 2025 e jep zëri: "Humbja nga huatë" dhe rënia e "të ardhurave të tjera".

Këto rezultate tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve makroekonomike dhe qëndrueshmëria e tij ndaj zhvillimeve të pafavorshme është më e fortë sesa një vit më parë. Numri i bankave që paraqet nevojë për shtim kapitali është vetëm tre kundrejt nëntë bankave që rezultojnë një vit më parë. Për rrjedhojë, edhe nevojat për kapital shtesë vlerësohen të jenë ndjeshëm më të ulëta deri në fund të periudhës në analizë (0.3% e PBB-së) ndaj vlerës së një viti më parë (3.4% e PBB-së).

3.1.3.2 Ushtrimi i provës së rezistencës së likuiditetit

Rezultatet e ushtrimit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit sipas të dhënave të muajit nëntor 2023, për horizontin kohor 2024-2025, paraqitet shumë më e mirë në krahasim me një vit më parë.

Ky përmirësim vërehet si në nivelin e likuiditetit për të gjithë sektorin bankar, ashtu edhe në nivel bankave individuale, dhe lidhet me rritjen e konsiderueshme në flukset e pritura hyrëse të parasë për monedhat Lek dhe Euro.

Rezultatet tregojnë një situatë dukshëm të përmirësuar edhe për banka që në vitet e kaluara kanë shfaqur dobësi në mbylljen e hendekut të likuiditetit në një ose më shumë monedha.

Prova e rezistencës së likuiditetit ka për qëllim të vlerësojë aftësinë e bankave individuale dhe të sektorit bankar në përgjithësi për t'iu bërë ballë goditjeve ekstreme, por të mundshme, në financimin e veprimtarisë së tyre. Prova e rezistencës së likuiditetit realizohet sipas përfaqjes "nga lart – poshtë" me të dhëna të raportuara nga bankat një herë në vit në fund të vitit. Ushtrimi përdor të dhëna mbi flukset e parashikuara hyrëse dhe dalëse të parasë sipas instrumenteve kryesore dhe për një horizont kohor të përbërë nga 8 shporta maturimi që mbulojnë intervalin nga "deri në 1 ditë" deri në "mbi 1 vit dhe deri në 2 vjet".

Prova kryhet për monedhat Lek, Euro dhe USD dhe mbështetet në kushtin që tepricat e likuiditetit në një monedhë nuk mund të përdoren për të plotësuar mungesën e likuiditetit në monedhat e tjera, për shkak të probabilitetit të zhvlerësimit të shpejtë të kursit të këmbimit gjatë krizave të likuiditetit. Për llogaritjen e hendekut të likuiditetit përdoren koeficientë të përcaktuar për tërheqjet e burimeve të financimit (të depozitave) dhe për riinvestimin e aktiveve (kredive) sipas të gjitha shportave të maturimit. Për burimet e financimit, koeficienti tregon vetëm atë pjesë të shumës së detyrimeve që maturohet në shportën përkatëse, e cila do të tërhiqet dhe nuk do të riinvestohet nga klienti. Për hyrjet e parasë, koeficientët e riinvestimit nënkuptojnë atë pjesë të shumës së të drejtave që maturohen në shportën përkatëse, e cila do të konvertohet në fluks hyrës parash dhe nuk do të riinvestohet nga banka. Një bankë konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara, që shiten me marzhe reduktuese të përcaktuara nga ushtrimi, bien deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

Rezultatet e ushtrimit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit sipas të dhënave të muajit nëntor 2023, për horizontin kohor 2024-2025, paraqitet shumë më e mirë në krahasim me një vit më parë. Flukset e pritura hyrëse dhe dalëse të parasë gjatë dy viteve të ardhshme llogariten përkatësisht 30% dhe 5% më shumë sesa vlerat e pritura një vit më parë, dhe rritja

e konsiderueshme në vlerën e hyrjeve të pritura të parasë, rezulton në një zvogëlim të diferencës hyrje-dalje prej rreth 20%.

Përmirësimi i pozicionit të likuiditetit vërehet në monedhat Euro dhe Lek dhe ngushtimi në vlerë relative dhe nominale i hendekut midis hyrjeve dhe daljeve është pothuajse i njëjtë. Flukset e pritura hyrëse për të dyja monedhat paraqiten 36% më të larta në krahasim me vlerën e raportuar nga bankat një vit më parë, ndërsa flukset e pritura dalëse janë rreth 5%-6% më të larta. Hendeqet negative për secilën monedhë rezultojnë përkatësisht 23% dhe 15% më pak. Niveli i kapaciteteve kundërpeshuese ose të aktiveve likuide të zgjeruara që bankat mund të likuidojnë në rastin e krizave të likuiditetit është i krahasueshëm me nivelin e raportuar nga bankat një vit më parë. Aktivët likuide në monedhën Lek janë zgjeruar ndërsa ato në monedhën Euro kanë regjistruar rënie.

Në krahasim me vitin e kaluar, madhësia e hendekut të thjeshtë të likuiditetit⁴⁶ në raport me totalin e aktiveve nuk ka ndryshuar për monedhat Lek dhe USD por paraqet një përmirësim të lehtë për monedhën Euro në të dy parametrat (numër bankash dhe madhësi mesatare e hendekut). Situata e likuiditetit përpara përdorimit të cash-it dhe kapaciteteve kundërpeshuese, matur nga hendeku i thjeshtë i likuiditetit, paraqitet më e dobët për monedhën Lek, si për nga numri maksimal i bankave me hendek të thjeshtë të likuiditetit (HTL) negativ (11 nga 11), ashtu edhe për nga madhësia maksimale e hendekut (7% e aktiveve në Lek në krahasim me 1-2% të aktiveve në Euro dhe USD).

Pas përdorimit të kapaciteteve kundërpeshuese (tituj që mund të likuidohen për të mbyllur hendekun më sipër), situata e bankave të sektorit përmirësohet ndjeshëm, duke qenë se numri i bankave që vijnë të kenë hendek negativ bie në 1 bankë nga përkatësisht 11 dhe 4 banka për monedhat Lek dhe USD dhe në 2 nga 9 banka për monedhën Euro. Për monedhën Lek bankat kanë përgjithësisht një hendek më të madh negativ midis hyrjeve dhe daljeve në krahasim me monedhën Euro, veçanërisht për shportat me maturitetet deri në 2 muaj, por aktivët likuide që bankat mund të përdorin për të mbuluar hendekun e likuiditetit në monedhën në Lek janë disi më të larta në krahasim me ato në Euro. Rezultatet tregojnë një situatë dukshëm të përmirësuar edhe për banka që në vitet e kaluara kanë shfaqur dobësi në mbylljen e hendekut të likuiditetit në një ose më shumë monedha.

3.2 Sektori jobankar

3.2.1 Ecuria e sektorit jobankar

Gjatë gjysmës së dytë të vitit segmentet e tjera të sistemit financiar kanë regjistruar zgjerim të aktivitetit.

Institucionet financiare të ndryshme nga bankat vijnë të mbeten të mirëkapitalizuara dhe me një cilësi të mirë të portofolit të

Të gjitha segmentet e sistemit financiar të ndryshme nga bankat kanë regjistruar rritje të aktivitetit gjatë gjysmës së dytë të vitit⁴⁷ mbështetur kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit të institucioneve financiare jobanka dhe fondet e investimit. Aktivët e sektorit jobankar arrijnë në 10% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe kanë ruajtur një raport të pandryshuar prej 9% ndaj PBB-së. Struktura e sektorit jobankar vijon të dominohet nga institucionet financiare jobanka që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, të ndjekura nga fondet e investimit dhe shoqëritë e sigurimit që licencohen dhe mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).


⁴⁶ Hendeku i thjeshtë i likuiditetit llogaritet si diferenca midis flukseve të pritura hyrëse dhe dalëse të shumëzuara me koeficientët e tërheqjes (për burimet e financimit/depozitat) dhe të riinvestimit (për aktivët/kreditë) për çdo shportë të maturitetit të mbetur për secilën nga monedhat.

⁴⁷ Baza e të dhënave vetëm për institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e sigurimit i përket tremujorit të tretë të vitit 2023.

kredisë për institucionet kredituese.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe i qëndrueshëm, ndërsa ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe ky ekspozim është rritur lehtë krahasuar me nivelin e qershorit të vitit 2023.

Grafik 92. Struktura e sektorit jobankar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.


Përveç këtyre dy segmenteve, në sistemin financiar vendas veprojnë edhe shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) dhe fondet e pensionit, që mbikëqyren përkatësisht nga Banka e Shqipërisë dhe AMF. Aktualisht, në tregun financiar operojnë 41 IFJB, 16 SHKK dhe një union, 12 shoqëri sigurimi, 15 fonde investimi dhe 6 fonde pensioni. Peshën kryesore në veprimtarinë e sektorit jobankar e zë aktiviteti i institucioneve financiare jobanka ndjekur nga shoqëritë e sigurimit.

Institucionet financiare jobanka raportuan zgjerim të aktivitetit, rritje të fitimit dhe nivel të mirë të kapitalizimit. Aktiviteti kryesor i tyre është ai kreditues (41%), ndjekur nga pagesat elektronike (26%). Sektori i aktiviteteve të tjera të shërbimit dhe ai i tregtisë me shumicë dhe pakicë janë sektorët më të financuar nga IFJB-të (me nga rreth 25% dhe 16% të totalit të stokut për bizneset), ndjekur nga ndërtimi (10%). Kredia dhënë individëve zë 50% të totalit të kredisë dhe pjesa tjetër u takon bizneseve. Cilësia e kredisë shënoi rritje gjatë periudhës, dhe RKP ra në nivelin 14% nga 15% një vit më parë. Rreth 78% e kapitalit të paguar të institucioneve jobanka është kapital vendas. IFJB-të e mbyllën periudhën me një rezultat financiar pozitiv (rreth 5 miliardë lekë) mbi 2 herë më të lartë ndaj nivelit të një viti më parë. Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet i lartë.

Shoqëritë e kursim-kreditit shënuan rritje të vëllimit të aktiveve. Ky segment ka ruajtur të pandryshuar cilësinë e portofolit të kredisë krahasuar me një vit më parë, me RKP në nivelin 4.7%. Në portofolin e investimeve të SHKK-ve, peshën kryesore e zënë investimet në kredi (76%) dhe investimet në banka në formën e llogarive rrjedhëse (15%). Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit është sektori i bujqësisë (21%), i ndjekur nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë (15%). SHKK-të e mbyllën periudhën me një fitim neto pozitiv.


Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit zgjeruan aktivitetin e tyre, si rrjedhojë e rritjes së primeve të shkruara bruto dhe investimeve në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë.

Grafik 93. Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas subjekteve në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 94. Shpërndarja e mjeteve, detyrimeve dhe pozicionit neto sipas subjekteve të sektorit jobankar (shtator 2023)




Sektori jobankar vijon të mbajë një pozicion të balancuar të aktiveve dhe detyrimeve financiare⁴⁸.

Aktivet kryesore janë huatë dhe letrat me vlerë të borxhit, ndërsa detyrimet përfaqësohen nga kapitali dhe aksionet në fondet e investimit dhe huatë. Sektori jobankar ka zgjeruar pozicionin neto kreditor në raport me fundin e një viti më parë, ndikuar nga shtimi i investimeve në letrat me vlerë të borxhit dhe huatë. Brenda sektorit jobankar, fondet e investimit dhe shoqëritë e sigurimit me fondet e pensionit kanë një pozicion neto negativ (debitor), ndërsa ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobankat dhe SHKK-të) kanë një pozicion neto pozitiv (kreditor). Për nënsektorët e fondeve të investimit dhe shoqërive të sigurimit me fondet e pensionit, pozicioni debitor në fund të tremujorit të tretë të vitit ishte sa 6% e totalit të aktiveve të sektorit jobankar.

Kredia dhe letrat me vlerë të borxhit vijojnë të zënë peshën kryesore në aktivet e subjekteve financiare të ndryshme nga bankat.


Letrat me vlerë të borxhit zënë 26% të aktiveve financiare të sektorit jobankar, ndërsa huatë dhe monedhat e depozitat zënë respektivisht 28% dhe 23%; megjithatë këto raporte janë të ndryshme për subjektet e këtij sektori. Për fondet e investimit, letrat me vlerë të borxhit përfaqësojnë rreth 82% të aktiveve të tyre, ndërkohë që për ndërmjetësit e tjerë financiarë peshën më të madhe e zënë huatë me rreth 51%. Shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit të marra së bashku, kanë shpërndarjen më heterogjene të aktiveve, të cilat janë të vendosura në monedha dhe depozita (36%), letra me vlerë të borxhit (26%), sigurime dhe skema pensionesh (14%), si dhe në kapital dhe aksione në fonde investimi (12%). Sipas instrumenteve, sektori jobankar ka një pozicion neto debitor për kapitalin dhe aksionet në fondet e investimit, në sigurime dhe skema pensionesh, dhe një pozicion neto kreditor për letrat me vlerë të borxhit, huatë dhe monedha e depozita.

Grafik 95. Pozicioni neto i sektorit jobankar sipas instrumenteve në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 96. Ndërlidhja e sektorit jobankar me sektorin bankar, shtator 2023



⁴⁸ Analiza për aktivet dhe detyrimet e sektorit jobankar mbështetet në të dhënat e llogarive financiare për tremujorin e tretë 2023.

3.2.2 Rreziqet dhe ekspozimet midis sektorit bankar dhe jobankar

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i ulët dhe nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Në krahun e aktivitet të bankave, ekspozimi ndaj sektorit jobankar përfaqësohet kryesisht nga huatë akorduar institucioneve financiare jobankare. Ndërmjetësit financiarë (jobankat dhe ShKK-të) janë segmentet më të financuara nga sektori bankar me një stok kredie prej 18 miliardë lekësh, ndjekur nga kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit me kredi në vlera mjaft të ulëta. Stoku total i financuar nga sektori bankar është rreth 20 miliardë lekë dhe zë vetëm 1% të vlerës së bilancit të sektorit bankar.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe ka shfaqur një rritje të lehtë gjatë periudhës. Pretendimet e sektorit jobankar ndaj bankave janë në formën e vendosjeve (Ilogari rrjedhëse, depozita me apo pa afat). Stoku i fondeve të vendosura pranë bankave deri në fund të tremujorit të tretë ishte rreth 54 miliardë lekë, ose sa 28% e aktiveve të sektorit jobankar. Vendosjet më të mëdha pranë sektorit bankar, ose 60% të totalit, i kanë ndërmjetësit e tjerë financiarë (jobanka, ShKK), dhe këto vendosje janë rritur lehtë krahasuar me gjysmën e parë të vitit.

Në raport me aktivitet e tyre, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit kanë ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar, pasi vendosjet e tyre në banka përbëjnë rreth 36% të aktiveve të tyre. Sektori jobankar ka zgjeruar pozicionin e tij kreditor neto me bankat në nivelin 37 miliardë lekë, nga 35 miliardë lekë në fund të qershorit 2023. Zgjerimi i pozicionit neto rrit ndjeshmërinë e sektorit jobankar ndaj ecurisë së aktivitetit të sektorit bankar. Pozicionin neto kreditor më të lartë e kanë shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit, duke qenë se kanë më shumë pretendime në sektorin bankar krahasuar me detyrimet, ndjekur nga ndërmjetësit e tjerë financiarë. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë, në kuadrin e vlerësimit periodik të rreziqeve sistematike dhe monitorimit të përmbushjes së objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës ndaj rrezikut të përhapjes tregojnë që segmente dhe subjekte të veçanta të sektorit jobankar janë të rrezikuara në rastin e goditjeve nga sektori bankar dhe nga banka të veçanta. Ushtrimi tregon që në tërësi sektori bankar është i mbrojtur nga goditjet që mund të vijnë nga sektori jobankar, edhe në rastin e dështimit të të gjitha subjekteve të një segmenti të marra së bashku. Nga ana tjetër, institucionet financiare jobanka dhe Sh.K.K-të shfaqin ndjeshmëri të lartë ndaj sektorit bankar pasi goditje ekstreme nga sektori bankar, kanë potencialin që të çojnë në dështim pjesën më të madhe të subjekteve ose të gjithë segmentin përkatës. Për shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve dhe investimit dhe për shoqëritë administruese të tyre ushtrimi tregon rrezik minimal në të dyja kahet e goditjes, që do të thotë që goditjet nga njëri sektor nuk rezultojnë në dështime të rëndësishme për nga madhësia në subjektet e sektorit tjetër. Ky rezultat shpjegohet me faktin që, pavarësisht se ekspozimet e këtyre segmenteve ndaj bankave janë të larta në raport me aktivitet e veta, kapitali i tyre është në nivele të mjaftueshme për të përthithur humbjet e shkaktuara nga goditjet e përcjella.

4. Rreziqet sistemike dhe politika makroprudenciale

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka vijuar të monitorojë rreziqet sistemike në sektorin bankar dhe në sistemin financiar në bazë të treguesve të stabilitetit financiar të lidhur me ecurinë e kredisë, nivelin e përqendrimit të aktivitetit bankar, nivelin e likuiditetit, madhësinë dhe natyrën e ekspozimeve të veçanta sipas instrumenteve, valutave, sektorëve të ekonomisë etj., si edhe në bazë të ushtrimeve të rregullta të provave të rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe për likuiditetin. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, pas një periudhe rreth dy vjeçare përgatitjeje dhe konsultimi me sektorin bankar, u miratua dhe hyri në fuqi rregullorja 44/2023 "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredihënien dhe investimet për prona të paluajtshme".

Rregullorja përcakton përkufizimet dhe formatin që do të përdorin bankat për të raportuar treguesit për standardet e huadhënies dhe për investimet e tyre në prona të paluajtshme. Paralelisht, nëpërmjet kësaj rregulloreje sqarohen mënyrat se si bankat mund të zbatojnë vlerat kritike dhe nivelet-kufi për treguesit e huasë ndaj të ardhurave, huasë ndaj vlerës së pronës dhe shërbimit të huasë ndaj të ardhurave. Gjithashtu, ajo parashikon të drejtën e BSh-së për t'i përdorur këta tregues si instrumente të politikës makroprudenciale, duke aplikuar kufij të sipërm ose të poshtëm mbi nivelet e tyre, në rast nevojë. Miratimi dhe zbatimi i këtij akti nënligjor përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit makroprudencial të vendit me legjislacionin dhe praktikën e ndjekura nga vendet e Bashkimit Evropian. Rregullorja shoqërohet me 8 forma raportimi për kreditë e reja dhe për tepicën e kredive të akorduara nga bankat në nivel subjekti kredimarrës, për prona rezidenciale dhe tregtare dhe raportimi i bankave pranë BSh do të fillojë për muajin mars 2024.

4.1 Rreziqet sistemike dhe politika makroprudenciale

Harta e nxehtësisë së rreziqeve sistemike përmban një analizë të hollësishme të një numri të lartë treguesish të ndarë sipas objektivave të ndërmjetëm makroprudencialë. Sipas të dhënave të analizuara deri në fund të periudhës, treguesit që i kanë tejkaluar ose iu janë afruar niveleve kritike të përcaktuara si mesatare historike ose në bazë të gjykimit ekspert, lidhen me objektivin e parë, të dytë dhe të tretë të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale. Konkretisht, treguesit e përfshirë në analizën e objektivit të parë sinjalizojnë për një rritje të shpejtë të indeksit të qerasë, pritjeve për çmimet e banesave dhe kredisë për pasuri të paluajtshme për bizneset. Disa tregues që monitorohen në kuadër të objektivit të dytë tregojnë hendek të lartë midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet shumë afatshkurtra, dhe rritje të luhatshmërisë në kursin e këmbimit, në spread-in e kursit ndërbankar Lek/Euro dhe në interesin ditor ndërbankar.

Midis treguesve që paraqesin shkallën e përqendrimit të ekspozimeve dhe që monitorohen brenda objektivit të tretë, dallohen vlera të larta dhe në rritje për ekspozimet e mëdha ndaj kapitalit të bankave, përqendrimin e kredisë për prona të paluajtshme ndaj totalit të kredisë, aktivet në valutë, dhe kredinë e pambrojtur nga ndryshimet e kursit të këmbimit. Një pjesë e mirë e këtyre ekspozimeve dhe treguesve, janë subjekt i kontroleve dhe kufijve rregullativë të Bankës së Shqipërisë dhe si të tillë, përgjithësisht paraqesin vlera nën kufijtë e lejuar nga rregulloret përkatëse. Pavarësisht kësaj, politika makroprudenciale mbetet e orientuar drejt parandalimit dhe mbajtjes nën kontroll të këtyre rreziqeve, duke synuar edhe kufizimin e përhapjes së tyre nga një segment, në një segment tjetër të sistemit financiar.

Treguesit e lidhur me rrezikun e përqendrimit valutor dhe me ecurinë e agregatëve valutorë në përgjithësi së bashku me analizën e efektit të masave të deritanishme, monitorohen dhe raportohen rregullisht edhe si pjesë e analizës gjashtëmujore "Raport¹ mbi ecurinë e treguesve që do të monitorojë BSh në kuadër të procesit të deeuroizimit".

Dy nga objektivat kryesorë që lidhen me mbinxehjen e kredisë në raport me rritjen ekonomike dhe me rreziqet e lidhura me institucionet me rëndësi sistemike, adresohen në mënyrë të rregullt nga ana e BSh nëpërmjet vlerësimit dhe shpalljes së shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) dhe shtesës së kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST). Në mënyrë më të përmbledhur, në kahun zbutës të rreziqeve të identifikuar kanë ndikuar zhvillimet pozitive në rritjen dhe peshën relative të kredisë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit, nivelet e larta të aktiveve likuide të bankave, shtrëngimin e standardeve të kreditimit për bizneset dhe individët nga ana e bankave, dhe rritjen e normave të interesit të kredisë gjatë dy viteve të fundit. Analizat janë shoqëruar me rekomandimin për të mos caktuar masa të reja makroprudenciale apo ndryshuar masat ekzistuese.

Tabelë 5. Treguesit e hartës makroprudenciale të rreziqeve sistemike që sinjalizojnë rrezik më të lartë ose të shtuar sipas objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale

<i>Objektivi i ndërmjetëm i politikës makroprudenciale</i>	<i>Tregues që sinjalizojnë rrezik më të lartë/të shtuar</i>
Objektivi 1: Zbutja dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kreditimit dhe raporti i levës financiare	Ndryshimi vjetor i indeksit të qerasë
	Balanca neto e pritjeve për çmimet e banesave
	Ndryshimi vjetor i kredisë për bizneset për pasuri të paluajtshme komerciale
Objektivi 2: Zbutja dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar në maturitet dhe mungesës së likuiditetit në treg	Hendeku kumulativ deri në 7 ditë
	Luhatshmëria tremujore e kursit EUR dhe USD në ALL
	<i>Spread</i> -i i kursit ndërbankar për EUR në ALL
	Luhatshmëria e interesit ditor ndërbankar
Objektivi 3: Kufizimi i përqendrimeve të ekspozimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë	Ekspozimet e mëdha totale ndaj totalit të kapitalit
	Kredia për prona të paluajtshme ndaj totalit
	Aktivet në valutë ndaj totalit
	HHI për kredinë e pambrojtur sipas monedhave (EUR, USD)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, BSH ka vijuar të zbatojë kërkesat e parashikuara në rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”⁴⁹ (Rregullorja 41/2019), dhe të ndjekë raportimet tremujore të bankave mbi masën e përmbushjes së këtyre kërkesave. Duke nisur nga viti 2020, bankat kanë filluar të përmbushin me shtesa vjetore prej 0.5 p.p. kërkesën për shtesën konservuese të kapitalit (KONS), si edhe për shtesën e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST), që shpallet një herë në vit, në fund të muajit mars.


Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC) përdoret për të zbutur ose ngadalësuar rritjen e tepërt të kredisë dhe për të rritur rezistencën e bankave gjatë periudhave të mbinxehjes së tregut të kredisë. Pavarësisht se ky instrument është aktiv, norma e shtesës për Shqipërinë ka mbetur e pandryshuar në vlerën zero për qind, pasi hendeku i kredisë ndaj PBB-së vijon të qëndrojë në territor negativ. Për të mbështetur vendimarrjen lidhur me normën e shtesës kundërciklike të kapitalit, BSH merr në konsideratë edhe ecurinë e disa treguesve plotësues, siç janë kredia për pasuri të paluajtshme, indeksi i çmimit të banesave, treguesi i intensitetit të kredisë për ekonominë dhe treguesi i paralajmërimit të hershëm plotësues.

Në tërësi, sektori bankar, i ndihmuar nga një pozicion i mirë fillestar i nivelit të kapitalizimit, ka qenë i aftë për të përmbushur këto kërkesa. BSH vlerëson që zbatimin e tyre, i ndërthurur me zbatimin e kërkesave të

⁴⁹ Shtesat që zbatohen aktualisht janë shtesa konservuese e kapitalit (KONS), shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC) dhe shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike (SIST). Për më shumë informacion mund të drejtoheni në adresën: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikës_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/


reja të lidhura me funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme⁵⁰, ka rezultuar dhe do të vijojë të kontribuojë në forcimin e rezistencës dhe shëndetit të sektorit bankar në vend.

Grafik 97. Hendeku i raportit kredi për ekonominë / PBB



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 98. Ecuria e treguesit të paralajmërimit të hershëm plotësues



4.2 Perceptimi i sektorit bankar mbi rrezikun sistemik

Vrojtimi me bankat për perceptimin prej tyre të rreziqeve sistemike, tregon një zbutje të perceptimit të rreziqeve nga faktorë të brendshëm dhe rritjes së rrezikut nga goditjet e jashtme.

Bankat kanë vlerësuar 'rrezikun e goditjeve nga jashtë' si rrezikun kryesor sistemik të periudhës dhe vlerësimi për të është rritur krahasuar me periudhën paraardhëse.

Rreziku kibernetik renditet në vendin e dytë, por nota e rrezikut ka rënë lehtë krahasuar me periudhën paraardhëse.

Perceptimi i bankave mbi rrezikun e inflacionit dhe të luhatjes së normave të

Rezultatet e vrojtimit mbi perceptimin e rreziqeve sistemike në vend nga industria bankare tregojnë një renditje dhe vlerësim të ndryshëm të rreziqeve në gjysmën e dytë të vitit 2023, krahasuar me gjysmën e parë të tij, diktuar nga faktorë si: përshkallëzimi i tensioneve të jashtme gjeopolitike, shtimi i sulmeve kibernetike në vend, ecuria e inflacionit, si dhe rritja e normave të interesit dhe efektet e kësaj rritjeje në ekonomi.


Sektori bankar ka klasifikuar rrezikun e goditjeve nga jashtë si rrezikun kryesor sistemik gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, dhe perceptimi mbi rëndësinë e tij është rritur. Përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike në mjedisin e jashtëm (si konflikti në Rripin e Gazës, vazhdimi i luftës në Ukrainë), presionet ende të larta inflacioniste në nivel global, shtrëngimi i kushteve të financimit në refleksion të politikave të bankave të mëdha qendrore etj., duket se kanë rritur shqetësimin e bankave në vend mbi rrezikun e transferimit të goditjeve negative nga jashtë, që shfaqet si rreziku sistemik më i rëndësishëm për këtë periudhë sipas perceptimit të bankave. Rreziku nga sulmet kibernetike ka vijuar të mbetet në listën e rreziqeve më të rëndësishëm, ndonëse perceptimi mbi të është zbutur disi. Shtimi i episodeve të sulmeve kibernetike gjatë vitit të kaluar, ka rritur tashmë vetëdijen e bankave mbi këtë rrezik, dhe një pjesë e tyre deklarojnë se kanë ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e sistemeve të tyre të mbrojtjes.

⁵⁰ Kërkesat që rrjedhin nga rregullorja nr.78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar".

interesit, është zbutur ndjeshëm gjatë periudhës, ndikuar nga rënia e normave të inflacionit dhe ngadalësimi i normalizimit të politikës monetare brenda dhe jashtë vendit.

Mundësia e materializimit të një/ose disa prej rreziqeve të rëndësishme sistemike në të ardhmen afatshkurtër vlerësohet e ulët dhe në rënie.

Grafik 99. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Perceptimi mbi rrezikun e inflacionit në vend ka rënë ndjeshëm, ndikuar nga rënia e qëndrueshme e vlerave të tij gjatë periudhës. Rënia e intensitetit të normalizimit të politikës monetare brenda dhe jashtë vendit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, krahasuar me gjysmën e parë të tij, si rezultat i rënies së ndjeshme të vlerave të inflacionit, duket se ka ndikuar në zbutjen e perceptimit të bankave në vend lidhur me rrezikun e luhatjes së normave të interesit, dhe vlerësimi për këtë rrezik ka shënuar rënie. Rreziku i përkeqësimit të ekonomisë së brendshme si rezultat i përcjelljes së efektit të politikave shtrënguese të brendshme dhe të jashtme, apo materializimit të goditjeve të ndryshme, vijon të mbetet i pranishëm, por perceptimi i sektorit bankar për të ka qenë në rënie gjatë gjithë vitit të kaluar.

Në terma të përgjithshëm, bankat perceptojnë që mundësia e materializimit të një (ose disa) prej rreziqeve të lartpërmendura në të ardhmen afatshkurtër (deri në një vit), është e ulët dhe në rënie, por rritet kur vlerësimi bëhet për një horizont më të gjatë kohor (1-3 vjet), ndikuar nga pasiguria që rrethon zhvillimet e ardhshme. Pavarësisht sfidave të vitit të kaluar, situata e mirë e kapitalizimit dhe likuiditetit të sektorit, ka bërë që besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar në të ardhmen të cilësohet mbi nivelin “i mjaftueshëm” dhe i pandryshuar, si për të ardhmen afatshkurtër (deri në 1 vit) edhe për atë afatmesme (1-3 vjet).